

ISSN 1857-6443
9 771857 644006

HERBERT MAKMASTER

SHBA kthehet në Ballkan

Fq.4



REFORMAT NË ARSIM

Lënda qytetare do të shkrihet në lëndë tjera

Fq.6



Vazhdojmë të punojmë me përkushtim maksimal

Fq.19



Koha

www.koha.mk



Njohja e gjuhëve, pasuri e veçantë

Fq.12-13

E PËRDITSHME INFORMATIVE

Viti XII · Numri 3238 · e mërkurë 6 dhjetor 2017

-4°C | 9°C

15 DEN

FORUM

Zhurma për (jo) identitet



Pse ka kaq entuziastë dhe të palodhshëm në nxitjen dhe mbajtjen e konflikteve ndërfaqetare? A mos këto agjenda publike që dalin pa pushim për të mbajtur gjallë mobilitetin konfrontues ndërfaqetar, përgjasojnë në thënie: "Në rastësi nuk mund të ketë gjithmonë jorastësi" **Fq.10**

DOSSIER

Mehmeti, krahu i djathtë i Ismail Qemalit

Fq.17

RAJON

Ballkani të përballet me të kaluarën

Fq.14

GLOBI

Marrëveshje për kufirin BE-Britani

Fq.15



NUK KA SHPRESA QË QEVERIA TË RRRIT DERI NË 13 PËRQIND TVSH-në

KOHA PËR NDARJE TË RE TERRITORIALE



Ekspertët thonë se duhet një ndarje e re territoriale apo të ndryshojë qasja e Qeverisë ndaj pushtetit lokal për ta ndihmuar direkt me mjete financiare për t'u zhvilluar. Këtë e kërkon edhe ish-kryetari i Gostivarit, njëherësh ish-ministër i Pushtetit Lokal, Nevzat Bejta. "Është qesharake që në shekullin 21 i kemi ende këto probleme. Edhe atë ligj që e kemi për zhvillim të barabartë rajonal, nuk e zbatojmë, sepse po të shpërndahej qysh duhet 1 përqindëshi i Bruto Prodhimit Vendor, nuk do ti kishim komunat në këtë gjendje ku janë", thotë Bejta **Fq.3**

Tre në Shutkë, tre në arrest shtëpiak

Shkup, 5 dhjetor - Në Shutkë, në paraburgim kanë përfunduar tre deputetët e VMRO-së, të cilësuar si kryesorë në hapjen e dyerve për hlliganët maqedonas natën e 27 prillit - Kërsto Mukovski, Sasho Vasilevski dhe Luben Arnau-dov, derisa paraburgim shtëpiak kanë marrë deputetët Johan Tarçullovski, Zhaklina Peshevska dhe Ljupço Dimovski. Kështu vendosi të martën Trupi gjyqësor i Gjykatës Penale të

Shkupit, ndërkohë që gjatë tërë ditës, kishte marrë në pyetje gjashtë deputetët e VMRO-së, të akuzuar për "terrorizëm". Një deklaratë të shkurtër për mediat para hyrjes në gjykatë dje dha vetëm deputeti Mukovski, i cili tha se shikuar juridikisht, sipas tij, nuk ka argumente për paraburgim, por, siç theksoi, ia lë gjyqit që të vendosë për atë dhe beson në të. Ndryshe, gjashtë deputetët janë... **Fq.5**



EDITORIAL

PËR ÇFARË PUNOJNË
KOMUNATVedat MEMEDALIU
kryeredaktor

Premtimi për rritjen e TVSH-së për komunat - nga 4.5 për qind sa është aktualisht, në 14 për qind, tashmë u harrua. Jo vetëm LSDM, por edhe BDI dhe Aleanca për Shqiptarët në pushtet - përveç në letër, para zgjedhjeve, nuk e kanë ndërmend ta vënë në rend dite këtë pikë, më shumë se të rëndësishme për funksionimin normal të pushtetit lokal. Këta të fundit, me buxhetet që disponojnë, e disa me llogari të bllokuara prej vitesh, pos rrogave për punonjësit administrativ, asgjë më shumë nuk mund të bëjnë. Ndonjë rrugë tek-tuk, disa gypa për kanalizim e ujësjellës, pa filtra tamam... është e gjithë puna e komunave që, pas zgjedhjeve, po mundohen të tregojnë se punë do ketë.

Me decentralizim të centralizuar fiskal dhe me ingerenca të përgjysmuara për komunat, kryetarët e komunave bartin një pjesë të fajit. Sepse, asnjëherë më parë, por as tani, nuk e ngrenë seriozisht zërin për të kërkuar hisen që u takon. Nuk bëzajnë, sepse në pushtet i kanë partitë e tyre dhe, si gjithmonë, në Maqedoni - komuna edhe duhet të dështojë, por jo partia të akuzohet. Aktualisht, Shkupi dhe komunat e tij marrin 12 për qind, ndërsa 88 për qind komunat tjera. Sipas kriterëve të kësaj rregulloreje, 65 për qind e këtyre mjeteve ndahen sipas numrit të banorëve, 27 për qind sipas madhësisë së territorit dhe 8 për qind sipas numrit të vendbanimeve. 4.5 përqindësi i TVSH-së jo që është shumë pak, krahasuar me shtetet me decentralizim të zhvilluar, por brenda vetës bën edhe një diskriminim të heshtur, sepse kriteret dhe formula e përdorur në shpërndarjen e TVSH nëpër komuna, nuk bëhet sipas asaj se nga ku mblihet kjo TVSH, por automatikisht, sipas kriterëve, dhe kemi situatë që në nivel të një komune, e cila ekonomikisht nuk ka aktivitete të zhvilluar në raport me një tjetër ku ka, ta ndajnë TVSH-në në mënyrë të barabartë, gjithmonë sipas kësaj formule. Të dhënat statistikore dhe studime të shumta tregojnë se nëse krahasohen burimet e të ardhurave të komunave në Maqedoni, me disa vende evropiane, apo edhe me vende të rajonit - shumë lehtë do të mund të vërejmë se decentralizimi fiskal te ne është akoma shumë larg prej tyre. Në Gjermani, për shembull, pjesa e komunave në tatimin personal, i cili paraqet të ardhura të përbashkëta të federatës dhe të krahinave - është 15 për qind. Në Belgjikë, madje komuna ka hisen e saj në të ardhura, të cilat grumbullohen nga regjistrimi i automjeteve, pastaj një pjesë e të ardhurave të grumbulluara nga sigurimet, të ardhurat nga dhënia e lejeve të gjuetisë dhe peshkimit, një pjesë e taksave energjetike, nga taksat e reparteve të prodhimit, pjesë nga kompensimi i shfrytëzimit të pasurive minerale dhe natyrore dhe kështu me radhë. Ndërkaq, më karakteristike janë të ardhurat komunale në Slloveni, të cilat janë pjesë e tatimit të të ardhurave nga të cilat komuna fiton 35 për qind, pastaj vijon një pjesë e të ardhurave nga lojërat e fatit dhe një pjesë nga shfrytëzimi i tokës bujqësore dhe pyjeve, dhe kështu me radhë. Në Kroaci, komunat fitojnë 3 për qind të TVSH-së, por 32 për qind të tatimit të të ardhurave dhe 20 për qind nga tatimi i fitimit. E, derisa pushteti dhe komunat të kujtohen për të reaguar (protagonistët pothuaj janë të të njëjtave parti), ashtu siç kanë premtuar, vendbanimet tona do arnohen me 10-15 metra asfalt dhe me qindra metra gypa kanalizim e ujësjellës. Kuptohet, pa filtra.

QË TË DALË NË SHESH E VËRTETA...

"Rastin e Kumanovës e montoj qeveria e Gruevskit! Këtë e deklaroi kryeministri Z. Zaev në datën 04.12.2017 në Komunën Qendër në Lagjen Kapishtec në një takim me qytetarët. E vërteta duhet të dalë në shesh për arsye se: Opinioni nuk e di kush ishte organizatori i dhe udhëheqësi i 'rastit të Lagjes së Trimave'; Cili ishte motivi i veprimit; Nuk dihet cili nga tetë policët e vrarë me armën e cilit anëtarë të grupit është vrarë (opinionin nuk e di a është bërë balistika e armëve); Pushteti i ka likuiduar dy anëtarë të grupit pasi ata janë dorëzuar (kjo duket nga emrat e dy të likuiduarve, të cilët kanë qenë në listën e të arrestuarve, listë të cilën MPJ e Maqedonisë ia ka dërguar MPJ të Kosovës); Si kualifikohet veprimi kur një helikopter gjuan në një vendbanim në caqe të pa selektuar... Që të dalë në shesh e vërteta, Këshilli i Familjarëve të të akuzuarve, i përkrahur nga Shoqata joqeveritare dhe qytetare, kërkon rikualifikim dhe rigjykim të rastit, e deri atëherë kërkojmë solidarizim nga qytetarët gjatë protestave, të cilat nuk do të ndalen deri në zbardhjen e plotë të këtij konstruksioni politik me pasoja tragjike", shkruan Shpëtim Pollozhani në FB.



ANTONIO DHE KOHEZIONI NË VMRO

"Tani i është kujtuar Antonios (Milloshoski) kohezioni kur bashkë me liderin e tij e ndarë popullin në Maqedoni në parti me të gjitha bazat. I dukej mirë me praktikimin e filozofisë 'përcajë dhe sundo'. Kërkon kohezion tani kur lideri i tij mori pjesë në eliminimin e gjithë atyre që mendojnë ndryshe në parti dhe në shtet. Tani i është kujtuar kohezioni kur gjithë kohën mbështeti strukturat kriminale, ndërsa etiketonte të tjerët. 'Malu morgen' Antonio, koha e cila kaloi ishte shumë e shkurtër për të harruar kontributin (aktiv dhe pasiv) tëndin në organizatën kriminale. Apo ndoshta tani i pari do të mundohesh të lashë duart nga lideri yt, Gruevski", shkruan Jove Kekenovski, ish-anëtarë i Kryesisë së VMRO-së.



KUFIRI, MOLLA DHE DARDHA

"Kur mendon se kufirin e ke te Molla, vështirë e ke me njëjt në dardha", shkruan në profilin e tij në Facebook publicisti Veton Surroi, duke ironizuar me gjetjet e reja për Demarkacionin e Kosovës me Malin e Zi.



KURTHI MAQEDONI-KOSOVË-SHQIPËRI

"Kryeministri maqedonas Zoran Zaev ka deklaruar se ngjarjen në Kumanovë e paska organizuar Gruevski me shërbimet e veta. Në këtë rast, pjesëmarrësit në atë ngjarje, disa prej të cilëve janë vrarë e disa të tjerë janë dënua me qindra vite burg, janë viktime të këtij kurthi prej qeverive e shërbimeve. Qeveria e Shqipërisë dhe ajo e Kosovës duhet të kontaktojnë me Zaevin për një gjykim më të drejtë të luftëtarëve shqiptarë, meqenëse kurthin e paska ngritur Gruevski. Por këtë kurth Gruevski nuk ka mundur ta ndërtojë vetëm me shërbimet maqedonase, duhet hetuar veprimtaria e dyshimtë e disa personave të lidhur me SHIK-un dhe me pushtetin në Kosovë, të cilët i kanë lehtësuar në ndërtimin e kurthit, madje e kanë nxitur rënien në kurth të pjesëmarrësve në ngjarjen e Kumanovës. Gruevski i ka bashkëfajtorët e vet në Kosovë", shkruan Arbër Zaimi në FB.



MEDIACitate

Universiteti me repute në botën islame sunitë, Al-Azhar, ka paralajmëruar kundër planeve të Shteteve të Bashkuara të Amerikës (SHBA) për zhvendosjen e ambasadës në Jerusalem, dhe njohjen zyrtare të qytetit të shenjtë për kryeqytet të Izraelit. Në një kumtesë të publikuar të martën, institucioni i lartë me seli në Kajro, tha se një vendim i tillë eventual do të paraqesë "kërcënim për paqen në botë". "Një veprim i tillë do të shtojë zemërimin në mesin e muslimanëve, do të kërcënojë paqen në botë dhe do të thellojë tensionet, ndasitë dhe urrëjtjen në botë", paralajmëron Al-Azhar. (Anadolu Agency, 5 dhjetor)

Nga Brukseli shefja e diplomacisë evropiane Frederica Mogherini deklaroi për mediat se presim që 2018-ta të jetë viti i çeljes së negociatave për anëtarësim në BE. "Jam e lumtur të diskutoj me kryeministrin Edin Rama për integrimin, pasi presim që të fillojmë vitin e ardhshëm", tha Mogherini. Ndërkaq kryeministri shqiptar, theksoi se: "Unë jam shumë i sigurt, që presim të kemi rezultate pozitive për anëtarësim në BE, do të kemi edhe shumë më shumë për të dhënë", tha Rama. Më herët, në samitin e Ballkanit të organizuar nga "Friends of Europe", kryeministri Rama në fjalën e tij duke folur për integrimin e Shqipërisë në BE deklaroi se është mundësi për ti lënë "fantazmat e së kaluarës". "Integrimi është mundësi për të lënë mënjanë fantazmat e së kaluarës". (Gazeta Shqip, 5 dhjetor)

230 shtëpi banimi, pese ura si dhe qindra hektarë tokë janë dëmtuar si pasojë e përmblyjeve në qarkun Durrës. Ky është bilanci i dëmeve nga përmblytjet që shkaktuan reshjet e shiut dhe vërshimi i ujërave. Prefekti Roland Nasto tha se ka përfunduar procesin e evidentimit të dëmeve. Situata në të gjithë qarkun është e stabilizuar, ndërsa ka nisur shpërndarja e ndihmave tek familjet e prekura. Në Fushë Krujë gjendja në mjaft shtëpi është ende problematike. Banorët thonë se orëditë i kanë jashtë funksionit dhe te gjendur në këto kushte kërkojnë ndihmë. (Vizion Plus, 5 dhjetor)

NËSE NUK
E KENI DITUR...

Kalendari Kombiar

"Kalendari Kombiar" (1897-1916, 1926, 1928), botim i përvitshëm enciklopedik kulturor, letrar e politik i shoqërisë "Dëshira" të Sofjes. Numri i parë doli më 1897 me titullin "Ditërrëfënjësi" (kalendari) Kombiar dhe nga viti 1901 e deri në fund u titullua "Kalendari Kombiar". Gjatë viteve 1897-1900 u drejtua nga Kristo P. Luarasi me Kosta Trebickën dhe më pas edhe me Nikolla Naçon. Pas vitit 1900 botues i vetëm ishte Kristo Luarasi deri në numrin e fundit. Në vitin 1909-1910 u botua në Selanik; më 1911-1916 përsëri në Sofje. Më 1926 rinisi botimi në Tiranë nën drejtimin e Mit'hat Frashërit (Lumo Skëndos), i cili mundi

të nxjerrë një numër të fundit në vitin 1928. E gjithë seria përbëhet prej 22 vëllimesh. Në këto botime kanë shkruar artikujt e tyre shumë pena të Rilindjes shqiptare, arbëreshë, etj. sipas tematikave të cilat zgjidheshin nga botuesi. Për rritjen e nivelit kulturor intelektual të lexuesve, krahas autorëve shqiptarë, botuesit kanë përzgjedhur materiale të autoreve të huaj, gjithnjë me një sens për të rritur ndjenjën kulturore dhe kombëtare shqiptare. Vihen re edhe materiale të përkthyer nga historia, gjeografia, shkencat e natyrës, teknike etj, ku një pjesë të madhe ka patur Mit'hat Frashëri në saje të arsimit dhe kulturës së tij gjerë. Me vlerë janë përmbledhjet e bëra të ngjarjeve të vitit të mëparshëm, reklammat e lajmërimet dhe një risi ishte botimi i listës së ndihmëtarëve financiarë anë e kënd botës, që shërbente si një lidhje mes shqiptare



që nga Rusia në Argjentinë dhe Australia në Amerikën e Veriut. "Kalendari Kombiar" është shkruar me tre alfabetë që përdoren në atë kohë. Pas vitit 1908 është shkruar me alfabetin e Kongresit të Manastirit që përdoret edhe sot.

NUK KA SHPRESA QË QEVERIA TË RRIET DERI NË 13 PËR QIND TVSH-në

KOHA PËR NDARJE

TË RE

TERRITORIALE

Ekspertët thonë se duhet një ndarje e re territoriale apo të ndryshojë qasja e Qeverisë ndaj pushtetit lokal për ta ndihmuar direkt me mjete financiare për t'u zhvilluar. Këtë e kërkon edhe ish-kryetari i Gostivarit, njëherësh ish-ministër i Pushtetit Lokal, Nevzat Bejta. "Është qesharake që në shekullin 21 i kemi ende këto probleme. Edhe atë ligj që e kemi për zhvillim të barabartë rajonal, nuk e zbatojmë, sepse po të shpërndahej qysh duhet 1 përqindëshi i Bruto Prodhimit Vendor, nuk do ti kishim komunat në këtë gjendje ku janë", thotë Bejta

Koha

Fatos RUSHTI

Shkup, 5 dhjetor - Gjatë fushatave parazgjedhore, jo vetëm për zgjedhjet lokale, por edhe ato parlamentare - partitë politike premtojnë vazhdimisht rritjen e TVSH-së dhe zhvillim të barabartë rajonal, por kur janë në pushtet ndryshojnë qëndrimet publike duke mos bërë shumë drejt decentralizimit dhe zhvillimit ekonomik. Partitë që janë në pushtet - LSDM, BDI dhe ASH premtuan rritjen e TVSH-së për komunat deri në 14 për qind dhe njëkohësisht u zotuan për rritjen e tatimit personal dhe se do të zbatojnë si duhet Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal, gjegjësisht shpërndarje racionale të 1 për qind të Bruto Prodhimit Vendor për komunat. Si rezultat i mos interesimit të vazhdueshëm të Qeverisë që nga ndarja territoriale e vitit 2004 për të ndihmuar komunat, qoftë përmes rritjes së TVSH-së qoftë përmes zhvillimit të barabartë rajonal, ka bërë që shumë komuna të mos mund të ekzistojnë me kapacitetet që kanë, të mos dalin nga borxhet, dhe të ngritin kapacitetet e tyre në sferën urbanizmit, arsimit, kulturës, sportit, qendrave sociale. Perceptimi i vazhdueshëm i shumë ekspertëve të pushtetit lokal ka qenë se duhet një ndarje e re territoriale apo të ndryshojë qasja e Qeverisë ndaj pushtetit lokal për ta ndihmuar direkt me mjete financiare për t'u zhvilluar. Ish-kryetari për dy mandate i Komunës së Gostivarit dhe ish-ministër i Pushtetit Lokal, Nevzat Bejta, thotë se është koha e duhur të hapet debati për ndryshimin e Ligjit për ndarje territoriale. Në këtë pikë, Bejta propozon që të përgjysohet numri i komunave dhe të forcohet pushteti i komunës.

"Edhe para ndarjes së fundit territoriale që u bë në 2004-ën, kishte lëshime. Ato bënë që shumë komuna të mos mundin të funk-



REXHAIL ISMAILI

Me insistimin tonë si parti, TVSH do ketë rritje deri në 2 për qind për vitin tjetër. Në projekt-buxhetin për vitin 2018 kemi paraparë që mbi 140 milionë denarë apo rreth 3 milionë euro të rritet TVSH-ja për komunat - që do të thotë nga 4.5 për qind sa është këtë vit, të shkojë në 6.5. Rritje do të kemi edhe në bllokdotacionet, ku janë paraparë diku mbi 700 milionë denarë për vitin 2018 dhe komunat shqiptare janë ndër që do të përfitojnë më shumë nga bllokdotacionet



NEVZAT BEJTA

Mendoj se numri i komunave duhet të përgjysohet - të mos kemi më shumë se 40 komuna, si dhe të punohet në drejtim të forcimit të pozitës së kryetarit të komunës. Qytetarët e dinë që pozitë të lartë ka kryeministri dhe ministri, por ata duhet të lidhen më shumë me pozitën e kryetarit të komunës dhe në zgjedhje do të dinë më shumë të vlerësojnë në përzgjedhjen e kandidatëve ose të vlerësojnë punën apo mospunën e secilit

sionojnë - sidomos komunat rurale. Logjika dhe përvoja ime si ish-kryetar i një komune si Gostivari dhe si ish-ministër i Pushtetit Lokal, thotë se është koha të hapet debati për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit për ndarjen territoriale. Mendoj se numri i komunave duhet të përgjysohet - të mos kemi më shumë se 40 komuna, si dhe të punohet në drejtim të forcimit të pozitës së kryetarit të komunës. Qytetarët e dinë që pozitë të lartë ka kryeministri dhe ministri, por ata duhet të lidhen më shumë me pozitën e kryetarit të komunës dhe në zgjedhje do të dinë më shumë të vlerësojnë në përzgjedhjen e kandidatëve ose të vlerësojnë punën apo mospunën e secilit dhe ai që nuk i ka kryer obligimet, të marrë dhe përgjegjësi ligjore dhe jo vetëm politike", thotë për gazetën KOHA, Nevzat Bejta. Në lidhje me rritjen e TVSH-së për komunat, Bejta sugjeron që Qeveria të ndjekë modelet e vendeve perëndimore që, sipas tij, kanë pasur sukses në zhvillimin e barabartë rajonal.

"Është qesharake që në shekullin 21 i kemi ende këto probleme. Edhe atë ligj që e kemi për zhvillim të barabartë rajonal, nuk e zbatojmë, sepse po të shpërndahej qysh duhet 1 përqindëshi i Bruto Prodhimit Vendor, nuk do ti kishim komunat në këtë gjendje ku janë. Që të bëhen punët mirë, duhet vetëm që Qeveria të ketë vullnet për të zbatuar këtë ligj. Sa i përket rritjes së TVSH-së, është e vërtetë se jemi larg me trendet që ndjekin aktualisht vendet tjera. Qeveria e ka lehtë, vetëm duhet të marrë një model nga vendet që kanë pasur sukses me rritjen e TVSH-së", thotë Bejta. Ndërkaq, deputeti BDI-së, Rexhail Ismaili thotë se në Buxhetin për vitin 2018 janë paraparë rreth 140 milionë denarë, apo 3 milionë euro nga TVSH-ja që t'u kthehet komunave. Ai përmend edhe bllokdotacionet që sipas tij, arrijnë shifrën



FADIL ZENDELI

Decentralizimi me ruajtjen e unitaritit të shtetit ishte dhe kompromis i Marrëveshjes së Ohrit, por që nuk realizohet kjo. Psenë duhet ta thonë partitë që janë dhe ishin në pushtet. Ende kemi komuna që nuk kanë as një çerdhe e as qendra kulturore, as rrugë lokale... plus dhe janë në borxhe ose nuk kanë resurse për tu zhvilluar. Këto komuna mendoj se duhet bashkangjitur komunave që kanë si qendër qytetet

rreth 700 milionë denarë të destinuar për komunat. Ai madje thotë se TVSH-ja nga 4.5 për qind sa është këtë vit, planifikohet që për katër vite të shkojë në 6.5.

"Me insistimin tonë si parti, TVSH do ketë rritje deri në 2 për qind për vitin tjetër. Në projekt-buxhetin për vitin 2018 kemi paraparë që mbi 140 milionë denarë apo rreth 3 milionë euro të rritet TVSH-ja për komunat - që do të thotë nga 4.5 për qind sa është këtë vit, të shkojë në 6.5. Rritje do të kemi edhe në bllokdotacionet, ku janë paraparë diku mbi 700 milionë denarë për vitin 2018 dhe komunat shqiptare janë ndër që do të përfitojnë më shumë nga bllokdotacionet", zotohet deputeti Ismaili. Por, as nga Qeveria e as nga Ministria e Pushtetit Lokal nuk përgjigjen në pyetjen sesa është planifikuar rritja e TVSH-së për komunat për vitin 2018. Deputeti i Lëvizjes BESA, Fadil Zendeli, njëkohësisht dhe njohës i pushtetit lokal, mendon se me ndarjen territoriale të vitit 2004, i janë bërë padrejtësi vendbanimeve shqiptare. Ai thotë se shumë komuna është tepër e qartë se nuk kanë kapacitete të funksionojnë, duke mos ushtruar edhe kompetencat ligjore. Sipas tij, për të ndryshuar ndarjen territoriale - duhet bërë një analizë profesionale për të parë, siç thotë Zendeli, se cilat ko-

muna nuk mund të ekzistojnë dhe cilat mund të funksionalizohen pas 5 viteve. Deputeti i BESËS gjithashtu shprehet se decentralizimi i plotë ishte kompromis i aritjes së Marrëveshjes së Ohrit "për të ruajtur unitaritetin e shtetit", por që sipas tij, ende nuk po realizohet ai qëllim.

"Në vitin 2004 kur u bë ndarja e re territoriale, kishte padrejtësi si në Mavrovë, e cila nuk iu bashkëngjiti Gostivarit, por Rastushës. Apo Vevçani që u nda nga Struga, por dhe disa komuna tjera. Mendoj se duhet bërë një analizë e thukhtë profesionale pse jo dhe shkencore e inicuar nga Qeveria, për të parë se cilat komuna realisht nuk kanë kapacitete të ekzistojnë dhe cilat me ndihmën e Qeverisë edhe mund të funksionalizohen, për shembull - pas 5 viteve. Tek e fundit, decentralizimi i plotë me ruajtjen e unitaritit të shtetit ishte dhe kompromis i Marrëveshjes së Ohrit, por që nuk realizohet kjo. Psenë duhet ta thonë partitë që janë dhe ishin në pushtet. Ende kemi komuna që nuk kanë as një çerdhe e as qendra kulturore, as rrugë lokale... plus dhe janë në borxhe ose nuk kanë resurse për tu zhvilluar. Këto komuna mendoj se duhet bashkangjitur komunave që kanë si qendër qytetet", thekson Zendeli.



Aziri: Nuk e kemi ndërmend të ikim!

Shkup, 5 dhjetor - Tre nga katër të akuzuarit për rastin "Monstra" në shoqëri të avokatit të tyre Naser Raufi sot erdhën në Gjykatën Penale në Shkup që të paraqiten në pajtueshmëri me vendimin e Gjykatës Supreme. Pas paraqitjes, i akuzuari Haki Aziri deklaroi se nuk e kanë ndërmend të ikin askund, sepse presin që e vërteta të del në pah. "Ne nuk e kemi ndërmend të ikim askund. Do të paraqitemi me rregull ashtu siç e përcakton ligji", tha Aziri. I pyetur se kur pritet të fillojë gjykimi i ri, tha se ai nuk e di dhe se pritet që atë ta përcaktojnë avokati dhe gjyqi. Ndryshe, të premten Gjykata Supreme vendosi të lirojë katër të akuzuarit për rastin "Monstra" dhe të njëjtit të qëndrojnë në paraburgim shtëpiak, si dhe të paraqiten dy herë në javë në gjykatën Penale. Të akuzuarit, katër nga gjashtë të akuzuar, në burg kanë qëndruar 5 vite e shtatë muaj.

KATIMERINI KOMENTON DEKLARATËN E HERBERT MAKMASTERIT

SHBA KTHEHET NË BALLKAN

"SHBA-ja i mbështet aspiratat euro-atlantike të vendeve të rajonit për integrimin në NATO dhe BE, që të shpejtohen reformat dhe të përforcohet stabiliteti edhe në këto korniza, ngushtë i ndjekin negociatat e Athinës dhe të Shkupit në çështjen për emrin e IRJM-së", shkruan "Katimerini"

Athinë, 5 dhjetor - Vizitën në Uashington të ministrave të punëve të jashtme të vendeve të rajonit, gazeta greke "Katimerini" e komenton si hapa të parë për kthimin e SHBA-në në Ballkan. Në tekst, korrespondentja e gazetës nga Uashingtoni, e transmeton deklaratën e këshilltarit për siguri nacionale të Trumpit, Herbert Makmaster, se rajoni është prioritet i lartë për SHBA-në, diçka që sipas analistëve, "nuk ishte e dukshme në vitet e fundit". Gazeta e përmend edhe shqetësimin e amerikanëve për ndikimin e madh rus në rajon, në periudhën kur Ballkani merr rëndësi gjithnjë e më të madhe strategjike për Evropën për shkak të pozitës kyçe për luftën me terrorizmin dhe kontrollin e migrimit. Duke i analizuar deklaratat e funksionarëve amerikanë, gazetaria shkruan se SHBA-ja dëshiron ta përforcojë bashkëpunimin me vendet e rajonit, ndërsa e transmeton edhe deklaratën e Reks Tileron, se Uashingtoni do të bashkëpunojë me BE-në për stabilitet, paqe dhe prosperitet në vendet e Ballkanit Perëndimor. "SHBA-ja i mbështet aspiratat euro-atlantike të vendeve të rajonit për integri-



min në NATO dhe BE, që të shpejtohen reformat dhe të përforcohet stabiliteti edhe në këto korniza, ngushtë i ndjekin negociatat e Athinës dhe të Shkupit në çështjen për emrin e IRJM-së", shkruan "Katimerini". Sipas gazetës, në administratën amerikane, me agjendën për Ballkanin Perëndimor tashmë merren nënpresidenti Majk Pens dhe sekretari shtetëror për mbrojtje Xhejms Matis, por edhe përfshirja e gjeneralit Makmaster, siç shkruan "Katimerini", është e rëndësishme të ekzistojë strategji

e qartë. "Në rajon, si protagonistë të rinj paraqiten ndihmës sekretari i ri shtetëror për Evropën, Ves Miçel, i cili sipas informacioneve, merr drejtim dhe propozime të shpejta ta vizitohet rajonin. Edhe përfaqësues të tjerë zyrtarë janë lojtarët kryesorë, siç është zëvendës ndihmës sekretari shtetëror Hojt Brajan Ji, i cili e njeht Ballkanin dhe pritet të shpejti të kthehet në rajon si ambasador në Shkup ose në Tiranë", thekson korrespondentja e "Katimerini"-t nga Uashingtoni. Nënkryetari i Këshillit atlantik në

Uashington, Dejmon Uilson, për gazetën greke thotë se Greqia do të mund të luajë rol të veçantë në rajon me ringjalljen e Agjendës së Selanikut për Ballkanin Perëndimor nga viti 2003. "Uilson mendon se riaktivizimi i SHBA-së duhet të zhvillohet në bashkëpunim të ngushtë me Athinën. Pothuajse 15 vjet pas deklaratës në Selanik dhe pasi disa vende rrezikuan ta humbin orientimin e tyre, propozon ripërtëritjen e tyre edhe atë në bazë transatlantike", shkruan gazeta në analizën e gjerë.

BE E INTERESUAR PËR BALLKANIN PERËNDIMOR

Bashkimi Evropian është i interesuar që gjashtë vendet e Ballkanit Perëndimor të bëhen pjesë e familjes evropiane, deklaroi përfaqësuesja e lartë e BE-së për Politikë të Jashtme dhe Siguri, Federika Mogerini. "Unë nuk mendoj se Bashkimi Evropian do të ketë 27 vende anëtare në të ardhmen, por mendoj se numri i tyre do të jetë më i madh", tha Mogerini në një intervistë për televizionin Euronjuz. Ajo theksoi se pret që deri në fund të mandatit të tanishëm të Komisionit Evropian pas dy vjetësh, BE do të bëjë përpunim në marrëdhëniet me gjashtë

vendet e Ballkanit Perëndimor. "Progres i cili nuk do të vihet në dyshim. Unë me të vërtetë e besoj këtë", tha Mogerini. Sipas saj, interesi i Brukselit për anëtarësimin e vendeve të Ballkanit Perëndimor në BE është i lidhur me arsye të sigurisë dhe arsye ekonomike. "Natyrisht, fillimisht të gjitha reformat e nevojshme duhet të zbatohen. Në shoqëritë dhe në institucionet politike duhet që të bëhen ndryshime të mëdha. Liderët politikë dhe qytetarët në rajon janë të përgatitur për këtë", tha Mogerini në intervistë.

OSMANI VAZHDON VIZITËN NË TALIN TË ESTONISË

2018-a, vit historik për Maqedoninë

Talin, 5 dhjetor - Zëvendëskryetari i Qeverisë përgjegjës për Çështje Evropiane, Bujar Osmani, në kuadër të vizitës së tij në Republikën e Estonisë, realizoi një sërë takimesh me përfaqësues të lartë të vendit mes të cilëve edhe me Klen Jarac, drejtor i zyrës për Çështje Evropiane në Qeverinë e Republikës së Estonisë, si dhe me Erik Nils Kros, kryetar i grupit parlamentar mes Republikës së Maqedonisë dhe Republikës së Estonisë. Në takime u hapën tema për bashkëpunim dypalësh mes Maqedonisë dhe Estonisë, bashkëpunimin rajonal në kuadër të vendeve të Ballkanit Perëndimor, si dhe zgjerimin e Bashkimit Evropian me vendet e rajonit. Theks të veçantë iu vu bashkë-



punimit të parlamenteve kombëtare në kuadër të grupit parlamentar mes Maqedonisë dhe Estonisë, si dhe avancimit të marrëdhënieve mes dy vendeve. Në kuadër të takimeve, Osmani potencoi marrëdhëniet e mira dypalëshe të cilat janë në drejtim të mbështetjes së procese-

veve tona euro-atlantike nga ana e Estonisë. Osmani potencoi energjinë e re politike në drejtim të optimizimit evropian, e cila u krijua me formimin e Qeverisë së re në Maqedoni, të cilën qytetarët e konfirmuan edhe në zgjedhjet e fundit lokale. "Viti 2018 paraqet vit

historik për Republikën e Maqedonisë për çështjet tona eurointegruese dhe për këto ambicie presim mbështetje nga Estonia" theksoi Osmani. Në takime u hapën edhe çështjet e menaxhimit me sfidat evropiane, siç janë lajmet e rreme, zbulimi i populizmit radikal, nacio-

nalizmi, ndikimi gjeopolitik nga Lindja, sfidat e krizës së emigrantëve etj. U konstatua se gjitha sfidat rajonale dhe evropiane në Ballkan duhet të zgjidhen në drejtim të vlerave evropiane, por më mirë, me përforcimin e perspektivave evropiane të rajonit, si dhe mbajtjen e besueshmërisë së procesit të zgjerimit. Gjatë bisedimeve bashkërisht u konstatua se roli i parlamenteve nacionale dhe Parlamentit Evropian janë të rëndësishme së veçantë për procesin e zgjerimit, si dhe për reformat e reja politike të BE-së. Paraprakisht, në kuadër të vizitës në Estoni, zëvendëskryeminstri Osmani realizoi takim edhe me ministrin e Punëve të Jashtme të Estonisë, Sven Mikser.

FILLOI GJYKIMI PËR RASTIN "TOTAL"

LLATASI RREZIKOHET ME 4 VITE BURG

Gjykatësja e rastit, Sofçe Gavrillova Efremova, me fillimin e seancës gjyqësore, tha se të akuzuarit kryesor Llatas, në rast të vërtetimit të propozim-akuzës nga PSP, i rrezikohen dënime me burg në kohëzgjatje prej katër viteve

Koha

Omer XHAFFERI

Shkup, 5 dhjetor - Nën akuzën për fshehje të tatimit, gazetari Dragan Pavilov Llatas, të martën u paraqit në Gjykatën Penale të Shkupit. Krahas të dyshuarit kryesor në rastin "Total", të cilin e përfaqëson Prokuroria Speciale Publike, në këtë seancë duhej të paraqiten edhe personat juridik të kompanive "Total Marketing" dhe "Total Media Centar", pronar i të cilëve është regjistruar gazetari Llatas. Gjykatësja e rastit, Sofçe Gavrillova Efremova, me fillimin e seancës gjyqësore, tha se të akuzuarit kryesor Llatas, në rast të vërtetimit të propozim-akuzës nga PSP, i rrezikohen dënime me burg në kohëzgjatje prej katër viteve. Ndërkohë, duke e sqaruar arsyen se pse nuk janë plotësuar kushtet për vazhdimin e mëturjes së këtij procesi gjyqësor, ajo tha ftesat të cilat u janë dërguar dy personave juridik, në gjykatë janë kthyer nën arsyetim se dërgesa ka qenë jo e rregullt. "Kompanive 'Total Marketing' dhe 'Total Media Centar' dy herë radhazi, në fshatin Zelenikovë u kemi dërguar ftesa, megjithatë nuk gjetëm asnjëri dhe kështu nuk arritëm që me rregull t'i dorëzojmë ftesat. I akuzuari kryesor deri më sot është dashur t'i caktojë personat juridik të kompanive, por ai këtë gjë nuk e ka bërë me arsyetim se ka ndalesë për iniciimin marrëdhënies së punës. Duhet të theksohet se ndalesa e tij ka të bëjë në pjesën e veprimeve afariste, dhe assesit në

caktimin e avokatëve", tha gjykatësja Gavrillova Efremova. Me këtë rast, pasi e caktoi seancën e radhës për më 7 dhjetor - gjykatësja tha se nëse i akuzuari i parë nuk i cakton avokatët, atëherë në bazë të detyrës zyrtare - këtë çështje do ta rregullojë vetë gjykata. Trupi gjykues në rastin "Total" theksoi se vetë i akuzuari i parë (në këtë rast gazetari Llatas), zyrtarisht ka kërkuar që përzgjedhjen e avokatëve, gjegjësisht caktimin e tyre ta bëjë ai vetë, por deri më sot, ai ende nuk ka zgjidhur këtë çështje. Ftesa për pre-

zencë në seancë gjyqësore, siç tha gjykatësja Gavrillova Efremova, nuk i ka arritur edhe kompanisë "Mediamaks", e cila është pjesë e propozim-akuzës për rastin "Total". "Në adresën e apostrofuar të kësaj kompanie, ne nuk arritëm të shohim asnjë shenjë, apo tabelë e cila asocion se aty funksionon një firmë", tha shkurtë gjykatësja Efremova, e cila shtoi se më pas - ftesa i është dërguar personit juridik, Petar Veljanovski, i cili me adresë jeton në Ohër. Mungesën e tij në këtë seancë ky i akuzuar e ka paralajmëruar ditë më parë përmes shkresës zyrtare deri te Gjykata, me arsyetim se për shkak të obligimeve tjera, nuk do të mund të paraqitet në seancë. Pala mbrojtëse e të akuzuarit Llatas, afatin prej dy ditësh për të caktuar avokatë për kompanitë tjera e vlerësoi si tejet të shkurtër, por gjykatësja ishte e vendosur se nuk ka më tepër kohë për të pritur. Me këtë rast, avokatja Svetlana Saviq, duke e ironizuar paraqitjen tepër serioze të gjykatësës, tha se në këtë mënyrë si ka filluar seanca, mungon vetëm shpallja e aktgjyqimit dhe ky proces të përfundojë. Kërkesë tjetër e avokates Saviq, në emër të të akuzuarit Llatas, ishte refuzimi i "bombave" që të përdoren si dëshmi në këtë proces gjyqësor. Mirëpo, gjykatësja edhe kësaj radhe ishte e prerë se këtë çështje paraprakisht e kanë rregulluar gjykatësit, të cilët e kanë vlerësuar propozim-akuzën. Ndryshe, i akuzuari Llatas, pas daljes nga Gjykata, para gazetarëve paraqitjen e gjykatësës e vlerësoi si tepër të ashpër, me çka bëri paralele mes procesit gjyqësor që zhvillohet kundër kryeministrit Zoran Zaev dhe tij, respektivisht nënvizoi se të drejtat e të akuzuarve nuk janë të barabarta. Po ashtu, ai theksoi se nuk mundet të caktojë avokat brenda këtyre dy tre ditëve, derisa gjykata nuk ia largon ndalesën për menaxhim me kompanitë.



Tre në Shutkë, tre në arrest shtëpiak

Shkup, 5 dhjetor - Në Shutkë, në paraburgim kanë përfunduar tre deputetët e VMRO-së, të cilësuar si kryesorë në hapjen e dyerve për hulgjanët maqedonas natën e 27 prillit - Kërsto Mukovski, Sasho Vasilevski dhe Luben Arnaudov, derisa paraburgim shtëpiak kanë marrë deputetët Johan Tarçulovski, Zhaklina Peshevska dhe Ljupčo Dimovski. Kështu vendosi të martën Trupi gjyqësor i

Gjykatës Penale të Shkupit, ndërkohë që gjatë tërësorishtë marrë në pyetje gjashtë deputetët e VMRO-së, të akuzuar për "terrorizëm". Një deklaratë të shkurtër për mediat para hyrjes në gjykatë dje dha vetëm deputeti Mukovski, i cili tha se shikuar juridikisht, sipas tij, nuk ka argumente për paraburgim, por, siç theksoi, ia lë gjyqit që të vendosë për atë dhe beson në të. Ndryshe, gjashtë deputetët

janë pjesë e 36 personave të cilët Prokuroria Themelore Publike i përndjek për "rrezikim terrorist të rendit kushtetues dhe të sigurisë" lidhur me ngjarjet e 27 prillit të këtij viti në Parlamentin e Republikës së Maqedonisë. Të premtën, Parlamenti i Republikës së Maqedonisë ua hoqi imunitetin, ndërsa njoftimi në Gjykatën Penale nga Parlamenti arriti një ditë më parë, ku iu dorëzua gjykatës-



sve kompetentë në procedurë paraprake, me çka u krijuan kushte që të veprohet rreth propozimit të prokurorisë. (O.Xh)

KRONIKË

Me pistoletë kërcënohet plaku nga Tetovë

65 vjeçari J.J nga Tetova, të hënën, ka denoncuar se rreth 16 është kërcënuar nga 40 vjeçari B.R nga Tetova. Sipas policisë së Tetovës, gjysmë ore para denoncimit, kur 65 vjeçari ka dalë nga shtëpia ku ka jetuar, ai ka vërejtur 40 vjeçarin me pistoletë në dorë në drejtim të tij. I frikësuar për jetën e tij ai ka filluar të ikë. Pas një kohe, kërcënuesit i ka rënë pistoletë, ka hyrë brenda në veturën Volsfagen Pasat, ku ka pasur edhe dy persona tjerë, dhe janë larguar në drejtim të panjohur, ndërkohë që ka pasur edhe një fjalosje me vëllain e të kërcënuarit për disa borxhe. Janë marrë masa për zbardhjen e plotë të rastit.

Arrestohet shtetasja nga Serbia

Në orët hershme të ditës së martë është arrestuar shtetasja e Serbisë A.N., 29 vjeçare, e cila e ka keqpërdorur qëndrimin turistik, përndryshe ka qëndruar në Tetovë në kundërshtim me ligjet në fuqi për shtetas të huaj. Shtetasja e Serbisë, sipas Sektorit për Punë të Brendshme në Tetovë, pas arrestimit dhe mbajtjes së shkurtër në Stacionin Policor në Tetovë, është dërguar në Njësinë për Kriminalitet Ndërkufitar, migracion, të huaj dhe riatdhesim për procedurë të mëtejshme.

Hajnat vjedhin dhe sulmojnë pronarin

Katër persona të panjohur të maskuar me kërcënime dhe me armë mbrëmë rreth orës 20:00 kanë hyrë në shtëpinë e B.S. (24) në rrugën "Mendelieva" në Shkup. Siç informon sot MPB-ja, vjedhësit e kanë lidhur B.S. e kanë goditur me armë në kokë, pas çka kanë bërë bastisje nëpër shtëpi. Para nëpunësve policorë B.S. ka deklaruar se nuk mund të thotë çka i është vjedhur. SPB Shkup merr masa për gjetjen e autorëve dhe për zbardhjen e plotë të rastit.

Paraburgim për 7 persona për prodhim dhe shitje të drogës

Paraburgim 30-ditor u është caktuar shtatë personave të dyshimta nga grupi i organizuar i zbuluar kriminel ndërkombëtar, të cilin policia e ka zbuluar më 30 nëntor dhe 1 dhjetor se në mënyrë të paautorizuar ka prodhuar dhe shitur "droga sintetike" në rrethinën e Tetovës. Prokuroria Themelore Publike për ndjekje të krimit të organizuar dhe korrupsionin, solli Urdhër për procedurë hetuese kundër dy shtetasve të Republikës së Serbisë dhe pesë shtetas të Maqedonisë, të akuzuar se kanë kryer vepër penale, prodhim të drogave narkotike, dhe substancave të tjera nga neni 215 nga Kodi Penal Për të gjithë shtatë të akuzuarit me propozim të prokurorit publik përgjegjës nga Prokuroria Themelore Publike për krim të organizuar dhe korrupsion nga ana e gjyqtarit për procedurën paraprake u është caktuar masa e paraburgimit për 30 ditë. (U.H)

NIS PROCESI PËR NDRYSHIME NË PROGRAMET MËSIMORE

Më 30 nëntor të këtij viti, ka nis edhe zyrtarisht procesi për ndryshime në lëndën e mësimit qytetar, respektivisht shkrijes ose shpërndarjen e lëndës Edukimi Qytetar në lëndë të tjera.

Koha Laura PAPANIKU

Shkup, 5 dhjetor - E kontestuar fillimisht nga përmbajtja që kishte në tekstet shkollore, lënda e Edukimit Qytetar pritet të pësojë edhe ndryshime të tjera thelbësore. Ministria e Arsimit dhe Shkencës (MASH), është duke kërkuar forma të reja të mësimit qytetar, konkretisht shkrijen e saj në ndonjërin prej lëndëve tjera të shkencave shoqërore ose edhe shpërndarjen e njësive mësimore në më tepër lëndë. Se cili variant do të ofrohet për vitin e ardhshëm shkollor, 2018/2019, do ta varet nga përcaktimi i një Grupi të veçantë pune, i cili është formuar enkas për këtë qëllim. Shkrijja apo shpërndarja e kësaj lënde, në fakt nënkupton shpërndarjen e njësive mësimore (të lëndës së tanishme) nëpër lëndë të tjera, e me çka MASH do të arrijte njëkohësisht edhe të caktojë për shkarkimin e shkollave nga numri i tepërt i lëndëve mësimore. Zvogëlimi i lëndëve mësimore është premtuar vazhdimisht nga partia më e madhe qeveritare, LSDM-ja si dhe nga ministria e radhëve të saj, Renata Deskovska.

Në fakt, Deskovska, veç më nisi ta ushtrojë postin e ministres së Arsimit me nxjerrjen e vendimit për largimin nga përdorimi të tekstit shkollor nga lëndën e Edukimit Qytetar, në fillim të vitit shkollor 2017/2018. Libri i larguar për shkak të qasjeve konservatore dhe mungesës gjithëpërfshirëse, në njësinë mësimore ku flitet për familjen,



LËNDA QYTETARE DO TË SHKRIHET NË LËNDË TJERA

nuk është zëvendësuar ende me libër të ri. MASH as që ka hapur konkurs për përpilimin e ndonjë teksti të ri shkollor për këtë lëndë, pasi largimi i tij koicidoi me periudhën kur në MASH u ndër morën hapa për reforma gjithëpërfshirëse në arsim. Kjo, sikurse ka shpjeguar vetë ministria, "nënkupton edhe ndryshimin e programit mësimor dhe të teksteve për lëndë të caktuara".

Lënda e Edukimit Qytetar, ka qenë çdo herë në shënjestër të kritikave. Përveç kësaj, sqarohen në MASH edhe gjatë konsultimeve me grupet e punës për reforma në arsimin fillor dhe të mesëm, janë kërkuar ndryshime për këtë lëndë.

Prandaj, thonë ato, MASH e ka parë të arsyeshme që të mos bëhen shpenzime të cilat mund të rezultojnë të kota. "Meqë mendimi i shumicës është për ri-konceptimin e

mësimit qytetar, logjikisht i bie që të jetë i panevojshme edhe përpilimi i cilitdo libër që do të bazohet në programin e tanishëm mësimor të kësaj lënde". Në kontekst të kësaj,

AKREDITIMI DHE VLERËSIMI I ARSIMIT, DO TË JENË TË NDARA

Ligji i ri për arsim të lartë është gati dhe deri nga fundi i muajit do të vendoset në ENER (regjistrin elektronik të rregullave ener.gov.mk), tha të hënën ministria Renata Deskoska në fjalimin hyrës në konferencën rajonale kushtuar sigurimit të cilësisë në arsimin e lartë. Një nga risitë të cilat propozohen është ndryshimi në funksionimin e Këshillit për akreditim dhe vlerësim të arsimit të lartë, respektivisht ndarjen e tij në dy organe. Deskoska tha se MASH është e kënaqur nga shumë propozime të marra nga institucione të ndryshme - universitete, studentë dhe

nga Plenumi i profesorëve dhe se nga të gjithë ata ka dalë konsensus i gjerë - se Këshilli për akreditim dhe vlerësim ashtu siç është tani, nuk jep mundësi që t'i përkushtohet mjaft vëmendje procesit të vlerësimit, respektivisht matjes së cilësisë, por më shumë përqendrohet në procesin e akreditimit. Ajo tha se një nga parimet në të cilat bazohen sistemet arsimore evropiane për rritjen e cilësisë është respektimi i autonomisë së Universitetit, e cila është shkelur nga pushteti paraparak me qëllim të avancimit të cilësisë në arsimin e lartë.

XHIROLLOGARIA E NGRIRË DERI NË FUND TË VITIT

TEATRI I TETOVËS I BLOKUAR NGA BORXHET

Koha Evis HALILI

Shkup, 5 dhjetor - Xhirollogaria e Teatrit të Tetovës vazhdon të jetë e bllokuar. Jo vetëm shfaqjet e tjera që nuk janë realizuar sipas Programit të paraprirë nga ky institucion, por edhe Edicioni i gjashtë i Festivalit Ndërkombëtar Teatror është anuluar për shkak të borxheve. Janë rreth tre milionë denarë borxhe të akumuluar që prej vitit 2013, por që rezultuan me pezullimin e aktiviteteve, në mënyrë që shuma të mos rritej. Kështu thotë Blerta Mamuti, ushtruese detyre e drejtorit në Teatrin e Tetovës. Pjesa më e madhe e faturave që duhen likuiduar janë për Agjencinë për të drejtat autoriale, kryesisht honorarë.

"Që me ndryshimin e drejtorit, xhirollogarinë e patëm të bllokuar dhe ashtu vazhdon të jetë. Ministria e Kulturës nuk lejoi që të kryhen aktivitete. Duhet të bëhen këto pagesa deri në fund të vitit, në



Jo vetëm shfaqjet e tjera që nuk janë realizuar sipas Programit të paraprirë nga ky institucion, por edhe Edicioni i gjashtë i Festivalit Ndërkombëtar Teatror është anuluar për shkak të borxheve

mënyrë që mos të grumbullohen edhe borxhe të tjera", thotë Mamuti. Sipas drejtoreshës, obligimet financiare ndaj firmave të ndryshme nuk kanë arritur të bëhen në kohë, pasi edhe pagesat nga Ministria e Kulturës nuk janë bërë kur duhet. Si pasojë, Teatri i Tetovës ka realizuar gjithsej vetëm dy shfaqje nga programi i këtij viti, një nga ansambli shqiptar dhe një nga ai i Dramës Maqedonase. Për progra-

min e këtij viti ka konkurruar me dhjetë projekte, realizimi i të cilave do të varet nga likuidimi i borxheve. "Ministria ka premtuar se kjo shumë do të shlyhet deri në fund të këtij viti. Kushtet janë ashtu si edhe vitet e tjera në këtë periudhë dimri, pa ngrohje qendrore, vazhdojmë të funksionojmë në një situatë tashmë të ngjashme, si qiraxhinj", thotë Mamuti. Ajo për të cilën ky institucion nuk ka mungesa janë aktorët, stafi i të cilëve është i kompletuar. Me ndryshimin që në të ardhmen të punësohen më shumë aktore, potencon drejtoresha. Sa i takon regjisorëve, dramaturgëve, e të tjerë ky institucion nacional funksionon me mungesa, në një situatë të ngjashme me Teatrin Shqiptar të Shkupit. Teatri i Tetovës këtë vit mbushi dhjetë vjet që nga themelimi si institucion nacional, por si pasojë e kushteve ku funksionon, në Qendrën e Kulturës, në të jepen shfaqje varësisht kushteve

MASH ka angazhuar Byronë për Zhvillimin e Arsimit (BZHA) të planifikojë ndryshimet në koncepcionet e përgjithshme të arsimit fillor dhe të mesëm, si dhe në programet e veçanta mësimore, sipas lëndëve të caktuara. Më 30 nëntor të këtij viti, ka nis edhe zyrtarisht procesi për ndryshime në lëndën e mësimit qytetar, respektivisht shkrijes ose shpërndarjen e lëndës Edukimi Qytetar në lëndë të tjera. Në takimin me përfaqësues të Ministrisë, Byrosë, Qendrës për arsim profesional dhe Qendrës Maqedonase për Arsim Qytetar, ministria ka nënvizuar se rëndësinë e përfortimit të përmbajtjeve mësimore nga kjo lëndë. "Nxënësit duhet të venë në praktikë dijet e tyre përmes aktiviteteve mësimore dhe jashtë mësimore me forcimin e kulturës qytetare dhe sjelljes demokratike", vlerëson ministria. Grupi i punës, sikurse bëjnë të ditur nga MASH, përveç përfaqësuesve nga institucionet e lartpërmendura përbëhet edhe nga profesor universitar dhe përfaqësues të sektorit civil. Ky proces është mbështetur nga USID, konkretisht nga projekti për integrim ndëretnik të të rinjve në arsim, nga Fondacioni i fëmijëve "Pestalloci" e Zvicrës përmes Projektit për përfortim të bashkëpunimit multietnik në komuna.

MODERNIZOHEN PIKË PAGESAT RRUGORE

NUK KA MË PRITJE NË AUTOSTRADË



Deri në fund të vitit të ardhshëm pritet të përfundon instalimi i sistemit për pagesë elektronike të taksës rrugore përgjatë Korridorit 10. Furgonët do të paguajnë në bazë të numrit të udhëtarëve, ndërsa do të dënohet çdo mbipeshë e kamionëve

Koha

Fisnik PASHOLLI

Shkup, 5 dhjetor - Në fund të vitit 2018, pritet të merr fund humbja e kohës për pagesën e taksave në autostradën Kumanovë-Gjergjeli. Vozitësit pritet që pagesën ta kryejnë përmes kartelave elektronike, vetëm duke zvogëluar shpejtësinë dhe pa ndalesa. Menaxhmenti i ri i "Rrugëve të Maqedonisë", paralajmëroi se deri në fund të vitit të ardhshëm pritet të përfundon instalimi i sistemit për pagesë elektronike të taksës rrugore përgjatë Korridorit 10. Në ndërkohë, në pikë-pagesat e tjera në Korridorin 8 po ndryshohen kabinat, ndërsa në këtë aks rrugor planifikohet që të vendoset opsioni i pagesës me softver të ri dhe kategorizim të mjeteve transportuese. Kjo do të mundësojë qarkullim më të shpejtë të veturave dhe ndalim minimal në pikë-pagesat e ndryshme. Sistemi i ri elektronik i pagesës me kartelë pripejd përgjatë korridorit 10 do të vendoset gradualisht, ndërsa me rritjen e përdorimit të kartelave do të përjashtohet pagesa me kesh në dorë. Paralajmërohet edhe kategorizimi i mjeteve transpor-

tuese përgjatë Korridorit 8 dhe 10, që nënkupton se, furgonët, për shembull, do të paguajnë në varësi prej numrit më të madh apo më të vogël të udhëtarëve që i transportojnë. Gjithashtu paralajmërohen edhe dënime rigoroze për transportuesit, te të cilët do të konstatohen se bartin mall me peshë më të madhe se sa lejohet me ligj. Në ndërkohë, me projektin për pagesën elektronike që duhej të jetë gati deri në fund të vitit 2016, duhej të modernizohen më shumë pikë-pagesa në autostradën Kumanovë-Gjergjeli. Projekti kushton afër 19 milionë euro dhe financohet me 15 milionë euro nga Banka Evropiane për Zhvillim dhe Rindërtim, ndërsa pjesa e mbetur janë të holla buxhetore. Deri tani është ndërtuar vetëm pikë-pagesa në Ramanli, ndërsa të tjerat pritet të finalizohen deri në fund të vitit 2018, për shkak të vonësve administrative në të kaluarën, ndërsa me lëshimin së fundmi të lejeve ndërtimore, pritet të intensifikohet ndërtimi i tyre, thonë nga Ndërmarrja Publike "Rrugët e Maqedonisë".

"Pas lejeve të miratuara punohet intensivisht në pikë-pagesat rrugore

Petrovec, Sopot, Otavica dhe Gradsko dhe në varësi prej dinamikës së ndërtimit si dhe procedurave, si pranimi teknik, pritet që për tetë muaj ato të jenë gati. Mund të pritet që projekti të rrumbullakohet deri në fund të vitit të ardhshëm. Nga ana tjetër, pikë-pagesa e ndërtuar në Ramanli, nuk mund të lëshohet në përdorim për shkak se duhet të zgjidhen dy ekspropriime të tokës që janë paraqitur gjatë ndërtimit të saj, ndërsa duhet të ndryshohet edhe softveri i pagesës që të parashikohet opsioni i pagesës në kesh në fazën kalimtare, që nuk është marrë parasysh aspak si opsion gjatë planifikimit të projektit", thotë për MIA, Zoran Kitanov, drejtori i Ndërmarrjes publike "Rrugët e Maqedonisë". Sipas tij, do të vendoset pikë pagesë rrugore edhe te dalja për Prilep në afërsi të rrugës Negotinë-Kavadar. Planifikohen edhe pikë pagesa të reja në autostradën Miladinovci-Shtip dhe Kërçovë-Ohër. Sistemi i ri do bëjë edhe kategorizimin e mjeteve transportuese përgjatë Korridorit 8 dhe 10. Kjo, me fjalë të tjera, nënkupton se në aksin rrugor Shkup-Ohër dhe Kumanovë-Gjergjeli, furgonët, për

shembull, do të paguajnë në varësi prej numrit më të madh apo më të vogël të udhëtarëve që i transportojnë. Si pjesë e aktiviteteve të planifikuara për pengimin e dëmtimit të rrugëve, Kitanov paralajmëron dënime rigoroze për transportuesit te të cilët do të konstatohen se bartin mall me peshë më të madhe se sa lejohet me ligj. "Kemi kryer matje teknike të urave, ku mbi 50 për qind e kamionëve kanë qenë me mbingarkesë, ndërsa pesë kamionë kanë qenë me peshë prej 72 tonë.

Në aksion me Ministrinë e Brendshme do të ketë dënime rigoroze në rast të transportimit të mallrave me mbipeshë", thekson Kitanov. Gjithashtu, me projektin për vlerësimin e rrugëve, për një vit pritet të fitohet një pasqyrë e tërësishme për nivelin e dëmtimit të pjesëve të caktuara të akseve rrugore dhe në bazë të kësaj do të përcaktohen edhe prioritetet për rikonstruimin e tyre. Në rrugët nëpër Maqedoni, dy vetura me pajisje të veçantë, do të kryejnë matje deri në një metër e gjysmë në tokë, nga shtresa e tamponuar deri në glazurën e asfaltit.



Si pjesë e aktiviteteve të planifikuara për pengimin e dëmtimit të rrugëve, Kitanov paralajmëron dënime rigoroze për transportuesit te të cilët do të konstatohen se bartin mall me peshë më të madhe se sa lejohet me ligj

KOMISIONI PËR BUXHET DHE FINANCIM VAZHDON ME PUNË

Debat pa deputetët e VMRO-së

Shkup, 5 dhjetor - Komisioni për financa dhe buxhet të martën vazhdoi seancën, në të cilën anëtarët e Komisionit në pesë ditët e ardhshme do të debatojnë rreth Propozim-buxhetit për vitin 2018. Pas shumë seancave të caktuara nga kryetarja e Komisionit, Liljana Kuzmanovski, deputete e VMRO-së, ajo sërish të njëjtën e anuloi, për të filluar më pas me propozim të deputetit të LSDM-së, Vasko Kovačevski, i cili në mungesë të kryeparlamentarit, nisi seancën për Buxhetin. Me këtë rast, Kovačevski u dha fjalë anëtarëve të Komisionit, ku të pranishëm ishin deputetët e LSDM-së, BDI-së, të Lëvizjes BESA dhe partisë Aleanca për

Shqiptarët, por jo edhe deputetët e VMRO-së. Debatit rreth buxhetit të propozuar, sipas Rregullores, në Komision zgjatë 10 ditë pune. Që të respektohen afatet për miratimin e propozim-buxhetit, Komisioni ka kohë që pesë ditët e ardhshme të shqyrtojë amendamentet e dorëzuara nga deputetët e VMRO-së, kuptohet nëse ndonjëri nga deputetët e VMRO-së do të arsyetojë dhe mbrojë amendamentet e dorëzuara. "Pavarësisht se seancat janë anuluar edhe ditët që nuk është mbajtur seanca përfshihen në afatin e caktuar prej 10 ditëve, kështu që deri të dielën do të punojë Komisioni ku dhe do të miratohet propozim-buxheti dhe

i njëjti do t'i kthehet Qeverisë dhe pas dy ditëve, qeveria Buxhetin duhet ta dorëzojë në Parlament për miratim", tha Kovačevski. Seanca e parë plenare, tha Kovačevski, do të caktohet më 13 dhjetor dhe pas pesë ditëve debat, deputetët duhet të votojnë miratimin e buxhetit për vitin 2018. Kovačevski njëherësh u bëri thirrje deputetëve të VMRO-së të paraqiten në sallë dhe seancat t'i udhëhojë kryetarja Kuzmanovska, duke sqaruar se në rast se askush nga VMRO nuk paraqitet në mbledhje, atëherë obligim i të pranishmëve është që t'i lexojnë amendamentet e parashtruar nga VMRO-DPMNE. (Z.V)

Në Batincë zbulohet depoja e drogave sintetike

Shkup, 5 dhjetor - Krahas laboratorit në Tetovë për prodhimtari të drogës sintetike, është zbuluar edhe hapësirë deponeuese në fshatin Batincë, në afërsi të Shkupit, ku janë deponuar substanca kimike dhe materiale të tjera dhe pajisje për përgatitje dhe prodhimtari të drogës. Ministria e Punëve të Brendshme njoftoi se janë zbuluar dhe konfiskuar automjete, telefona celularë, sim-kartela, armë, municion dhe të tjera. Në vijim është ekspertiza e materialit dhe drogës e cila sipas vlerësimeve fillestare është rreth 125 kilogramë, gjegjësisht minimum mbi gjysmë milionë tableta drogë sintetike. Në aksionin policor janë arrestuar shtatë persona të cilët janë marrë me tregti ilegale me drogë. Midis tyre, ka edhe dy shtetas serbë. Të gjithëve u është caktuar masë paraburgim prej 30 ditësh.

Për rëndësinë e inovacioneve dhe kërkimeve shkencore në zhvillimin dhe përparimin e një shteti, flet edhe Shembulli i Finlandës. Ky shtet para 40 vitesh ka qenë një shtet kryesisht bujqësor, ndërsa sot është vendi i tretë në botë për kah zhvillimi i inovacioneve

Koha Fisnik PASHOLLI

Shkup, 5 dhjetor - Maqedonia është një nga shtete e rajonit që më së paku ndan të holla për veprimtarinë shkencore-hulumtuese. Sllovenia në rajon është lider me 2,2 për qind të Prodhimit të Brendshëm Bruto, ndërsa ne ndajmë vetëm një shifër modeste prej 0,2 për qind të PBB-së, ose diku 16 milionë euro në vit. Kroacia, Bullgaria dhe Serbia ndajnë prej 0,7 deri në 0,8 për qind. Pak më shumë se ne, me 0,3 për qind dhe 0,4 për qind të PBB-së, shpenzojnë Mali i Zi dhe Bosnja e Hercegovina. Për rëndësinë e inovacioneve dhe kërkimeve shkencore në zhvillimin dhe përparimin e një shteti, flet edhe shembulli i Finlandës. Ky shtet, para 40 vitesh, ka qenë një shtet kryesisht bujqësor, ndërsa sot është vendi i tretë në botë për kah zhvillimi i inovacioneve.

Në botën e zhvilluar perëndimore, harxhimet për kërkime shkencore kanë një rëndësi të madhe për shkak se avancimi teknologjik nënkupton produkte dhe shërbime të reja, që sjellin punësim të reja, përmirësim të standardit dhe rritje më të madhe ekonomike.

PAK PARA PËR VEPRIMTARINË SHKENCORE-HULUMTUESE

ME SHIFRA MODESTE S'KA EKONOMI TË ZHVILLUAR



"Për çfarë zhvillimi ekonomik mund të flasim në Maqedoni, kur ndajmë kaq pak mjete për shkencë, ndërsa biznesi ndan bile edhe qindra herë më pak për hulumtim dhe inovacione. Me vite flitet në Maqedoni se duhet të ndahen më shumë mjete për kërkime shkencore, si nga ana e shtetit ashtu edhe nga ana e kompanive, megjithatë një gjë e tillë mbetet vetëm në letër. Mendoj se është koha e fundit, së pari të ngrihet në debat më serioz në in-

stitucione dhe opinion për këtë çështje dhe pastaj nevojitet një planifikim serioz se cilat degët ekonomike kanë prioritet në zhvillimin e shtetit dhe më në fund të ndahen më shumë të holla për këtë. Natyrisht, gjithnjë në bashkëpunim midis biznesit dhe arsimit të lartë",



NERITAN TURKESHI

Mendoj se është koha e fundit, së pari të ngrihet në debat më serioz në institucione dhe opinion për këtë çështje dhe pastaj nevojitet një planifikim serioz se cilat degët ekonomike kanë prioritet në zhvillimin e shtetit dhe më në fund të ndahen më shumë të holla për këtë. Natyrisht, gjithnjë në bashkëpunim midis biznesit dhe arsimit të lartë

më të mirë arsimore si dhe një kujdes të veçantë për të plasuar prodhimet jashtë shtetit.

Problemi i investimit të ulët në zhvillime dhe hulumtime, është prezent në të gjitha shtetet e rajonit si rrjedhojë e ndarjes së pamjaftueshme të mjeteve për këtë qëllim, rolin të paqartë të politikës industriale në strategjitë e zhvillimit ekonomik, strukturës ekzistuese industriale, shkallës së ulët të zhvillimit në arsimin e lartë, lidhjes së

dobët midis teknologjisë dhe shkencës, mungesës së vizionit që të lidhen hulumtimet me nevojat e ekonomisë, si dhe kyçjes më të madhe të eksportuesve lidhur me politikën ekonomike.

Në ndërkohë, edhe shtetet evropiane që ndajnë më shumë mjete për hulumtime, si Suedia dhe Austria, me nivelin prej 3 për qind të PBB-së, megjithatë ngecin në këtë drejtim, pas tigrave ekonomik të Lindjes së largët.

Në Korenë e Jugut, që është ekonomia e 12-të më e fuqishme në botë dhe ku punojnë gjigandët industrial si Samsung, Kia, Hundai, apo punojnë edhe disa nga kantieret më të mëdhenj të ndërtimit të anijeve të mëdha, ndahen afër 4,3 për qind të PBB-së për hulumtime.

Japonia me një ekonomi shumë të zhvilluar ndanë 3,9 për qind të PBB-së për hulumtime, ndërsa Shtetet e Bashkuara të Amerikës, për të cilat as nuk ka nevojë të shpjegohet se çfarë ekonomie dhe universitet të dalluara kanë në rang botëror, ndajnë afër 2,8 për qind të PBB-së. Nga ana tjetër, Gjermania, Danimarka, Finlanda, Belgjika, Franca, Holanda dhe Sllovenia, ndajnë më shumë të holla në BE për hulumtime që lëvizin prej 2 deri 3 për qind të PBB-së në nivel nacional.

ASOCIACIONI I MENAXHERËVE ME VËREJTJE

Kundër ndryshimit të shkallës së tatimit personal

Shkup, 5 dhjetor - Të mos ndryshohet tatimi personal i të ardhurave dhe të mos bëhen ndryshime tek tatimi i fitimit kapital, kërkuan nga Asociacioni i menaxherëve të Maqedonisë në debatin e djeshëm para kryeministrit Zoran Zaev dhe ministrit të Financave, Dragan Tevdovski. "Më së miri është të mos ketë ndryshime. Argumente për atë se shpërblehen mesatarët, ndërkaq biznesi dhe individët e suksesshëm shpërngulen jashtë, posaçërisht frilenserët, paratë locohen jashtë vendit, bëhet shkuarje e kuadrit dhe do të rritet evazioni tatimor", theksuan nga Asociacioni në tribunën e sotme. Marijana Andriq theksoi që të mos ndryshohet shkalla e tatimit personal dhe porositi të shkohet në drejtim tjetër, e jo të llogaritet pragu prej 60.000 denarëve për luks mbi të cilin do të paguhet shkallë

më e lartë. Për Petar Andreevski nga Asociacioni, në Maqedoni nuk ka njerëz të pasur në mënyrë ekstreme, por konsiderohet se mundësia e tillë duhet të jepet. Kryeministri Zaev dhe ministri i Financave Tevdovski porositen se ndryshime në tatimin në Maqedoni duhet të ketë, në mënyrë që të ketë shoqëri të drejtë. "Maqedonia ka një ndër shkallët më të larta të pabarazisë së të ardhurave në Evropë", tha Tevdovski. Vendimet tona për tatim të drejtë janë të matura. Flasi për vendosje të shkallëve tatimote që do të përfshijnë dy për qind të qytetarëve, për të gjithë të tjerët mbetet shkalla e tatimit prej 10 për qind", tha Tevdovski. Sipas tij, ndryshimet tek tatimet duhet të shkojnë së bashku me përmirësimin e efikasitetit të institucioneve. Nuk do të shpejtojmë në reformat, tha kryeministri Zaev, duke

cekur se fokusi tani është më shumë në atë që të përmirësohet pagesa dhe të ulet evazioni tatimor i cili tek TVSH-ja është 30 për qind. "Debat do të zgjasë gjatë vitit të ardhshëm, ndërsa kur të përfundojë dhe kur do të fillojnë reformat, do të dihet se kur do të bëhet i njohur numri i saktë i njerëzve që do të përfshihen dhe cilët saktë do të jenë", tha Zaev. Qëllimi, siç theksoi, është që me reformat të bëhet një shoqëri më e drejtë. Ai theksoi se të ardhurat nga buxheti duhet të arrijnë deri te ato në Evropë ku janë 50 deri 55 për qind, ndërsa tek ne janë 29 për qind të BPV-së. Maqedonia, sipas tij, duhet të përparojë me rritje më të madhe. Zaev në debat i dha mbështetje kërkesës së Asociacionit që të jepen stimulime tatimore për ndërmarrjet që do të transformohen në shoqata aksionare.

Patentë shoferi prej moshës 17-vjeçare

Shkup, 5 dhjetor - Në vend si 16 vjeçarë, tinejxherët kur të mbushin 17 vjeç do të kenë të drejtën për aftësim për drejtimin e automjetit. Kufiri i sipërm lidhur me afatin e patentës së shoferit do të jetë për personat mbi 70-vjeçarë, e jo si deri tani mbi 65-vjeç. Kjo parashikohet në ndryshimet e Ligjit për siguri në komunikacion, i cili miratohet me procedurë të shkurtuar, e të cilat sot janë miratuar në Komisionin e Kuvendit për mbrojtje dhe siguri. Përveç rritjes së moshës për përfitim të drejtës për aftësim për drejtimin e automjetit, propozuesit e ndryshimeve, deputetët e LSDM-së, po ashtu propozojnë edhe heqje të kriterit që tinejxherët të kenë sukses të shkëlqyeshëm dhe sjellje shembullore. Personat mbi 70 vjeç, të cilët do të dëshirojnë ta vazhdojnë patentën e shoferit, do t'i nënshtrohen kontrolleve të obligueshme shëndetësore, ndërsa leja do t'u jepet me vlefshmëri prej tre viteve. Udhëheqësit profesionalë në autoshkollat nuk duhet të posedojnë patentë shoferi për të gjitha kategoritë A, B, C dhe D, por vetëm për kategoritë për të cilat autoshkolla ka licencë. Përveç ndryshimeve të përmendura, parashikohet po ashtu që drejtuesit e traktorëve të jenë mbi 17-vjeçarë, e jo si deri tani 16 vjeçarë.

PASOJAT E VËRSHIMEVE AKOMA NUK EVITOHEN



URA NË POROJ E RREZIKSHME

Koha Urim HASIPI

Tetovë, 5 dhjetor - Që nga vërshimi i lumit të fshatit Poroj në vitin 2015, të cilat shkaktuan dëme të mëdha në fshat, mburojat e urës së këtij fshati që gjendet përgjatë magjistrales, Tetovë-Jazhincë, që për pasojë u shkatërruan tërësisht, ende nuk janë rivendosur. Në këtë urë, e cila krahas mungesës së shenjave dhe mburojave po ashtu e njëjta është e dëmtuar dhe nuk i është nënshtruar riparimeve. Me këtë, automjetet që qarkullojnë janë të ekspozuar ndaj rreziqeve të shumta, sepse nuk ka asnjë garanci apo paralajmërim se sa është qëndrueshmëria e urës ndaj automjeteve të rënda që lëvizin në këtë rrugë. Banorët shprehin shqetësimin e tyre se një pjesë e urës është pa asnjë mbrojtje, kurse rreziku do të jetë më i madh kur do të ketë ngrica. Banorët ankohen që mungesa e

mburojave në këtë urë, paraqet rrezik potencial si për këmbësorët po ashtu edhe për veturat, të cilat qarkullojnë në këtë rrugë, për shkak se kjo rrugë është një ndër rrugët më të frekuentura në Pollog, pasi që lidh edhe Republikën e Maqedonisë me Republikën e Kosovës.

“Për çdo ditë qarkullojmë në këtë rrugë dhe deri tash nuk kemi pasur probleme, por tash e tutje siguria është vënë në pikëpyetje, sepse nuk ka asnjë mbrojtje të vendosur në urën në fshatin Poroj. Duhet që të merren masa sa më shpejtë që të mos ndodhin aksidente apo edhe rënie në lum, si pasojë e mungesës së mbrojtësve përgjatë urës”, thotë Armendi, vozitës.

Nga ana tjetër, kryetari i Bashkësisë Lokale të fshatit Poroj, Sulejman Ramadani thotë se edhe përkundër kërkesave të shumta, të

cilat i janë adresuar ndërmarrjes publike “Rrugët e Maqedonisë”, Komunës së Tetovës dhe Institucioneve të tjera që të ndërmerret diçka në këtë drejtim, gjegjësisht të vendosen mburoja të reja. Këto kërkesa nuk janë përfillur aspak dhe për pasojë e kemi këtë gjendje.

“Kemi bërë kërkesa që tek rrugët e Maqedonisë, që të vendosin sinjalizim, sepse këtu kalojnë këmbësorë dhe fëmijë që shkojnë në shkollë. Fatmirësisht, komuna na ka dhënë një urë në njërin pjesë, por në anën tjetër nuk ka, prandaj edhe kërkojmë që të vendosen mburoja. Në fillim kemi pasur premtime, por nuk është bërë asgjë”, deklaroi kryetari i Bashkësisë Lokale të fshatit Poroj, Sulejman Ramadani. Përveç mburojave mbrojtëse të urës, në këtë pjesë të rrugës mungon edhe sinjalistika rrugore, si shenjat dhe shenjazi-

Banorët shprehin shqetësimin e tyre se një pjesë e urës është pa asnjë mbrojtje, kurse rreziku do të jetë më i madh kur do të ketë ngrica

met, edhe pse në afërsi është edhe shkolla fillore dhe nxënësit për çdo ditë kalojnë nëpër këtë rrugë për të shkuar në shkollë.

“Këtu, përveçse kalojnë automjete, po ashtu kemi edhe fëmijë që qarkullojnë për të shkuar në shkollën e fshatit. Ata nuk kanë asnjë siguri elementare dhe shpesh herë i dërgojnë dhe i marrim ne nga shkolla, sepse kemi frikë për sigurinë e tyre, pikërisht kur e kalojnë urën e pambrojtur”, thotë Imeri, një banorë i kësaj lagje.

Përndryshe, në këtë gjendje siç është ura në këtë fshat, sipas banorëve rreziqet janë të mëdha që të ketë edhe aksidente dhe të rrezikohet seriozisht siguria e drejtuesve të automjeteve të shumta që qarkullojnë në këtë rrugë.



Arslani me librin “Diskursi në kornizë”

Tetovë, 5 dhjetor - Këtyre ditëve doli nga shtypi libri “Diskursi në kornizë” i autorit Artan Arslanit. Ky libër jep një pasqyrë të zhvillimeve shoqërore-politike të fillimshkullit XXI në Maqedoni. Përtej raportimit ditor, ato ruajnë kuintesencën e vrojtimit kritik të ngritjes së institucioneve në shtetin e ri të Maqedonisë, pas pavarësisht nga ish-Jugosllavia, dhe sidomos pas luftës së vitit 2001 dhe arritjes së Marrëveshjes-kornizë të Ohrit, thotë në recensionin e botimit, Nazif Zejnullahu. Të shkruash raportin, kronikën dhe dëshminë, në të njëjtën kohë, kjo është sfida më e preferuar për çdo njeri të penës, sidomos për një gazetar të ri, të mbrojtur me përvoja shumë të afërta të zhurnalistikës shqiptare. Duke paraqitur punën e institucioneve shtetërore, të partive politike dhe të subjekteve të tjera shoqërore, autori Artan Arslani, në fakt, ka bërë një libër në ecje e sipër, gjithnjë duke i parë gjërat nga një distancë, përkatësisht sipas thënies latine “Pushteti më i madh është të zotërosh veten”, nënvizon Zejnullahu, duke shtuar se kushdo që është i interesuar për këtë periudhë kohore, mund të qëmtojë shumë të dhëna, të paraqitura këtu, por dhe nga “zotërimi i vetvetes”, gjithandej të pranishëm në këtë tekst sa informativ, po aq dhe mësimor e historik. Me një fjalë, një “kornizë” e relacioneve Shkup-Tetovë, për një “kornizë” të Ohrit dhe më shumë se aq.

(U.H.)

Të enjten Bletëzat 2017

Tetovë, 5 dhjetor - Janë duke u bërë përgatitjet e fundit për festivalin e këngës për fëmijë “Bletëzat 2017”, i cili do të mbahet me datë 7 dhjetor ditën e enjte në orën 18.00, në Qendrën për kulturë në Tetovë. Në këtë festival, i cili është më i vjetër në Maqedoni me rreth 20 edicione të mbajtura deri më tani, do të këndojnë fëmijë nga qytete të ndrysh-

me të Maqedonisë dhe nga Republika e Kosovës. Këngët kësaj radhe do t'i shoqërojnë kori i fëmijëve pranë Shkollës fillore “Liria” të Tetovës, nën udhëheqjen e profesoreshës së muzikës Laurije Ibrahimit. Ata për çdo ditë janë duke bërë prova dhe janë u përgatitur për natën finale të festivalit. Festivalin Bletëzat kësaj radhe e kanë mbështetur Mi-

nistria e Kulturës, Kompania Ecolog, Komuna e Tearcës, Vezë Sharri Trebosh, dhe produktioni Jehona Events. Në mbrëmjen finale do të garojnë gjithsej 14 këngë të autorëve të ndryshëm, kurse në pjesën riviale mysafirët do t'i argëtojnë fëmijët e çerdhes REA, grupi Zumba, dueti Gadaf dhe Dorela Elmazi si dhe shoqëria kulturo artistike Tear-

ca me vallen e pavarësisht. Interesimi për këtë festival është shumë i madh dhe si gjithmonë kërkohet një vend më tepër për hyrje në sallë. Përndryshe përzgjedhjen e këngëve fituese do ta përcaktojë juria profesionale në përbërje të Fiolla Lena Elmazit, Fismik Ristemi, dhe Anita Aliu, ndërsa çmimin e publikut me votat e tyre do ta ndajë vet publiku.

Shuhet pishtari i arsimit Kurtish Haliti

Tetovë, 5 dhjetor - Në moshën 83-vjeçare është ndarë nga jeta njëri ndër mësuesit e parë të shkollës shqipe në rajonin e Pollogut, Kurtish Haliti nga fshati Dobrosht. Mësuesi Kurtish Haliti lindi në fshatin Dobrosht të komunës së Tearcës më 17 të vitit 1934 dhe ishte drejtori i parë i shkollës fillore “Faik Konica”, njëkohësisht edhe mësues i parë kësaj shkolle ku

edhe kaloi më shumë se katër dekada si mësues në këtë shkollë. Ai gjatë gjithë jetës së tij sa ishte gjallë nuk kurseu asgjë nga vetja për të mbjellë farën e diturisë dhe atë për ta shpërndarë tek arsimimi i popullit të vet. Mësuesi Kurtish ishte një mësues i devotshëm dhe i dëshmuar në punë e në dije i përkushtuar me tërë energjinë e tij për përgatitje sa më të mire të

gjeneratave të reja. Gjenerata të tëra do ta mbajnë në kujtesë për punën e pa lodhshme dhe edukimin e mirëfillt, që do të jetojë në mbamendjen e shume gjeneratave në një pjesë më të gjerë shqiptare. Ai për në botën e amshueshme u përcoll me nderime fetare si dhe me shumë respekt nga ana e shumë bashkëqytetarëve, arsimdashësve, mësimdhënësve dhe ish

nxënësve. Si veteran i arsimit shqip, sot ai me mirënjohje kujtohet nga nxënësit e tij dhe të tjerët, si një edukator shembullor, me qëndrim të shkëlqyer pedagogjik ndaj nxënësve, i cili me punën e tij të palodhshme dhe fisnike arriti të mbjellë farën e diturisë dhe të arsimimit shqip në këto troje. Kontributi që dha ai, tani manifestohet nëpërmjet nxënësve të tij,

të cilët kanë arritur suksese në profesione të ndryshme si, mjek, jurist, ekonomistë, inxhinier të elektroteknikës, arkitekturës, e të tjerë, të cilët përveç se në Maqedoni veprojnë edhe në shumë vende të botës, si në Evropë po ashtu dhe Amerikë, shumë prej tyre edhe me tituj të lartë shkencor nga ky fshat dhe fshatrave të tjerë që gravitojnë në Komunën e Tearcës.

Zhurma për (jo) identitet

Ibrahim BERISHA



Zhurma komb a fe është bërë një ushqim konfliktesh dhe protagonizmas në skenën joformale publike ndër shqiptarët dhe në këtë kontekst edhe në Kosovë. Tonet dhe diskursi arrogant shpërthyen veçmas pas vitit 1999. Rrjetet sociale këtë punë e lehtësuan dhe madje edhe e shndërruan në akt subtil. Refleksionet konfliktuale verbale e shkrimore, në formën e opinionëve dhe mesazheve personale, në vend të një debati të mundshëm konstruktiv për paqe fetare, sikur edhe për tema tjera sociale, kulturore a politike, përmbajnë kauzë, arbitraritet dhe agjendë konfrontuese ndër fetare. Konfrontimet nuk burojnë nga një pus i vetëm, ta zëmë ndonjëherë i arsytueshëm, sikur është injoranca. Me të drejtë thoshin moralistët e shekullit XVIII, se guximi më i rrezikshëm është padituria. Pra, nuk bëhet fjalë në tërë këtë zhurmë vetëm për të paditurin fatkeq. Dinamika e rifreskimit tematik të konflikteve e tensionimeve, territori i gjerë konfrontues, na rikujton agjendën që e stimulonte formalisht regjimi serb në Kosovë: fundamentalistët islamistë, fundamentalistët katolikë! Stimulim konflikti i dy fundamentalizmave. Kësaj praktike i përgjigjet fare mirë që në vitet 1930 filozofi (prizrenas) Krist Maloki në Refleksionet kur shkruante se "tek gjendja jonë e varfër shpirtërore sundon e kaluara, gjenden hijet e pushtimeve të hueja e fryma e keqe, që ata krijuan dhe na lanë." Ata e lanë dhe ne po e mbajmë me devotshmëri, do të ishte një fjali plotësuese në kontekstin e mendimit të Malokit për të sotmen.

Përdorimi i gjuhës fyese, përjashuese, të ashpër (Na dhe Ata), e cila rrëshqet në urrejtje dhe tensione, në realitetin e shoqërisë shqiptare në Kosovë, pos tjerash, provokon kujtimin për një përvojë të freskët dramatike. Janë vetëm më të rinjtë në Kosovë që nuk e kanë para syve a në mendje fotografinë e luftës dhe të shkatërrimeve massive të ushtrisë dhe të milicisë serbe. Kjo ka ndodhur vetëm para tetëmbëdhjetë vjetëve. Kur objektet, shtëpitë dhe gjithçka që ngrihej lartë po shkatërrohej. Kur ata që shkatërronin kishin vetëm një motiv: dyzonin nacionalen dhe religjiozën për të kryer aktin kryesor-spastrimin etnik të shqiptarëve. Nuk dallonin shqiptarin katolik nga shqiptari musliman as në Meje, as në Gjakovë, as në Klinë. Prandaj në këto dyqind vjet, shteti serb ndërtoi kujdesshëm dhe sistematikisht për shqiptarët etiketën e fundamentalizmit, qoftë mysliman, qoftë

katolik, të cilën e përdorë sa herë i duhet. Rrënuan xhami dhe kisha katolike, sepse në propagandën shtetërore ishte konstruktuar rreziku i barabartë: "nga shqiptarët muhamedanë dhe katolikë". Kështu ishte edhe në vitin 1945. Ata vranë njësoj, shqiptarët me besime të ndryshme, Marie Shllakun e Bernard Lllupin, sikur edhe Mulla Idriz Cjllanin e Shyqri Prishtinën.

Fundamentalistët të krejt feve, shkruan Eduard Said, gjenden njëllor tek të gjitha fetë, sikur që ka fundamentalistët edhe nacionalistët në mesin e të gjitha kombeve. Të dy këto kontigjente ekstreme nuk pranojnë barazinë, tolerancën, mirëbesimin dhe pluralizmin e identiteteve si të mundshme të jetojnë në një hapësirë të përbashkët paqeje fizike, kulturore, fetare dhe politike. Këta ekstremistë, sipas kësaj logjike, duan edhe ndarjen e territoreve, krijimin e kufijve, spastrimin e hapësirave dhe nëse nuk e arrijnë në tokë, së paku këtë e bëjnë në terrene virtuale. Dhe në këtë mision sot, jo pak u ndihmon teknologjia informative, e cila është lehtë e përdorshme për të kryer misione indoktrinimi dhe aktivizmi radikal. Kështu, konstruohen me shumë pak mund, kufijtë vetidentifikues, për të përjashuar gjithë të tjerët që nuk janë, jo pak si ata, po plotësisht të ngjashëm sikur

ata. Ky kontigjent "Besimtarë" nuk pranojnë as harmoninë vëllazërore, të cilën e proklamojnë dhe praktikojnë besimet monoteiste. Duke shikuar përtej këtyre vlerave u bëhet se arrijnë që besimin personal ta shndërrojnë në një kauzë kolektive. Debatet si zhurmë, andaj në këto vite të fundit, jo pak prodhuan keqinterpretime në pyetjen: komb a fe? Natyrisht se mbra pa kësaj fjalie mbetet një pikëpyetje e madhe dhe shqetësuese. Pse ka kaq entuziastë dhe të palodhshëm në nxitjen dhe mbajtjen e konflikteve ndër fetare? A mos këto agjenda publike që dalin pa pushim për të mbajtur gjallë mobilitetin konfrontues ndër fetar, përgjasojnë në thënien: "Në rastësi nuk mund të ketë gjithmonë jorastësi". Natyrisht diskutimet, qasjet kritike janë të dobishme gjithmonë edhe për këtë temë, por shpërthimet emocionale për çfarëdo çështjeje a pune që ka të bëjë me besimet, nuk është se ndihmojnë gjë. Përkundrazi, vetëm sa mjegullojnë të drejtën dhe lirinë e besimit dhe të besimtarit. Pikërisht kjo fare qartë është shkruar si e drejtë kushtetuese: Secili është i lirë të zgjedhë ose të ndryshojë fenë ose bindjet, si dhe t'i shfaqë ato individualisht ose kolektivisht, në publik ose në jetën private, nëpërmjet kultit, arsimit, praktikave ose kryerjes së riteve fetare

Pse ka kaq entuziastë dhe të palodhshëm në nxitjen dhe mbajtjen e konflikteve ndër fetare? A mos këto agjenda publike që dalin pa pushim për të mbajtur gjallë mobilitetin konfrontues ndër fetar, përgjasojnë në thënien: "Në rastësi nuk mund të ketë gjithmonë jorastësi."



Udhëpërshkrues, diplomatë, gazetarë, studiues, politikanë etj, kanë theksuar tolerancën ndër fetare si një nga vlerat kryesore të shoqërisë shqiptare. Këtë të dhënë nuk e injorojnë as jodashamirësit mbasi ishte një e mirë e dukshme, sikur edhe një mosfavorizim i përzjerjes dhe grindjeve: "identiteti nacional a identiteti religjioz". Sami Frashëri, po në këtë temë, shkruante se shqiptari nuk njeh grindjet e fesë dhe luftërat e përgjakshme fetare, që kanë njohur popujt e Lindjes dhe të Perëndimit. Bashkimi i vërtetë dhe i fortë është ai që mbështetet mbi një themel parimor, mbi bindje të përbashkëta. Shqiptarët, me shumë besime, nuk i dhanë asnjë religjioni komponentin kombëtar, sikur ishte rasti me popuj evropianë, aziatikë apo amerikanë-jugorë. Anglia u identifikua me protestantizmin, sikur edhe Prusia, po në anën tjetër Rusia, Greqia dhe Serbia u identifikuan me ortodoksinë, sikur amerikanë-jugorët me katolicizmin apo disa nga shtetet arabe me muslimanizmin. Fatet e popujve janë të ndryshme. Tashti, kaq vjet më vonë, riaktualizohen mendimet e Samiut për identitetin (fetar) të shqiptarëve, këtë që e thoshte edhe Said në një kontekst universal: Kombi-komb e feja-fe. E thënë kaq lehtë, por jo krejt e thjeshtë as sot e kësaj dite, për të qenë pikërisht kështu si thuhet. (gazeta ekzpress)

KOHA PËR KARIKATURËN E DITËS



Themelues: Arben Rattkoceri dhe Lirim Dullovi

Botues: Koha Production SHPK | Adresa e botuesit dhe redaksisë: Bul. Goca Delçev nr.11, | Q.T. Mavrovësja lok.14 - përdhës, Shkup | Gazetë ditore - botohet çdo ditë përveç të dielës | Shtypi dhe distribuimi: "Adria Media Balkan" - rr. 852 nr.62, Shkup, 5000 kopje | Data e shtypjes e martë 5 dhjetor | Numri i parë i gazetës doli më 22 Nëntor 2006
 Drejtor: LIRIM DULLOVI | Kryeredaktor: Vedat MEMEDALIU | Ndihmëskryeredaktor: Evis HALILI | Redaktorë: Shkëlzen HALIMI | Redaktor teknik: Halil BERISHA
 E-mail: koha@koha.com.mk | Tel: 02 3179 - 904; Tel: 02 3179 - 905; Tel: 02 3179 - 906; Fax: 02 3118 - 060; | MARKETING: Bekim SHAQIRI • marketing@koha.com.mk; Tel: 02 3179-904; Mob: 071 372 222 | Përgjegjës për distribuim: Afrim DULLOVI - Tel: 071 372 221
 Përfaqësues ligjor: Shtëpia e avokatëve Inter Partes - Shkup

NPK "Koha Production" Num. i xhironlogarisë: 210063340670177; Tutunska Banka -Shkup; Numri tatimor 4030008022772

Vendlindja, ëndrra e një bote të shenjtë



Nga Stanislav STRASBURGER

Përveç rrugicave të qytetit tonë dhe zakoneve tona - përveç lidhjeve tona të gjakut - pjesa tjetër e botës është një xhungël e tmerrshme ku vetëm mashtruesit mund të mbijetojnë. Këtë predikonin gjyshërit e protagonistit të "Kalorësit polak". Por ai gjithmonë donte të largohej. Romancieri spanjoll Antonio Muñoz Molina përshkruan se si Manueli ëndërronte që në fëmijëri të shpëtonte nga vendlindja e tij e vogël, qyteti i Andaluzisë Magina. Ai donte të bëhej qytetar i botës: të fliste gjuhë të huaja dhe të jetonte në qytetet kryesore të botës - Paris, Nju-Jork ose Bruksel. Si ri rebel Manueli dëgjonte "The Doors" dhe i pëlqenin sidomos "Riders on the storm" dhe "Break on through". Kështu ai mësoi anglisht, sepse në vitet 60-të në shkollat spanjolle nuk ofrohej mësimi i gjuhëve të huaja. Më vonë Manueli u bë përkthyes dhe ëndrra e tij u bë realitet. Në një moment, kur ishte në mesin e të tridhjetave të tij, ai dëgjoji përsëri zërin e gjyshit. Dhe papritmas e gjithë jeta iu duk e dështuar. Zëri i gjyshit i thoshte: "Nëse bën edhe një hap më tej, nuk do të kthehesh më prapa, do të bëhesh i

huaj përgjithmonë, nuk do të kesh më një vend që të jetë kaq i rëndësishëm për ty që të duash të qëndrosh atje. Sepse çdo qenie njerëzore ka vetëm një gjuhë dhe një shtëpi, ndoshta dhe vetëm një qytet dhe një peizazh". Kush ka të drejtë - Manueli apo gjyshi i tij? A jemi ne njerëzit të dënuar që si të rinj të ëndërrojnë të jetojmë një jetë të re, ndryshe nga kufijtë e ngushtë të vendlindjes sonë mbytëse dhe pastaj dekada më vonë për t'u dhënë të drejtë të moshuarve dhe për t'u kthyer të penduar në shtëpinë e prindërve?

Mua personalisht, prindërit (dhe dy gjyshet) nuk më kanë predikuar në fëmijërinë time që bota e largët është një xhungël mizore. Megjithëse në dekadën e fundit të Perdes së Hekurt kishte shumë arsye për këtë: shumica e familjes sime u vra në Luftën e Dytë Botërore, një konfrontim i mundshëm me kapitalizmin e kalbur që i pranishëm. Në shtëpi më kanë dhënë një mësim tjetër: e keqja e botës nuk ndalet në qytetin dhe fafësinë tonë. Aktualisht këtë e tregon edhe fushata në mediat sociale #MeToo. Një numër i madh njerëzish, shumica gra, raportojnë për përvojat

e tyre pjesërisht traumatike. Disa i kanë bërë ato jashtë vendit ose me të huaj, por shumë edhe në ambientin e tyre të afërt: si fëmijë në shtëpi dhe midis të afërmeve, në jetën e tyre profesionale dhe në mjedisin më të afërt shoqëror. Çdokush që ka qenë i prirë të mendojë, se vetëm të huajt ngacmojnë dhe përdhunojnë, ka nevojë urgjente për një përditësim. Çfarë më thotë kjo? Bota e përsosur, amtare është një ëndërr. Ajo është një utopi. Në një nivel personal, ekzistencial, ajo gjithmonë e ka shoqëruar njerëzimin. Për disa, kjo ëndërr mund të jetë sjellëse fati. Për të tjerët, krijon presion. Në një mjedis familjar, kjo ëndërr shpesh shndërrohet në të vërtetë, por shumë shpesh kjo nuk është asgjë më shumë se një gënjeshtëri. Në fund të fundit, është një rastësi se ku ndeshesh me të keqen e botës: në qytetin tënd ose në një të huaj. Transferuar në nivelin politik, gënjeshtria e botës së shenjtë brenda vendit, shpesh shndërrohet në një instrument pushteti. Së bashku me konceptin e kombit dhe të identitetit, kjo gënjeshtëri është një nga shpikjet mashtruese të shekullit të 19-të. Pa to, nuk do të ishte e mundur të mobilizohe-

Te ne është mirë, kurse jashtë plot rreziqe. Përse atëherë ka kaq shumë të rinj që duan të largohen nga vendlindja?



shin dhe fanatizoheshin miliona njerëz që në shekullin e njëzetë ishin gati të sakrifikonin lumturinë e tyre personale, të linin familjet e tyre dhe të shkonin në luftë për të vlarë njëri-tjetrin. Atdheu në nivelin e politikës është lëndë shpërthyes. Protagonisti i Muñoz Molinas arriti që t'i kundërvihet fuqisë shkatërruese të utopisë së atdheut në të dyja nivelet. Kujtesa e tij shkon më thellë se zërat e gjyshërve të tij. Ai flet për vuajtjet e të afërmeve të tij, edhe nëse ata vetë heshtin për këtë.

Pas një kërkimi të marrëzishëm, Manueli e gjen vatrën e tij tek ... dashuria. Sikurse thuhet në një prej këngëve të tij të preferuara të "The Doors". Zëri i Jim Morrisonit mbizotëroi: "Kam gjetur një ishull në krahë e tua / një vend në sytë e tu." Personalisht, unë mendoj si Manueli. Për mua janë njerëzit që përbëjnë shtëpinë dhe vatrën time. Ata mund të jetojnë në vendlindjen time ose larg saj. Unë jam gjithmonë i lumtur kur i takoj ata atje ku jetojnë. E njëjta vlen edhe për mua. Ka mjaft vende gjeografike ku më pëlqen të jem. Vendlindja ime Varshavë është vetëm një prej tyre. (dv)


Qysh prej shekujsh vazhdon lufta midis këtyre të dy botëkuptimeve. Kjo luftë filloi aty nga i XII shekull me Kartën e Madhe. Filloi në mënyrë të dukshme kur populli anglez vendosi të shkëputet prej ndikimit të kishës universale. Lufta vazhdon e ashpër edhe sot nën forma të ndryshme. Nga ana e universalistave lufta bëhet dhe bëhet në bazën e një arsyeje shumë herë gjeniale, por gjithmonë arësye të ftohtë dhe spekulonjëse. Kurse nacionalistët i ka shtytur instikti, kishte me thanë vetë natyra. Natyra i do individet, do shumëllojshmërinë ndër njerëz, ndër kafshët dhe bimët. Për me i dalë zot këtij qëllimi, jo vetëm i ka krijuar racat, llojet e kafshëve dhe të bimëve, por iu ka dhanë armët dhe mjetet ma të rafinuara për t'u mbrojtur.

Universalistat nuk pranojnë kufi nga jashtë, por aq më të ngushtë i venë kufijtë nga mbrenda. Flasin për njerëzin mbarë, për ide të përgjithshme, për njësi dhe vllazëri të përbotshme. Forma e universalizmit është imperializmi, qoftë fetar ose shekullar. Siç thashë imperializmi përdor si parim të domosdoshëm shprehjen: "kufi të gjërë nga jashtë dhe të ngushtë nga brenda". Që të kuptohemi ma mirë, po iu jap disa shembuj. Çdo fe e organizuar që ka prirje universale thotë: Më fal arsyen tënde, gjykimin tënd dhe unë të zbuloj të vër-

NË SHIRITIN E KOHËS

Universalizmi dhe Nacionalizmi

Nga Mihal ZALLARI



tetën absolute. Imperializmi shekullar romak ose anglez etj., ka thënë ose thotë: falmë urinë tande si individ ose si komb dhe une do të ngreh një shtet i cili përfshin gjithë njerëzinë dhe gjithë dheun, ku do të sundojë rregullisht dhe paqë. Komunizmi, një tjetër formë e universalizmit, thotë: Hiq dore nga vëllau tënd i gjakut dhe unë të bëj vëlla me të gjithë njerëzit e kësaj bote. Kjo bie erë diçka si ajo puna e shejtanit, i cili i paska thënë Krishtit: Bjer në gjunjë, falmu mua dhe unë të fal gjithë pasurinë e kësaj bote. Shkurt, çdo imperializëm, në emrin e një ideje universale, kërkon dhe ka kërkuar: Hiq dorë nga personaliteti tënd dhe nga liria personale. Universalizmi ka patur gjithmonë një fuqi të madhe dhe tërheqëse në njerëzit e ligështë. Mirëpo njeriu i fortë nuk e pranon. Ai gjen në kraharorin e tij, në familjen e tij, në popullin e tij një botë pa kufi, të cilin ai nuk e shkëmben me gjithë universin dhe me gjithë yjet e panumurt të tij. Nacionalisti i ka vënë vetes kufij nga jashtë, për të ruajtur personalitetin e vet dhe kërkon kufij të

Shkurt, çdo imperializëm, në emrin e një ideje universale, kërkon dhe ka kërkuar: Hiq dorë nga personaliteti tënd dhe nga liria personale



gjërë nga brenda, për me qenë i lirë në zhvillimin e natyrshëm të vlerave të tij, të prirjeve të tij, shkurt të karakterit të tij. Kurse universalisti thotë: bëju si unë, nacionalisti përkundrazi lyp: bëju siç je, me fjalë të tjera, qëndro besnik i vetvetes.

E vërtetë që nacionalisti pranon që njeriu ashtu edhe kombi nuk mund të qëndrojnë për vehte dhe të veçuar, se bëjnë pjesë në një tërësi, në të cilën secili është mbështetje dhe mbështetet. Por njerëzia, si një tërësi, është e interesueshme dhe mund të lartësohet vetëm atëherë kur individit ose kombit ka dhe di të ruajë karakterin e tij. Nacionalisti i jep një rëndësi të veçantë personalitetit dhe lirisë vetjake. E quan për detyrë të shenjtë të ruajë dhe zhvillojë vlerat e tij; e çmon vehten dhe kërkon që ta çmojnë dhe të tjerët; lyp që ta ketë fatin e vet vetë në dorën e tij; nuk duron të humbasë në turmën e popujve; nuk duron të bëjë pjesë si një numur i një shoqërie anonime; nuk do të fshihet prapa një pseudonimi, por del para botës me gjithë personin e tij përgjegjës, si ai burri i Tepelenes i cili

çdo letër e mbaronte me këto fjale: "Unë, Aliu, shkruaj".

Që ta presim shkurt në një mënyrë konkrete: Ne shqiptaret duam idenë tonë, virtutin tonë, të mirën ose vetveten tonë. Nuk e duam idenë e këtij, atij ose të gjithë botës. Siç thashë, nuk duam të jemi pjesëtarë në një shoqëri anonime. As duam të jemi dekorative brenda suazës së një perandorije. Por në një çast fatzi ligështije dhe të krupës së madhe na sulmoi armiku befas dhe na mashtrroi. Hodhi fare të keqe midis nesh dhe organizoi anarkinë e shëmtuar. Ne, që si popull kemi dhënë burra shteti dhe ushtarë të mëdhenj, jetojmë sot turpin, të na heqin nga hunda të huajt! Por krenaria e jonë kombëtare na ndalon të organizohemi nën priz të huaj. Vetëdija e jonë kombëtare dhe instikti i vetëmbrojtës na ndalojnë ndër këto kohe fort të rrezikshme të vrasim njeri tjetrin. Mbi te gjitha, nderi i jonë kombëtar na ndalon të gënjejmë, të intrigojmë dhe të shpifim! Jemi vëllezër. Duhet të bëhemi shokë! (Botuar në Gazeta Kombi, 17.10.1943)

ISMAIL KRIFCA, PËRKTHYES

NJOHJA E GJUHËVE, PASURI E VEÇANTË

Në këtë periudhë të gjatë mbi 23 vjet, kam pasur mundësinë dhe fatin e mirë që të takoj shumë njerëz nga mbarë bota. Kam punuar me kryetarë shteti, kryeministra, deputetë, ministra, artistë të ndryshëm si edhe me shumë “njerëz të rëndomtë”, që secili në mënyrën e tij të veçantë të lë mbresa dhe përshtypje me diçka të jashtëzakonshme. Në raste të ndryshme kam pasur përjetime të ndryshme. Ndonjëherë të bëjnë të ndjehesh krenar që je në praninë e tyre, ndonjëherë të bëjnë të ndjehesh paksa i turpëruar, ndonjëherë madje edhe të vjen keq për veten dhe popullin nga fakti se kush po na udhëheq

Koha

Delvina KËRLUKU

Ismail Krifca – Mali u lind më 18 maj, 1967, në Dibër. U shkollua në vendlindje, ndërsa, Fakultetin e Ekonomisë e kreu në Shkup, në Universitetin “Qirili dhe Metodi”. Përkthen nga 11 gjuhë. Pasioni për mësimin e gjuhëve të huaja lindi që në bankat shkollore. Më vonë, me ndihmën e babait, i mundësohet të qëndroj në Britaninë e Madhe, ku edhe vazhdoi me mësimin e gjuhës angleze. Atje kalon dy vera gjatë viteve 1983–1984. Kureshtja për të mësuar edhe gjuhë të tjera, bën që Mali t’i mveshet edhe gjuhës frënge, italishtes, rusishtes, gjermanishtes, duke mos lënë anash edhe gjuhën serbe, bullgare, kroate, ndërsa gjuhën maqedonase e kishte përvetësuar që në shkollën fillore. Filloi karrierën e përkthyesit profesional që nga viti 1994. Punoi në punë të ndryshme me organizata ndërkombëtare në vend, si me UNPREDEP-in, ICRC, NATO-n (përkthyes personal i gjeneralit Sir Michael Jackson, komandant i forcave të NATO-s në Maqedoni dhe përkthyes gjatë marrëveshjes NATO – Serbi në Bllacë dhe Kumanovë). Që nga viti 2003 është përkthyes i lirë, me angazhime të shumta në konferenca, seminare dhe punëtori në vend, rajon, por edhe shumë më gjerë. Deri më tani ka kaluar mijëra përkthime dhe vizita nëpër vendet e botës. Në periudhën gjatë viteve të luftërave dhe konflikteve në Kosovë dhe Maqedoni, ka qenë pranë Presidentin Clinton dhe bashkeshortës së tij, Hillari Clinton. Ka qenë përkthyes i kryeministrin e Britanisë së Madhe, Toni Bler dhe bashkeshortës së tij. Por, ishte edhe pranë Solanës, Vokerit, Piter Fejti, Perdju, Leotar dhe shumë të tjerë. Pranë aktorëve Roxher Mur, Riçard Gir, Marisa Tomei, Majkëll Jork, Ben Gazar, Vanesa Redgrejv, e shumë e shumë të tjerë. Mali vazhdon të jetë pjesë e paneleve edhe sot. Është i martuar. Përreth tij ka familjen dhe shumë miq.

KOHA: Përkthimi është shumë i lashtë mbi këtë dhe, gati aq sa vetë gjuhët njerëzore. Ndërsa, jeni përkthyes i njëmbëdhjetë gjuhëve. Ç’do të thotë të njihni kaq shumë gjuhë?

KRIFCA: Në fakt, unë komunikoj në njëmbëdhjetë gjuhë, ndërsa me përkthime, deri tani, kam punuar me shtatë gjuhë. Përveç gjuhës amtare shqipe dhe gjuhës maqedonase si gjuhë zyrtare (tani më së bashku me gjuhën shqipe) në Maqedoni, unë flas edhe anglisht, serbisht, frengjisht, bulgarisht, italisht (gjuhë në të cilat kam përkthyer), si edhe rusisht, çekisht, polonisht dhe gjermanisht (në mënyrë pasive). Një nga dëshirat e parealizuarra deri tani, kryesisht për mospasje të kohës së mjaftueshme si edhe materialeve mësimore, është gjuha kineze, për të cilën shpresoj se do të gjej kohë dhe mundësi ta mësoj, së paku për një komunikim themelor. Njohja e gjuhëve, para së gjithash, të shton vetëbesimin në shoqëri, të bën më të pasur në çdo aspekt dhe të jep mundësinë të ndjehesh shumë më lirisht dhe më bukur në secilin mjedis dhe ambient ku fliten gjuhët të cilat i njeh. Nuk ke nevojë për përkthim apo shpjegim të asaj që ndodh përreth teje dhe pa droje mund të përfshihesh në bisedën me njerëzit e pranishëm. Njohja e gjuhës gjithashtu mundëson që të njohësh njerëzit dhe vendet më mirë, duke kuptuar më qartë dëshirat dhe mendimet e tyre, lidhur me vendin dhe fatin e tyre. Shumë më shpejt pranohesh në rrethin e tyre dhe krijon besim më të madh të të tjerët, në veçanti për shkak se ata ndjehen krenar dhe më të respektuar që një “i huaj” ka dhënë mundin dhe ka kështu kohën që të mësojë gjuhën e tyre për komunikim të drejtpërdrejtë. Në sytë e tyre shikohesh “më bukur”. Përveç këtij fakti, të njohurit e gjuhëve ka edhe shumë përparësi dhe rëndësi në jetën e secilit njeri, në veçanti në jetën time. Kjo, për shkak se tre pasionet

kryesore në jetë i kam pasur dhe i kam, të njoh dhe shoqërohem me sa më tepër njerëz të popujve dhe rasave të ndryshme, të lexoj sa më shumë libra dhe të shëtis anembanë rruzullit tokësor. Njohja e gjuhëve të mundëson këtë në mënyrën më të bukur.

KOHA: Roli i përkthyesve në shoqërinë njerëzore erdhi e u bë gjithnjë e më i rëndësishëm aq sa sot, me të drejtë, një filozof e shkrimtar si Umberto Eko, thekson se “zanati i përkthyesit është një profesion që i përket së ardhmes”, çka do të thotë se bota moderne nuk do të mund të bëjë dot pa përkthyes?

KRIFCA: Gjithsesi Umberto Eko është njëri nga njerëzit të cilët kanë kuptuar rolin e përkthyesit që në kohën kur jetonte dhe vepronte. Por, sot, gjithnjë e më tepër, zanati i përkthyesit është absolutisht zanat i cili i takon së tashmes dhe të ardhmes në këtë jetë kaq dinamike dhe të shpejtë, me informacione dhe ndryshime, të cilat ndodhin me “shpejtësinë e dritës”, fakt ky i cili rezulton me mospasjen e kohës së duhur nga secili që të mësojë më tepër gjuhë për të komunikuar me të tjerët afër dhe larg tij, që flasin gjuhë të ndryshme nga gjuha e tij. Duke mos harruar këtu edhe faktin që interneti dhe rrjetet so-

cialle krijojnë mundësi dhe raste për kontakte personale dhe afariste me mbarë botën në një kohë tmerrsisht të shpejtë. Ndonjëherë mundësitë më të mira në jetë mund të humben për shkak të moskomunikimit të duhur. Prandaj, edhe zanati i përkthyesit gjithnjë e më tepër do të jetë i rëndësishëm në mbarë botën. Lëvizjet emigruese, ekonomike dhe vizitat e ndryshme turistike apo afariste e bëjnë përkthimin dhe përkthyesit gjithnjë e më të kërkuar.

KOHA: Edhe te ne përkthimi është një veprimtari intelektuale e artistike e hershme. Të parët që u morën me përkthime ndër shqiptarët qenë Buzuku, Budi, Bardhi e Bogdani, pastaj vijnë disa nga rilindësit tanë më të shquar, si Kristoforidhi, Naim Frashëri e Çajupi; më vonë kemi Fishtë, Prenushin, Konicën, Lumo Skëndon, Koliqin e Dom Lazër Shantojën, etj, duke mos harruar edhe Fan Nolin. Sa rëndësi ka një përkthyes në shoqërinë tonë?

KRIFCA: Si në historinë e popullit tonë, ashtu edhe në ditët bashkëkohore, roli i përkthyesit është shumë i rëndësishëm. Përkthimet e realizuar nga të gjithë mendimtarët e mëdhenj të lartpërmendur, si edhe shumë të tjerë në historinë më të afërt, kanë

mundësuar që edhe populli ynë, si të gjithë popujt e tjerë në botë, të mund të ndjek të gjithë risitë dhe ndodhitë në mbarë rruzullin tokësor. Të mund të edukohet dhe të kuptojë se çfarë po ndodh për rreth tij. Imagjoni një botë, ose një jetë, në të cilën nuk do të kishim pasur mundësinë të lexojmë dhe kuptojmë Shekspirin, Tolstojin, Hygonë, Edgar Alan Po-në, Robespierin, Danten dhe shumë të tjerë dhe veprat e tyre klasike dhe të paharrueshme. Një jetë ku nuk do të dinim për artistët, piktorët, skulptorët botëror dhe veprat e tyre madhështore. Madje, edhe gjërat më të rëndomta, siç janë ushqimi, moda dhe jeta e përditshme, si do të mund të ishte, sikur mos i kuptonim gjërat dhe mënyrën e përdorimit të tyre. Por, roli i përkthyesit në shoqëri, ka të bëjë shumë edhe me komunikimin gjatë konflikteve dhe mosmarrëveshjeve të ndryshme. Shpesh herë gjërat ndodhin për shkak të një keqkuptimi gjatë të komunikuarit. Madje, edhe të gjitha komunikimet shtetërore, diplomatike nuk do të mund të realizohen pa praninë e përkthimit dhe përkthyesit si bartës të kësaj pune. Me punën e tyre përkthyesit ju mundësojnë edhe njerëzve “të rëndomtë”, të cilët nuk kanë mundësi dhe kohë të mësojnë gjuhët e huaja, të mund të ndjekin ndodhitë dhe risitë në mbarë botën.

KOHA: Në historinë e njerëzimit, përkthimi do të luajë, ashtu si deri më sot, një rol të veçantë e të pazëvendësueshëm në përshpejtimin e zhvillimit të tij. Nëse do ta shpalosni historinë e rrugëtimit tuaj si përkthyes, ç’na tregon?

KRIFCA: Që nga fëmijëria e hershme (nga klasa e dytë në shkollën fillore) unë fillova të mësoj gjuhën angleze me leksione private për gjuhë. Babai im i ndjerë, Iqmet Krifca, kishte vizion të qartë në jetë për vete dhe për të afërmit e tij. Duke pasur parasysh dhe duke kuptuar se bota dhe vendi



gjithnjë e më tepër ec përpara, dhe në këtë rrugë gjuha angleze do të jetë shumë e rëndësishme, më propozoi që të ndjek orë private te zonja Vjollca Agolli Çilku, që ishte mësuesja ime e parë e gjuhëve të huaja. Në atë kohë, unë flisja gjuhën maqedonase dhe serbe pa problem. Babai pa te unë talentin dhe dëshirën e madhe për të mësuar gjuhët e huaja dhe unë fillova me orët private që nga ajo moshë e hershme. Kjo bëri që kur filluam me lëndën e gjuhës angleze në klasën e pestë, të jam disa shkallë më lartë në njohjen e gjuhës angleze se shokët e klasës. Më pas, vazhdova me mësimin e gjuhës në shkollën fillore dhe të mesme. Atëherë përsëri me ndihmën e babait, unë pata mundësi që dy pushime verore (1983 qershor – gusht; 1984 qershor – gusht) të qëndroja në Britaninë e Madhe, ku edhe vazhdova me mësimin e gjuhës, tanimë në vendin ku kjo gjuhë kishte burimin e saj. Atje sigurisht që përparova shumë në këtë aspekt, falë edhe faktit që isha i detyruar që të flas vetëm anglisht, që të merrem vesh me njerëzit përreth. Por, ndoshta edhe më së tepërmi në këtë rrugëtim të mësimin të gjuhës më ndihmoi edhe pasioni tjetër i imi, e ai ishte dashuria për lexim të sa më shumë librave. Në këtë periudhë lexoja shumë libra, të shkruara në gjuhën angleze, gjë e cila kontribuoi shumë për të kuptuar dhe folur gjuhën shumë më mirë. Më pas, edhe pse vendosa të studioj në fakultetin e ekonomisë, edhe më tutje jetonte në mua dëshira që mësoj sa më shumë gjuhë të huaja, të cilës i dedikova kohë dhe interes së veçantë në jetën time. Njëpërmjet mënyrave të ndryshme të të mësuarit, mësova edhe gjuhën frënge dhe italishte. Gjithashtu, edhe shëtitjet dhe vizitat e shumta në shtetet përkatëse, më ndihmuan që më lehtë të mësoj gjuhët. Duke vazhduar me përkthime zyrtare, fillova karrierën e përkthyesit profesional që nga viti 1994 deri më sot. Punova në punë të ndryshme me organizata ndërkombëtare në vend, si me UN-PRDEP-in, ICRC, NATO-n (përkthyes personal i gjeneralit Sir Michael Jackson, komandant i forcave të NATO-s në Maqedoni dhe përkthyes gjatë marrëveshjes NATO – Serbi në Bllacë dhe Kumanovë), IFES dhe shumë organizata të tjera. Që nga viti 2003 unë jam përkthyes i lirë (freelance), me angazhime të shumta në konferenca, seminare dhe punëtori në vend, rajon, por edhe shumë më gjerë. Deri tani në këto 23 vite përkthimi, kam kaluar mijëra përkthime dhe vizita të shumta në pothuajse gjysmën e botës.

KOHA: Mund të përmendi si cilat nga personalitete e huaja keni shoqëruar, që të përktheni fjalën e tij/saj? Dhe cilat janë mbresat që ju ka lënë një nga personalitetet?

KRIFCA: Në këtë periudhë të gjatë mbi 23 vjet, kam pasur mundësinë dhe fatin e mirë që të takoj shumë njerëz nga mbarë bota. Kam punuar me kryetarë shteti, kryeministra, deputetë, ministra, artistë të ndryshëm si edhe me shumë "njerëz të rëndomtë", që secili në mënyrën e tij të veçantë të lë mbresa dhe përshtypje me diçka të jashtëzakonshme. Në raste të ndry-



shme kam pasur përjetime të ndryshme. Ndonjëherë të bëjnë të ndjehesh krenar që je në praninë e tyre, ndonjëherë të bëjnë të ndjehesh paksa i turpëruar, ndonjëherë madje edhe të vjen keq për veten dhe popullin nga fakti se kush po na udhëheq. Por, e gjithë kjo është pjesë e punës dhe si e tillë edhe duhet të perceptohet. Bëj punën time me sa mundem dhe di më së miri dhe vazhdoj më tutje me jetën time. Gjithsesi, duhet pasur parasysh se një nga virtetet kryesore dhe më të rëndësishme të përkthyesit është diskrecioni dhe konfidencialiteti. Çdo gjë që ndodh dhe thuhet gjatë këtyre takimeve, mbetet vetëm për aty dhe nuk guxon të del në pah, së paku jo nga ana e përkthyesit. Duke thënë këtë, më duhet të përmendi së paku disa burra shteti, me të cilët kam pasur rast dhe mundësi të takohem gjatë përkthimeve që i kam kryer në vend dhe jashtë. Në periudhën gjatë viteve të luftërave dhe konflikteve në Kosovë dhe Maqedoni, pata mundësinë të takoj Presidentin Clinton dhe bashkëshorten e tij, Hillari Clinton. Kryeministrin e Britanisë së Madhe Toni Bler dhe bashkëshorten e tij. Shumë të tjerë që vizituan Maqedoninë gjatë kësaj periudhe, si Solana, Vokeri, Piter Fejti, Perdju, Leotar etj. Siç theksova edhe më lartë, unë isha përkthyes personal i komandantit të forcave të NATO-s në Maqedoni, gjenerali Sir Majkëll Xhekson. Pata rastin të jam i pranishëm si përkthyesi i tij gjatë marrëveshjes teknike NATO – Serbi në Bllacë dhe Kumanovë, që shënoi fundin e okupimit serb në Kosovë. Ky është një nga momentet më të rëndësishme në jetë, sepse në një mënyrë u bëra pjesë e historisë më të re të Kosovës. Përveç tyre, kam pasur mundësi të takoj një numër të madh të artistëve të tjerë, të cilët vizituan Kosovën dhe Maqedoninë në këtë periudhë. Kam pasur mundësi të takoj aktorët Roxher Mur, Riçard Gir, Marisa Tomei, Majkëll Jork, Ben Gazar... por, gjithsesi, më mbresëlënëse ka qenë bashkëpunimi 8 javor me aktoren e madhe angleze, në të njëjtën kohë edhe mbështetëse e madhe e luftës së Kosovës, e madhja Vanesa Redgrejv. Ajo në atë kohë, për nder të kthimit të vëllezërve të Kosovës në shtëpitë e tyre, organizoi festival muzikor – teatral "The Return" (Kthimi) me vepra teatrale dhe muzikore, një ditë në Shkup dhe dy ditë në Prishtinë, ku morën pjesë mbi 120 aktorë dhe muzicantë nga mbarë bota. Fuqia dhe entuziazmi i saj, të bënte me flatra. E palodhshme dhe me vullnetin e saj bënte që të gjithë rreth saj të mos

ndjejnë asnjë lodhje, edhe pse punonim edhe nga 18 deri 20 orë në ditë. Një FALENDERIM të veçantë për gjithçka që ajo bëri për Kosovën, gjatë dhe pas luftës për çlirimin e Kosovës.

KOHA: Më vështirë është të përkthejmë poezinë apo librat artistik, apo një fjalë e drejtpërdrejtë e thënë nga një i huaji?

KRIFCA: Secili përkthim përmban rëndësinë dhe peshën e tij dhe kërkon vëmendjen dhe kujdesin e veçantë gjatë punës që e bëjmë. Me siguri poezitë dhe veprat letrare, përveç rëndësisë së tyre burimore dhe kujdesit të jashtëzakonshëm që e kërkojnë për përkthim, kërkojnë edhe një punë voluminoze që duhet bërë para përkthimit të tyre. Duhet së pari kuptuar vetë atë poezi ose vepër letrare që të mundesh të transferosh mendimin dhe qëllimin që poeti ose autori e ka pasur gjatë përpilimit të saj. Jo gjithmonë poezia dhe vepra mund të përkthehet fjalë për fjalë, sepse mund të humb kuptimin dhe vlerën e saj. Por, në të njëjtën kohë, nuk mundet gjithmonë të realizohet përkthimi vetëm me interpretim personal të të kuptuarit të poezisë ose librit artistik. Kërkon një bashkëpunim me autorin, që shpesh herë nuk mund të realizohet për arsye objektive ose subjektive. Këtu vjen në pah aftësia e jashtëzakonshme e përkthyesit për përshtatjen gjatë përkthimit. Gjithsesi, punë e vështirë dhe kërkon njohuri të jashtëzakonshme. Por, edhe fjala e drejtpërdrejtë e thënë nga të huajt ose nga njerëzit tanë që ju përkthehet të huajve, ka një peshë dhe vështirësi të jashtëzakonshme. Jo gjithmonë temat të cilat diskutohen janë domosdoshmërisht të njohura mirë nga përkthyesit. Jo gjithmonë folësi mbahet vetëm në një temë të caktuar, por gjatë bisedës së tij, kalon nga një temë në një tjetër, pa ndonjë pauzë të caktuar ose paralajmërim për atë. Jo gjithmonë, folësi qartë dhe rrjedhshëm fillon dhe mbaron fjalën e tij. Përkthyesi e ka vështirë shpesh të kuptojë edhe fjalët me kuptime të ndryshme që mund të ndryshojnë kuptimin. Gjatë përkthimit simultan, varësisht nga teknika, edhe fjalët shpesh vështirë dallohen që mund të shkaktojnë moskuptim. Një shkronjë ndryshon shumë gjëra. Psh. i tha dhe i ra. E pret dhe e vret. Do apo nuk do... Mendoj pra, se secila prej tyre ka veçoritë dhe vështirësitë e tyre të caktuara.

KOHA: Buzëqeshja nuk ka nevojë për përkthyes. Ajo është gjeja më e bukur që posedon njeriu..?



KRIFCA: Jo vetëm më e bukur, por edhe më e vlefshme. Një buzëqeshje mund të ndryshojë shumë gjëra për njeriun. Në të njëjtën kohë, edhe nuk kushton asgjë. Thjesht, një lëvizje e disa muskujve, e cila, në veçanti kur është e sinqertë, mund t'i vlejë personit përballë më tepër se shumë gjëra materiale në jetë. Nënkupton mirëkuptim për hallet dhe problemet e personit përballë dhe paraqet një fuqi shtesë që ai ose ajo të përballojë fatin e keq më lehtë, madje edhe të shtojë lumturinë dhe gëzimin që ndjen në ato momente. Për fat të keq, njerëzit shpesh e harrojnë këtë.

KOHA: Z. Krifca, nëse kthehemi te pjesa tjetër e jetës, çfarë flet ajo, pra shtëpia, familja, shoqëria, etj?

KRIFCA: Familja dhe shoqëria në jetën time kanë vend të veçantë. Edhe pse babai, Iqmet Krifca – Meti tanimë 6 vjet i ndjerrë, ai është gjithmonë i pranishëm në vendimet në jetën time, sepse gjithmonë e kam pasur si udhërrëfyes. Fizikisht më mungon, por mendërisht është gjithmonë me mua. Nëna, Shqipe Krifca, mësuese e pensionuar, gjithmonë pranë në momentet e lumtura dhe të hidhura në jetë, është shtylla e fortë e jetës sime. Motra, Mirilinda Krifca, doktore e shkencave të albanologjisë, profesore universitare, së bashku me dhëndrin, Rexhailin dhe vëllai Dritani me bashkëshorten Flora, janë pasuria e jetës sime. Në veçanti këtë pasuri e shtojnë mbesat (nga vëllai dhe motra) Arba, Fjolla, Ardena dhe Genta, që në çdo moment shtojnë gëzimin që i kam në jetë. Pa harruar Lean dhe Lekën që më shtojnë buzëqeshjen në secilin mëngjes. Dhe së fundi, gjithsesi jo më pak e rëndësishme, përkundraz, bashkëshortja Laura, profesore dhe e kimisë në gjimnazin "Zef Lush Marku" në Shkup, është mbështetja më e madhe në jetën e përditshme, që me mirëkuptimin e saj më lehtëson gjithçka në jetë. Pa familjen, njeriu nuk vlen asgjë. Por, nuk duhet të harrojmë dhe rrethin më të gjerë familjar që shpesh herë kalon edhe përtej kësaj. Shpesh, ata janë forca shtytëse në jetë, së bashku me shokët pa të cilët jeta ime do ishte e zbrazët. Fati ka dashur që të kem shumë shokë dhe miq në jetë. Shokët e fëmijërisë nga Dibra (Muja, Arbeni, Lumi, Adriatiku, Fatmiri, Argjenti, Nderimi, Blerimi, Arsimi, Valoni dhe të tjerët) si edhe ata nga Shkupi (Blerimi, Burimi, Faredini, Ganiu, Bashkimi, Skenderi, Urimi, Fatonë, Dritëroi, Genci dhe shumë të tjerë), secili ka pasur dhe ka rol të veçantë në jetën time. Pa harruar në asnjë moment kushërinjtë shokë të vërtetë, si

Imeri, Benoni, Bekimi, Maliqi, dhe shumë të tjerë. Por, edhe miqtë e tjerë dhe kolegët e punës secili e begaton jetën time pa masë. Përfshirë këtu edhe miqtë dhe shokët e Lëvizjes "Zgjuhu", me të cilët kemi ndarë shumë gjëra dhe aktivitete të përbashkëta në jetë. Secili ka rol dhe vend të veçantë. Ju faleminderit që jeni pjesë e jetës sime!

KOHA: Si mund ta përshkruani "Oden Dibrane", pra shoqatën?

KRIFCA: "Oda dibrane-Shkup" është diçka e jashtëzakonshme për mua. Është nder dhe privilegj të jesh anëtar i saj. Unë si kryetar i saj, ndjej edhe më shumë përgjegjësinë dhe frymën e saj. Qëllimi kryesor i Shoqatës "Oda dibrane – Shkup", është të ruajë dhe kultivojë traditat dibrane të mirënjohura në të gjitha trevat shqiptare. Aktivitetet kryesisht janë ndodhi të ndryshme të natyrës shoqërore, letrare dhe historike lidhur me Dibrën, dibranët dhe shqiptarët në përgjithësi. Organizojmë takime të ndryshme si mbremje dibrane (dy vitet e fundit me rastin e Ditës së Flamurit organizuam në bashkëpunim me "Sofrën gjakovare-Shkup" mbremje dibrane-gjakovare), si edhe promovime të ndryshme të librave të autorëve dibrane dhe libra kushtuar Dibrës dhe takime të ndryshme me qytetarë, kandidatët për kryetarë të komunës dhe aktiviteteve humanitare në rastet e bashkëqytetarëve, të cilët kanë nevojë si edhe aktivitete kulturore - sportive. Shpresojmë se në vitet në vijim do të zgjerojmë fushëveprimin e aktiviteteve tona.

KOHA: Besoni se zgjedhjet vendosin fatin tënd: Talenti qëndron në zgjedhjet që bëni?

KRIFCA: Zgjedhjet të cilat njeri i bën në jetë, shpesh herë përcaktojnë fatin e tij. Natyra e njeriut është e tillë që shpesh zgjedhjet i bën edhe në mënyrë emocionale, që ndonjëherë edhe mund të sjellin edhe rezultate të gabueshme. Por, gjithsesi, edhe zgjedhja thjesht racionale jo gjithmonë është e suksesshme. Njeriu duhet të kombinojë të dyja këto, duke përfshirë edhe kushtet dhe rrethanat si edhe mundësitë ku jeton, që të arrijë atë që është më e mira në jetë.

KOHA: Cila është më e rëndësishme, shëndeti, lumturia, paraja?

KRIFCA: Pikërisht në këtë radhitje siç edhe parashtrohet pyetja. Shëndeti personal dhe ai i njerëzve dhe miqve më të afërt, është padyshim më i rëndësishëm në jetë. Lumturia, gëzimi dhe jeta me sa më pak brengë dhe vështirësi (që shpesh edhe varen nga shëndeti), vijon me rëndësi në jetë. E tërë kjo, e kombinuar me një sasi të mjaftueshme të parave (pa të cilat fatkeqsisht nuk imagjinohet jeta bashkëkohore) bëjnë që njeri të ndjehet mirë dhe i lumtur. Por, gjithsesi, liria në jetë, miqtë e mirë, mundësia që të bësh punën që e do, e plotësojnë jetën dhe bukurinë e saj. Jeta padyshim është e bukur dhe e shkurtër. Është gjithashtu e shtrenjtë. Prandaj duhet shfrytëzuar secili moment në jetë që t'i gëzohemi asaj. Siç thotë edhe një mendimtar: "Jeta nuk matet me numrin e frymëmarrjeve në të, por me momentet që të frymëzojnë dhe ndalin frymën".

TOBY VOGEL PËR RADIO EVROPA E LIRË

PËR SERBINË ËSHTË MË LEHTË NËSE E NJEH KOSOVËN



“Më së lehti do të ishte që Beogradi, më në fund, të pranonte faktin që e ka humbur Kosovën dhe që e ka humbur, jo për shkak të bombardimeve të NATO-s, por për shkak të veprimeve të veta gjatë më shumë dekadave në Kosovë. Në qoftë se do ta pranonte këtë, atëherë përfundimi logjik do të ishte që ta pranojë të drejtën e Kosovës për vetëvendosje...”, ka thënë Vogel

Pranimi i faktit që Serbia e ka humbur Kosovën, do të ishte zgjidhja më e lehtë për Beogradin, në rrugën e kësaj të fundit drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Kështu është shprehur në një bisedë me shërbimin e Ballkanit të Radios Evropa e Lirë, Toby Vogel, njohës i zhvillimeve në Ballkan dhe analist në Qendrën për Studime Politike Evropiane në Bruksel. “Më së lehti do të ishte që Beogradi, më në fund, të pranonte faktin që e ka humbur Kosovën dhe që e ka humbur, jo për shkak të bombardimeve të NATO-s, por për shkak të veprimeve të veta gjatë më shumë deka-

dave në Kosovë. Në qoftë se do ta pranonte këtë, atëherë përfundimi logjik do të ishte që ta pranojë të drejtën e Kosovës për vetëvendosje, që do të nënkuptonte pavarësinë dhe sovranitetin e plotë, jo vetëm de facto, por edhe pavarësinë legale. Me fjalë të tjera, më së lehti do të ishte që Beogradi ta pranojë Kosovën”, ka thënë Vogel. Ndonëse faza e re e dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është në përgatitje e sipër, ende nuk është bërë e ditur se çfarë do të përfshijë. Përfaqësuesja e lartë e Bashkimit Evropian, Federica Mogherini, ka thënë se dialogu do të shënoj një

“kërcim kualitativ” deri në fund të vitit 2018, atëherë kur edhe zonjës Mogherini i përfundon mandati. Por, Vogel ka theksuar se duhet pasur kujdes ndaj tendencës që gjërat të përshpejtohen, vetëm sepse ekzistojnë afate artificiale. “Në qoftë se dy vendet, Kosova dhe Serbia, nuk janë të gatshme që ta përmbyllin një marrëveshje kyçe, të cilën të dy vendet do ta respektonin, atëherë nuk mendoj se që është e dobishme që të arrihet një marrëveshje e tillë, sepse do të jetë vetëm një copë letrë, e cila do të lihet pas dore më vonë. Kemi pasur raste të tilla në të kaluarën”, ka theksuar Vogel. Ai ka

shtuar se është fakt që Bashkimi Evropian nuk ka ndonjë strategji tjetër për Ballkanin Perëndimor, përveç zgjerimit. Sipas tij, ekzistojnë procese paralele, të cilat i mbështetë Bashkimi Evropian, sikurse procesi i Berlinit ose bisedimet ndërmjet Prishtinës dhe Beogradit, ndonëse proceset e tilla, në një masë, janë të pavarura nga njëra-tjetra. Vogel ka shprehur mendimin se Bashkimi Evropian duhet t’i shqyrtojë mundësitë se si mund t’i ndihmojë vendet e Ballkanit Perëndimorë, që ato t’i reformojnë sistemet e tyre vendore, të drejtësisë, të ekonomisë dhe sociale, në mënyrë që ato të bëhen vende më të mira. Një gjë e tillë, siç thotë ai, do të çonte gati se automatikisht drejt shndërrimit të tyre në kandidatë shumë më të besueshëm për anëtarësim në BE. Siç është thënë edhe më herët, Serbia, por edhe Mali i Zi,

do të jenë anëtarët e ardhshme të Bashkimit Evropian. Por, Serbia do të bëhet anëtare pa Kosovë, të cilën e quan pjesë të saj. Në këtë rast, Vogel konsideron që nuk ekziston rreziku që pesl vendeve të Bashkimit Evropian që nuk e njohin shtetin e Kosovës, t’i shtohet edhe një vend, në këtë rast Serbia, gjë që do ta vë shtirësonte rrugën e Kosovës kah Bashkimi Evropian. “Jo, sepse do të duhet që të ekzistojë qartësi e shkajshme rreth kësaj çështje: që Serbia nuk do të mund të bllokojë Kosovën në rrugën drejt anëtarësimit për shkak të çështjes së statusit ose për shkak se Serbia konsideron se është çështje e statusit. Duhet të ekzistojnë qartësi absolute se kjo nuk do të ndodhë. Natyrisht që Serbia nuk do të pengohet në bllokimin e Kosovës në çështjet tjera. Gjithmonë do të ketë çështje të tjera, të cilat do të shfrytëzohen si mjete për bllokim. Në mënyrë ironike, Kosova ka problem të njëjtë me Qipron, ashtu sikurse me Serbinë. Kundërshtimi i Qipros për ta pranuar pavarësinë e Kosovës, në fakt ndërlidhet me situatën në Qipro dhe jo me miqësinë e saj me Beogradin”, ka thënë Vogel. Sipas tij, edhe në qoftë se Beogradi do ta njihte që nesër Kosovën, është vështirë e besueshme që edhe Qipro do ta bënte të njëjtën gjë.

Ballkani të përballet me të kaluarën



“Jam i shokuar për vetëvrasjen e Slobodan Praljakut dhe gabimet në masat e sigurisë janë të pafalshme”, thotë për DW-në Wolfgang Petritsch, ish-përfaqësues i lartë për Bosnjen dhe Hercegovinën. Por sipas tij megjithë këtë Gjykata e Hagës ka bërë një punë të mirë për zbardhjen e krimeve të luftës në ish-Jugosllavi. Tani duhet që në rajon të nisë pajtimi dhe nismën për këtë duhet ta marrin njerëzit dhe politika, thekson politikani socialdemokrat austriak. Sipas Wolfgang Petritsch pas përfundimit të punës së gjykatës ndërkombëtare duhet që në nivel nacional të forcohet ligji dhe gjykatat. Detyra e tyre dihet të jetë jo vetëm luftimi i korrupsionit, por ato duhet edhe të vazhdojnë proceset për krime lufte. Po ashtu duhet të

Pas përfundimit të Tribunalit të Hagës e kanë radhën vendet e Ballkanit që të përballet me të kaluarën, mendon Wolfgang Petritsch

forcohet shoqëria civile, e cila në Serbi është e fortë dhe që duhet të bëhet më aktive edhe në vendet e tjera të rajonit. Përbalja me të kaluarën duhet të bëhet prej të gjithëve, mendon Wolfgang Petritsch, pavarësisht nëse ata e shohin veten në rolin e viktimës apo konsiderohen si kriminelë. Sa i përket këmbënguljes së disa politikanëve në narativet nacionaliste dhe etnike, apo pretendi-

mit të presidentit të Republika Srpska, Milorad Dodik, për të vënë në diskutim kufijtë ekzistues, Wolfgang Petritsch thotë se vënia në diskutim e kufijve do të shkaktojë tragjedi të reja. “Faktori etno-nacional është njëri prej faktorëve, por jo vendimtar për paqen në rajon. Integrimi evropian bën të qartë se në një hapësirë të madhe mund të përjetohej të përbashkëta si ekonomikisht edhe kulturalisht”, thotë Petritsch. Sipas tij bashkëpunimi me Evropën duhet të jetë sidomos për serbët prioritet absolut, “sepse vetëm në një Evropë të bashkuar serbët mund të jenë të bashkuar. Një bashkim në një krijesë multietnike apo multinacionale si ish-Jugosllavia, nuk mund të krijohet më. Efektet pozitive mund të arrihet vetëm në një Evropë më të madhe dhe ky vizion duhet të rrenjose më thellë në zemrat dhe mendjet e njerëzve”, thotë Petritsch. Diplomati austriak Wolfgang Petritsch ishte nga viti 1999 deri 2002 Përfaqësues i lartë për Bosnjen dhe Hercegovinën.

Në këtë funksion ai drejtoi zbatimin e marrëveshjes së Dejtonit të 14. dhjetorit 1995, që nënshkruan ish-presidentët Slobodan Milosheviq, Franjo Tugjman (Kroaci) dhe kryetari i presidiumit boshnjako-hercegovinas Alija Izetbegoviq.

Miratojeni Demarkacionin, është i saktë!

Pavarësisht raportimit të Komisionit të Ri për Shënjimin e Kufirit me Malin e Zi, i cili konstatoi se Kosova humb territor nga versioni aktual i Demarkacionit, përfaqësuesit e huaj diplomatikë në Kosovë kanë thënë se kjo marrëveshje është e saktë dhe si e tillë duhet ratifikuar. Madje sipas tyre, komisionet e mëparshme (duke përfshirë edhe atë ndërkombëtar) kanë bërë një ekzaminim të përgjithshëm rreth kësaj marrëveshjeje që tregon për saktësinë e kësaj marrëveshjeje. Ambasada e Francës në Kosovë ka thënë për “Zërin” se të dyja palët, edhe ajo e Kosovës, edhe ajo e Malit të Zi, ishin pajtuar që ta nënshkruanin Marrëveshjen e Demarkacionit para më shumë se dy vjetësh. “Marrëveshja për Demarkacionin e Kufirit, e arritur në vitin 2015, ishte nënshkruar nga Qeveria e Malit të Zi dhe nga Qeveria e Kosovës. Të dyja palët u pajtuan kështu së bashku për të definuar vijën kufitare”, thuhet në përgjigjen e kësaj Ambasade. Andaj, sipas zyrtarëve të saj, Marrëveshja e Demarkacionit mes dy shteteve duhet të miratohet. Ndërkaq, Ambasada e Norvegjisë në Kosovë ka deklaruar se marrëveshja në fjalë, e arritur në vitin 2015, është krejtësisht e saktë. “Norvegjia beson se komisionet e mëparshme si në Kosovë, ashtu edhe në nivel ndërkombëtar, kanë bërë një ekzaminim gjithëpërfshirës, tërësor dhe objektiv të demarkacionit të kufirit midis Kosovës dhe Malit të Zi dhe beson se demarkacioni i përfunduar në marrëveshjen aktuale është e saktë”, thuhet në përgjigjen e Ambasadës Norvegjeze dhënë “Zërit”. Edhe Zyra e Bashkimit Evropian në Kosovë (BE), ka kërkuar që Kosova ta gjejë një zgjidhje sa i përket marrëveshjes së demarkacionit. “Është thelbësore që Kosova ta gjejë zgjidhjen më të mirë për bllokimin aktual të demarkacionit përmes një debati të përfaqësuesve të zgjedhur dhe një vote e cila jep mbi bazën e pritjeve legjitime të popullit të Kosovës dhe të ardhmes së tyre evropiane”, ceket në përgjigjen e zyrës së BE-së dhënë “Zërit”.

Mjekët shpallin gabimisht të vdekur foshnjën, e gjithë India në këmbë

Dy doktorë u përjashtuan nga puna, pasi kishin shpallur gabimisht të vdekur një fëmijë të porsalindur. Prindërit nga Dehli i Indisë zbuluan se foshnja ishte gjallë gjatë

kohës që po shkonin në varrimin e tij. Incidenti nxiti zemërim pothuajse të gjithë Indisë dhe debat mbi cilësinë e kujdesit shëndetësor privat, i cili shpesh është i kushtue-

shëm. Ndërsa zyrtarë nga spitali thanë në një deklaratë se ky veprim strikt është marrë në bazë të diskutimeve me ekspertë. "Ndërsa hetimi nga grupi i ekspertëve që përfshin

ekspertë të jashtëm nga Shoqata Mjekësore Indiane është ende në proces, ne kemi vendosur të ndërpresim shërbimet e dy mjekëve të trajtuar", thuhej në një deklaratë.

MARRËVESHJE PËR KUFIRIN



Ekipi i Brexitit i Britanisë së Madhe raportohet se ka rënë dakord që Irlanda e Veriut t'u përmbahet edhe më tej rregullave të BE që e shmangin kufirin e fortë me Republikën. Për tekstin përfundimtar diskutohet më tej

Britania e Madhe me sa duket ka rënë dakord që Irlanda e Veriut të jetë edhe më tej pjesë e tregut të përbashkët të BE dhe e rregullave të bashkimit doganor, që evitojnë një kufi të fortë me Republikën pas Brexitit. Në projektin e tekstit, të cilin raporton se e ka parë media irlandeze, sipas informacioneve thuhet se "Mbretëria e Bashkuar do të sigurojë vazhdimin e harmonizimit me

rregullat e tregut të brendshëm dhe të bashkimit doganor, tani ose në të ardhmen, do të mbështesë bashkëpunimin Veri-Jug dhe mbrojtjen e marrëveshjes së të Premtes së Mirë". Megjithatë mbetet e paqartë se çfarë do të thotë saktësisht formulimi "harmonizim me rregullat", besohet se ai ka të bëjë me rregullat e tregut të përbashkët që mbështesin bashkëpunimin midis Irlandës së Veriut dhe Republikës së Irlandës. Qeveria irlandeze e kërkoi një angazhim të tillë. Më herët të hënën, ministri i Evropës i Irlandës, Helen McEntee i tha BBC se Irlanda do të kundërshtojë çdo propozim që nuk do të garantonte që të mbetet i hapur

kufiri midis Irlandës së Veriut dhe Republikës. Negociatat po vazhdojnë dhe bëhet e ditur se qeveria britanike i kundërshton disa elemente të tekstit përfundimtar. Kryeministri irlandez Leo Varadkar tha në Twitter se do të bëjë një deklaratë sot për përparimin e bisedimeve për Brexitin. Teksti për Irlandën e Veriut është pjesë e dokumentit me titull "Raporti i Përbashkët" i Komisionit Evropian dhe i negociatorëve të Mbretërisë së Bashkuar. Veç çështjes së kufirit irlandez, çështje të tjera për zgjidhje midis BE dhe Britanisë së Madhe janë marrëveshja për detyrimet financiare të Britanisë së Madhe dhe ajo për të drejtat e qy-

tetarëve të Bashkimit Evropian. Ekipi negociues i BE i ka dhënë kohë deri sot Britanisë për të dëshmuar se është bërë përparim i mjaftueshëm në negociatat për Brexitin, në mënyrë që të avancojnë bisedimet. Elmar Brok, anëtar i grupit të Parlamentit Evropian që negocion për Brexitin tha se beson se "ka shanse shumë të mira" për të arritur një marrëveshje. Brok shtoi se është "i habitur" sa kanë avancuar negociatat dhe shtoi se dallimet konsistojnë vetëm "në pak fjalë". Kryeministria britanike, Theresa May do të diskutojë sot për ecurinë e negociatave me Presidentin e Këshillit Evropian, Donald Tusk.

Biznesmenët që e largojnë pasurinë kryejnë "tradhti"



Presidenti i Turqisë, Recep Tayyip Erdogan, ka thënë se biznesmenët që përpiqen ta largojnë pasurinë jashtë vendit, kryejnë "tradhti". Gjatë një raporti në televizion, Erdogan mbrëmë theksoi se "jam i vetëdijshëm se disa biznesmenë po përpiqen t'i dërgojnë pasuritë e tyre jashtë vendit" dhe ka shtuar se i ka bërë thirrje qeverisë "që të mos i autorizojë këto lëvizje, pasi ato janë akte të tradhtisë". Megjithatë, ai nuk e ka përmendur ndonjë emër të biznesmenëve eventuale, që janë përpjekur ta largojnë pasurinë nga Turqia. Këto komente u bënë vetëm disa ditë pasi prokurorët urdhëruan konfiskimin e pasurisë së një tregtari me ar me shtetësi turko-iraniane, i cili në një gjykatë në Nju Jork po dëshmon kundër një bankieri turk të akuzuar se i ka shkelur sanksionet e Shteteve të Bashkuara kundër Iranit. Në dëshminë e tij, biznesmeni me ermin, Reza Zarab, e ka akuzuar Erdoganin dhe zyrtarët e tjerë qeveritarë, se kanë marrë pjesë në nënshkrimin e një transaksioni në skemën prej 1 miliard dollarësh për t'i pastruar parat iraniane nga shitja e naftës dhe gazit, nëpërmjet transaksioneve me ar, në mënyrë që Iranit t'i mundësohej shfrytëzimi i fondeve në aspektin ndërkombëtar duke i shkelur sanksionet e Shteteve të Bashkuara.

Presidenti i Francës, Emmanuel Macron, u shpreh "i shqetësuar" nga mundësia që presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, të njohë Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit. Në një bisedë telefonike me Trumpin, Macron tha se çdo vendim për statusin e qytetit "duhet të merret brenda kornizës së negociatave midis izraelitëve dhe palestinezëve". Paralajmërimet të ngjashme kanë bërë edhe disa vende arabe dhe myslimane. Sipas disa raporteve, Trump do ta njohë Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit këtë javë. Ky qytet është pika më e nxehtë e konfliktit izraelito-palestinez. Palestinezët e konsiderojnë atë si kryeqytet të shtetit të tyre të ardhshëm. Izraeli, ndërkaq, e ka pushtuar Jerusalemin Lindor në luftën e vitit 1967 dhe pretendon se

Çështja e Jerusalemit, Macron dhe Turqia paralajmërojnë Trumpin




i gjithë qyteti është kryeqytet i tij. Megjithatë, sovraniteti i Izraelit mbi Jerusalemin nuk është njohur kurrë ndërkombëtarisht dhe të gjitha vendet i kanë ambasadat e tyre në Tel Aviv. Trump ka para-

lajmëruar se do ta zhvendosë edhe ambasadën amerikane në Jerusalemin. Kundër Trumpit ka reaguar edhe Turqia. Zëdhënësi i Presidencës së Turqisë, Ibrahim Kalin deklaroi se janë tejet shqetësues

lajmet për paralajmërimet se SHBA do të njohin Jerusalemin si kryeqytet të Izraelit. "Kjo do të jetë një shkelje e rëndë e statusit fetar dhe historik të Jerusalemit, si dhe marrëveshjeve dhe vendimeve ak-

tuale ndërkombëtare të Kombeve të Bashkuara", porositi Kalin. Presidenti amerikan Donald Trump gjatë fushatës zgjedhore të vitit të kaluar premtoi se do të zhvendosë ambasadën amerikane në Izrael nga Tel Avivi në Jerusalemin, kurse sipas pretendimeve të mediave amerikane, Shtëpia e Bardhë është duke përgatitur procesin e shpalljes së Jerusalemit kryeqytet të Izraelit. Kalin paralajmëroi se një hap i tillë do t'i jepte fund procesit edhe ashtu të brishtë të paqes dhe do të nxiste konflikte dhe tragjedi të reja në Lindjen e Mesme. "Shpresojmë se SHBA nuk do të bëjë këtë gabim katastrofal. Është e një rëndësie kyçe që të ruhet statusi i Jerusalemit dhe Harem Sherifit", theksoi Kalin në deklaratën e tij.



KOMISIONI RREGULLATOR PËR
ENERGJETIKË I REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË



Në bazë të nenit 10 paragrafi 3 të Rregullores për mënyrën dhe procedurën për përcaktimin e tarifës për shërbime të ujit dhe tarifës rregullator për shërbim të ujit ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 63/17), Komisioni rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

KUMTESË

Lajmërohen të gjitha subjektet e interesuara juridike dhe fizike se NP Isar Shtip më datë 25.09.2017 deri tek Komisioni rregullator për energjetikë ka parashtruar Kërkesë për përcaktim të tarifës për furnizim me ujë për pije ose furnizim të ujit për periudhën e rregulluar 2018-2020, të shënuar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr. 08-176/17 të datës 25.09.2017 dhe Kërkesë për përcaktim të tarifës për grumbullim dhe mënjanim të ujërave të zeza urbane të shënuar në arkivin e Komisionit rregullator nën numrin UP1 nr. 08-177/17 të datës 25.09.2017.

Me Kërkesat e parashtruara, NP Isar Shtip kërkon që të ardhurat e rregulluara për secilin vit nga periudha e rregulluar dhe tarifat përkatëse për secilin shërbim të ujit të jenë:

1. Për furnizim me ujë për pije ose furnizim me ujë:

		2018	2019	2020
Të ardhurat e rregulluara	denarë	109.537.524	114.012.277	118.253.275
Sasia e ujit të porositur	nm ³	2.281.076	2.281.856	2.295.191
Tarifa mesatare	den/nm ³	45,16	43,06	44,53

2. Për grumbullim dhe mënjanim të ujërave të zeza urbane:


		2018	2019	2020
Të ardhurat e rregulluara	denarë	36.597.872	38.651.381	41.578.674
Sasia e ujërave të grumbulluar dhe të mënjnuar të zeza urbane	nm ³	2.277.460	2.278.251	2.279.079
Tarifa mesatare	den/nm ³	15,96	16,78	17,59

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike, mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën e publikuar mund t'i parashtrorin më së voni deri më 11.12.2017 deri në ora 12.00 në Komisionin rregullator për energjetikë, përmes:

- E-mail: erc@erc.org.mk
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: rr. Makedonija nr. 25, pallati Llazar Pop Trajkov – kati 6, 1000 Shkup

Shkup, 05.12.2017

KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGJETIKË
I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



KOMISIONI RREGULLATOR PËR
ENERGJETIKË I REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË



Në bazë të nenit 23 të Rregullores për mënyrën dhe kushtet për rregullim të tarifave për përcim, menaxhim me sistemin për përcim dhe distribuim të gazit natyror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 201/2016 dhe 87/2017), Komisioni rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

KUMTESË

Informohen të gjitha subjektet e interesuara juridike dhe fizike se **Drejtoria për zona të zhvilluara teknologjike dhe industriale**, si bartës i licencave për kryerje të veprimtarive energjetike "distribuim të gazit natyror", "menaxhim me sistemin për distribuim të gazit natyror" dhe "furnizim me gaz natyror të shpenzuesve tarifor të kyçur në sistemin për distribuim të gazit natyror", deri tek Komisioni rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë më datë 24.11.2017 ka parashtruar Kërkesë për aprovim të të hyrave të rregullta dhe tarifave për vitin 2018.

Me Kërkesën e parashtruar, Drejtoria për zona të zhvilluara teknologjike dhe industriale, kërkon tarifa mesatare për vitin 2018 të jetë:

Përshkrim		2018
Tarifa	den/nm ³	2,7957


Mendimet dhe propozimet në lidhje me të dhënat e publikuara nga Kërkesa, subjektet e interesuara fizike dhe juridike mund t'i dorëzojnë më së voni deri në ora 12.00 më datë 11.12.2017 në Komisionin rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë, përmes:

- E-mail: erc@erc.org.mk
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: rr. Makedonija nr. 25 pallati Llazar Pop Trajkov kati 6, 1000 Shkup

Shkup, 05.12.2017

UP1 nr. 08-189/17

KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGJETIKË
I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



KOMISIONI RREGULLATOR PËR
ENERGJETIKË I REPUBLIKËS SË
MAQEDONISË



Në bazë të nenit 23 të Rregullores për mënyrën dhe kushtet për rregullim të çmimeve për përcim, menaxhim me sistemin për përcim dhe distribuim të gazit natyror ("Gazeta Zyrtare e RM" nr. 201/2016 dhe 87/2017), Komisioni rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë në vijim publikon

KUMTESË

Lajmërohen të gjithë personat e interesuar juridik dhe fizik se **Shoqëria Aksionare GA-MA Shkup**, si bartës i licencave për kryerje të veprimtarive energjetike "përcim të gazit natyror" dhe "menaxhim me sistemin për përcim të gazit natyror", deri tek Komisioni rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë më datë 29.11.2017 ka shtruar Kërkesë për leje të ardhurave të rregulluara dhe tarifat për veprimtaritë përcim dhe menaxhim me sistemin për përcim të gazit natyror për vitin 2018 për periudhën e rregulluar 2017 – 2021.

Me Kërkesën e shtruar, Shoqëria Aksionare GA-MA Shkup, kërkon të ardhurat e rregulluara dhe tarifa mesatare për veprimtaritë përcim dhe menaxhim me sistemin të gazit natyror të arrijë:

Përshkrimi		2018
Të ardhurat e rregulluara	Denarë	270.276.676
Sasia e planifikuar e gazit natyror për përcim	nm ³	158.830.000
Tarifa	den/nm ³	1,7017

Mendimet dhe propozimet në lidhje me të dhënat e publikuara nga Kërkesa, personat e interesuar juridik dhe fizik mund t'i dorëzojnë më së voni deri në ora 12.00 më datë 11.12.2017 në Komisionin rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë, përmes:

- E-mail: erc@erc.org.mk
- Faks: 02/ 32 33 586
- Adresa: rr. Makedonija nr. 25 pallati Llazar Pop Trajkov kati 6, 1000 Shkup

Shkup, 05.12.2017

UP1 nr. 08-191/17

KOMISIONI RREGULLATOR PËR ENERGJETIKË
I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË



REPUBLIKA E MAQEDONISË

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup
Fakulteti për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike



Në bazë të nenit 131 dhe nenit 135, paragrafi 1 të Ligjit për arsim sipëror dhe nenit 34 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë-doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" – Shkup, Dekani i Fakultetit për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike në Shkup publikon:

KONKURS
Për zgjedhje në titujt

1. Zgjedhje të një mësimdhënësi në të gjitha titujt mësimor-shkencor në të gjitha sferat mësimore shkencore në fushën mësimore-shkencore informatikë dhe fushën mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatika
2. Zgjedhje të asistentit doktorantit në të gjitha sferat mësimore-shkencore në fushën mësimore-shkencore informatikë dhe fushën mësimore-shkencore teknika kompjuterike dhe informatika

Kushtet: Krahas kushteve të përgjithshme kandidatët duhet ti plotësojë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimor-shkencor, mësimor-profesional dhe bashkëpunues dhe asistentë dhe doktorantë të Universitetit "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup.

Orari i punës do të përcaktohet në pajtim me orarin e orëve.

Pagesa për pozitën 1 lëvizë prej 28.000,00 deri më 44.000,00 denarë.

Pagesa për pozitën 2 lëvizë prej 21.500,00 deri më 32.000,00 denarë.

Për pozitën 1 së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje sipas konkursit në të cilën do të qëndrojë se për cilën pozitë paraqiten, dokument për arsimin e mbaruar përkatës, (diplomat e huaja të jenë të nostrifikuara dhe të plotësuar me ekuivalencë të notave), biografi të shkurtë, certifikatë të shtetësisë, listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale (nga një kopje të punimeve);

Për pozitën 2 së bashku me fletëparaqitjen kandidatët duhet të dorëzojnë: fletëparaqitje për konkurs, dokument për mbarim të arsimit përkatës – sukses mesatar prej së paku 8,50 në ciklin e parë dhe të dytë të studimeve (diplomat e huaja të jenë të nostrifikuara dhe të plotësuar me ekuivalencë të notave), biografi të shkurtë, certifikatë të shtetësisë vërtetim për njohje të gjuhës angleze edhe atë (TOEFL) – së paku 74 pikë për dhënie të provimit në mënyrë elektronike përmes kompjuterit jo më të vjetër se dy vjet nga dita e dhënies, (IELTS) – së paku 6 pikë jo më të vjetër se dy vjet nga dita e dhënies, (TOLES) – njohje bazike (Foundation level), (ILEC) – të dhënë me sukses më së paku (B2) dhe Kembrixh certifikatë për gjuhë angleze preliminare (Cambridge Certificate of Preliminary English) - (B1), listë të punimeve të publikuara shkencore dhe profesionale (nga një kopje të punimeve – kopje);

Zgjedhja do të realizohet në afatin e paraparë në nenin 131 të Ligjit për arsim sipëror (deri në 6 muaj nga publikimi i konkursit)

Dokumentet të dorëzohen në origjinal ose kopje të vërtetuar në noter – fletëparaqitjet të cilat nuk janë të plotësuar nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit.

Fletëparaqitjet të dorëzohen më së voni 8 ditë nga dita e publikimit të konkursit në Dekanatin e Fakultetit për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike, rr. Rugjer Boshkoviç 16, Shkup.

Fakultetit për shkencë informatike dhe inxhinieri kompjuterike

PROFILE

MEHMET DERRALLA, KRAHU I DJATHTË I ISMAIL QEMALIT

Deri sa delegacioni shqiptarë ndodhej në Evropë, qeverisjen e vendit Ismail Qemali, ia kishte besuar Ministrit të Luftës Mehmet Derrallës dhe jo zëvendësit të tij, Dom Nikollë Kaçorit. Por, as edhe kryetarit të Senatit, Vehbi Dibrës

Dr. Vebi XHEMALI

Kuvendi Kombëtar i Vlorës i udhëhequr nga diplomati më i shquar shqiptar Ismail Qemali, pas Shpalljes së Pavarësisë, menjëherë iu rekë punës për themelimin e shtetit modern shqiptar, me tipare të shteteve evropiane. Dy ditë pas Shpalljes së Pavarësisë, kryetari i Qeverisë së Përkohshme, Ismail Qemali propozoi zgjedhjen e organeve drejtuese të shtetit të ri shqiptar. Pasi dështoi propozimi i parë, Ismail Qemali doli me propozim të ri, duke e shtuar numrin e ministrive nga gjashtë në tetë ministri, që u pranua një zëri nga të gjithë delegatët. Në mbledhjen e tij të pestë më 4 dhjetor. Mbledhja filloi me 3 dhjetor dhe zgjati deri më 4 dhjetor. Senati kësaj radhe në seancën e pestë arriti të verifikojë emrat e ministrave të Parë të Qeverisë së Vlorës. Senati të gjithë kandidatët e propozuar nga vetë Ismail Qemali, i futi në votim të fshehtë, nga 63 delegatë të pranishëm ishin vetëm 57, vendi i tretë i takoi Gjeneralit tetovar, i cili mori 42 vota, pas Luigj Gurakuqit e Mufid Beut.

Në këto rrethana të vështira për Shqipërinë kur disa feudalë shqiptarë për interesa të veta personale e lëshuan Qeverinë e Ismail Qemalit dhe bënë çdo ditë pengesa në funksionimin e qeverisjes dhe demokratizimit të vendit. Disa shkuan aq larg sa që kërkonin si në vend po ashtu edhe nga diplomacitë e e huaja largimin e Ismail Qemalit, si Kryetar i Qeverisë së Përkohshme, udhëheqës të i këtij grupi që ishin më të pakënaqur ishte Sureja bej Vlorë. Kjo rrymë erdhi në shprehje pas disa muajve, me formimin e qeverisë së Esat Pashës më 12 sh-

tator 1913, në taborin e Esat Pashës, ku u futën edhe emra të njohur të Lëvizjes Kombëtare Shqiptare: Ndër ta ishin: Preng Bib Pasha, Mehdi Frashëri, Syreja Bej Vlorë, Bedri Pejani e tjerë. Pas përfundimit të Kryengritjes së Dibrës, në Qeverinë e Esatit shkuan edhe Hasan Prishtina, Vehbi Dibra, Dervish Hima e shumë të veprimtarë të tjerë.

Gjeneralit tetovar, Mehmet Derralla, 69 vjeçar, u zgjodh ministër i Parë i Luftës në Qeverinë e Ismail Qemalit, i lindur në Tetovë, që në atë kohë së bashku me Gostivarin ishin pjesë e pandarë e Vilajetit të Kosovës deri në vitin 1912, me kryeqytet Shkupin. Pra, Kosova dhe trevat tjera lindore shqiptare deri në Manastir e Ohër si bartës kryesor të luftës katër vjeçare e fitoi vetëm një post ministror me peshë në Qeverinë e Përkohshme të Ismail Qemalit.

Më besnik deri në fund të qeverisjes së Ismail Qemalit, ngeli vetëm Mehmet pashë Derralla. Kjo më së miri shihet kur më 30 mars të vitit 1913, Ismail Qemali u nis në krye të delegacionit shqiptar së bashku me: Isa Boletinin, Dhimitër Beratin dhe Luigj Gurakuqin për zëvendës të tij e la Mehmet Derrallën.

Takimin e parë delegacioni shqiptar i udhëhequr nga Ismail Qemali, e pati në Romë, më 1 prill me ministrin e punëve të Jashtme të Italisë, San Xhulianon, ku kryetari i Qeverisë Shqiptare, kërkoi nga ai sqarim në lidhje me caktimin jo të drejtë të kufijve etnik pas vendimit të 22 marsit, pasi tani më ishte marrë vesh se Konferenca kishte lënë jashtë kufijve shtetërorë të Shqipërisë, gjysmën e territoreve të saja. Por, ministri italian jo që nuk pranoi kërkesat e delegacionit shqiptar, por u mundua së bashku me ambasadorin austriak në Romë, Mereyt, që ta bindin delegacionin shqiptar që të kthehet e të prapë për në Vlorë. Delegacioni shqiptar nuk pranoi kthimin prapa, por vazhdoi misionin e tyre nëpër qendrat Evropiane, ku qëndroi përafërsisht

sht tre muaj nëpër shtetet e Fuqive të Mëdha: Romë, Vjenë, Paris, Londër, duke të protestuar kundër vendimeve të padrejta, pasi Fuqitë e Mëdha me vendimin e tyre arbitrare më 22 mars 1913, e kishin ndarë Shqipërinë në dy pjesë: të lirë dhe të robëruar.

Ky vendim arbitrar i Fuqive të Mëdha ishte në kundërshtim me vullnetin e shprehur të popullit shqiptarë të shprehur vullnetarisht nga vetë delegatët e saj në Kuvendin Mbarëkombëtar të Vlorës më 28 Nëntor 1912. Deri sa delegacioni shqiptarë ndodhej në Evropë, qeverisjen e vendit Ismail Qemali, ia kishte besuar Ministrit të Luftës Mehmet Derrallës dhe jo zëvendësit të tij, Dom Nikollë Kaçorit. Por, as edhe kryetarit të Senatit, Vehbi Dibrës. Mehmet Derralla, ishte dhe mbeti krahu i djathtë i Ismail Qemalit,

edhe pse mbante postin e Ministrit të Luftës e përkrahu fuqishëm qëndrimin diplomatik të Ismail Qemalit dhe kurrë nuk u pajtua me vendimin e Fuqive të Mëdha. Prandaj ky në bashkëpunim me Isa Boletinin e Ajdin Dragën u dërguan Qeverive të Mëdha një memorandum ku kërkonin, përsëri drejtësi, për rishikimin e kufijve Verilindor nga gjashtë Fuqitë e Mëdha. Në këtë memorandum thuhej: "Ne nuk mund të rimë të qetë, ku një popullsi prej një milion shqiptarësh mysliman e katolik të bien nën sundimin serbo-malazez, ku përqindja e saj në këto territore shqiptare nuk arrin mbi 5%", këtë mund ta verifikoni në teren, me dërgimin e një Komisioni të Lartë evropian.

Për qëndrimin atdhetarë të Ministrit të Luftës Mehmet pashë Derrallës, na jep të dhëna i dërguari special i Nikolla Pashiqit, Ballugçiqi, i cili thotë: "Vetëm Mehmet Tetova është më i vendosur kundër bisedave për një marrëveshje të ardhshme shqiptaro-serbe". Siç dihet kryetari e Qeverisë serbe, Nikolla Pashiqi, kërkonte nga Qeveria Shqiptare lidhjen e një marrëveshje, në bazë të së cilës Beogradi zotohej se do t'i jepte përkrahje Qeverisë së Përkohshme Shqiptare, në rast se kjo pranonte vijën kufitare që do të caktonte Serbia dhe nuk do të kundërshtonte kërkesën e saj që Durrësi të caktohej pika tregtare e Serbisë. Këto kërkesa serbe i refuzoi vendosmërisht Ismail Qemali, ky nuk pranoi të takohet as me Ballugçiqin, e as me ithtarët e tij në Vlorë. Nikolla Pashiqi e urdhëroi Ballugçiqin që ta prisnin delegacionin shqiptar kur arrij në Milano, por edhe këtu patën qëndrim të kundërta për një bashkëpunim të ardhshëm shqiptaro-serb. Ismail Qemali i tha Ballugçiqit: "se kur shqiptarët nuk do të pajtohen me ata kufij që i ka caktuar Konferenca e Londrës".

Ministri Mehmet Derralla-Tetova, së bashku me disa ministra në Qeverinë e Përkohshme të Ismail Qemalit, përkrahën fuqishëm çlirimin e vendeve tona nga sundimi

Më 22 janar 1914, për t'i dhënë fund përçarjes brenda vendit, Ismail Qemali, dha dorëheqje nga Qeveria, ku i dorëzoi pushtetin Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Kjo ishte një vepër e burrave të mëdhenj, që janë të rrallë në histori. Ky ishte një akt tejet demokratik dhe kombëtar, për të parandaluar situatën përkeqësuar politike në vend. Për këto arsye në fund u largua përkohësisht nga Shqipëria. Në të njëjtën kohë pushoi edhe funksionimi i Ministrisë së Luftës. Mehmet Derralla pas kësaj periudhe u vendos në Durrës dhe pas ardhjes së Princ Vidit në Shqipëri, Mehmet Tetova, së bashku me Hasan Prishtinën dhe Isa Boletinin u bashkuan me qeverisjen e Princ Vidit, për të mirën e Shqipërisë, duke e vazhduar rezistencën e armatosur kundër sunduesve serbo-malazez.

serb. Kjo shihet më së miri kur Qeveria e Ismail Qemalit përkrahu fuqishëm Kryengritjen e Shtatorit, e cila filloi në Dibër kah fundi i muajit shtator 1913. Prandaj, me themelimin e "Komitetit për çlirimin e viseve të pushtuara", bënte pjesë menjëherë pas Hasan Prishtinës, Isa Boletinit dhe Mehmet pashë Derralla. Ndërsa djali tij Halim Derralla-Tetova, ishte emëruar udhëheqës i kryengritjes të krahinës lindore nga Dibra, Gostivari, Tetova deri në Shkup.

Më 22 janar 1914, për t'i dhënë fund përçarjes brenda vendit, Ismail Qemali, dha dorëheqje nga Qeveria, ku i dorëzoi pushtetin Komisionit Ndërkombëtar të Kontrollit. Kjo ishte një vepër e burrave të mëdhenj, që janë të rrallë në histori. Ky ishte një akt tejet demokratik dhe kombëtar, për të parandaluar situatën përkeqësuar politike në vend. Për këto arsye në fund u largua përkohësisht nga Shqipëria. Në të njëjtën kohë pushoi edhe funksionimi i Ministrisë së Luftës. Mehmet Derralla pas kësaj periudhe u vendos në Durrës dhe pas ardhjes së Princ Vidit në Shqipëri, Mehmet Tetova, së bashku me Hasan Prishtinën dhe Isa Boletinin u bashkuan me qeverisjen e Princ Vidit, për të mirën e Shqipërisë, duke e vazhduar rezistencën e armatosur kundër sunduesve serbo-malazez. Këta vazhduan veprimtarinë e vetë patriotike, në organizimin e luftës deri në vdekje kundër zaptuesve serbo-malazez. Falë këtyre tre udhëheqësve kombëtar u organizua një nga kryengritjet më të mëdha në trevat lindore, e njohur në histori si Kryengritja e Shtatorit, e cila filloi në Dibër me rrethinë në vitin 1913 dhe me të shpejtë u zgjerua në tre drejtime: I pari; Strugë-Ohër-Manastir, i dyti; Dibër-Rekë-Tetovë-Gostivar. Drejtimi i tretë Lumë-Prizren-Pejë. Në luftë për çlirim e bashkim kombëtarë që tronditi diplomacinë evropiane.





Bashkim Shehu fiton çmimin "Balkanica"

Në ceremoninë e mbajtur në Shkup shkrimtari shqiptar është shpallur si më i miri, në një garë ku merrnin pjesë emra të rëndësishëm të letrave ballkanike. Shehu fitoi çmimin e madh me romanin romanin "Loja, shembja e qiellit", botimet Toena. Për këtë roman Shehu është shpallur fitues i çmimit "At Zef Pllumi" – 2013. Po këtë vit juria e Panairit të Librit Fier e nderoi me çmimin "Autor i Vitit" – 2013. Është hera e dytë që shkrimtari Bashkim Shehu, përzgjidhet për të konkurruar në këtë garë letrare ndërballkanike. Në vitin 2007 ai u paraqit me romanin "Angelus novus" dhe arriti të ishte një nga tre të nominuarit e këtij çmimi. Romani "Loja, shembja e qiellit" është botuar në shqip nga Shtëpia Botuese TOENA, në vitin 2013. Për këtë roman dhe vlerat e tij letrare janë shkruar me dhjetëra artikuj vlerësues në mediane dhe shkruar. Në garë për çmimin Balkanica ishte dhe poetja Luljeta Lleshanaku.

Çmimi letrar Balkanica jepet nga Fondacioni Balkanica, me qendër ekzekutive në Sofje të Bullgarisë. Anëtarë të këtij Fondacioni janë shtëpitë botuese: Biblioteka 48 (Bullgari), Toena (Shqipëri), Magor (RM), Kedros (Greqi), Laguna (Serbi), Can (Turqi), Muzeul National al Literaturii Romane (Rumani). Më parë këtë Çmim e kanë marrë shkrimtarët shqiptarë Fatos Kongoli (2002) dhe Ismail Kadare (2009).

EKSPOZITË PERSONALE E BASHKIM MEXHITIT

Janë rreth 30 piktura në teknikën akril, të realizuara gjatë dy vitet e fundit, që pasqyrojnë në formën më të mirë të mundshme ekspresivitetin krijues dhe gjuhën artistike me të cilën artisti ka vendosur t'i flasë këtë herë publikut



"DIMENSIONET KOHORE", NJË RRËFIM NDRYSHE

Koha

Evis HALILI

Shkup, 5 dhjetor – "Dimensione kohore" titullohet ekspozita e piktorit Bashkim Mexhiti që qëndron e hapur në galerinë e Qendrës Informative të Kulturës. Janë rreth 30 piktura në teknikën akril, të realizuara gjatë dy vitet e fundit, që pasqyrojnë në formën më të mirë të mundshme ekspresivitetin krijues dhe gjuhën artistike me të cilën artisti ka vendosur t'i flasë këtë herë publikut. Motivi etimologjik i pikturave, ashtu siç sqaron vetë piktori, pasqyron rrugëtimin e gjatë historik të trojeve tona nëpër kohëra, qëndresën shumëshekullore të periudhave të ndryshme, hyjnizimin e gjuhës, shkrimin e lashtë, si dhe lavdinë e të parëve tanë.

"Të gjitha këto motive thuren në piktura abstrakte ekspresioniste e me shumë simbolikë. Elementet dhe parimet figurative si, ngjyra, tonet, vijat, shkronja si dhe vetë

procesi i veprimit në pikturë janë nën ombrellën e semiotikës dhe flasin me gjuhën e simbolikës, që përfundojnë në kompozicione të dimensionit shpirtëror duke shprehur lirikën e dhimbjes, shpresës dhe dashurisë", thotë piktori. Tradicional dhe simbolik Mexhiti përmes lojës së ngjyrave dhe narracionit figurativ sjell rrëfimin e vet për historinë, qëndresën shqiptare, gjuhën, kulturën. Kritika e vlerëson lirikën në pikturën e tij si një pasqyrim të raportit esencial metaforik të poetikës së formave abstrakte. Në vështrimin e tij për këtë ekspozitë historiani i artit, Mixhait Pollozhani thotë se ky lloj i abstraksionit lirik, i bazuar edhe në spontanitetin e refleksionit të pikturimit të veprimit, me anë të improvizimeve psikike dhe shprehjeve automatike surrealiste, i kundërvihet abstraksionit gjeometrik dhe i hap rrugë abstraksionit të lirë.

"Ai e vetëdijshëm e redukton dhe e transformon figuracionin në

veprat e tij. Simbolet, si përbërës të semiotikës së tij artistike, nga pozicioni i sistemit sekondar marrin funksionin e mjetit aktiv asociativ. Nëpërmjet asociacioneve dhe lojës me gjysmë-forma dhe ngjyra, autori i ofron publikut një mundësi të hapur në perceptimin dhe përjetimin e lirë të veprave artistike. Shikuar nga këndvështrimi i historisë së artit pamor, si përfundim mund të konstatohet se, Bashkim Mexhiti, me takt ka gërshtuar përvojat e enformelit, ekspresionizmit abstrakt dhe abstraksionit lirik. Dhe duke ofruar një variant të kombinuar abstrakt, i cili mban vulën e ekzistenciale dhe artistike të kohës postmoderne, ka shprehur specifikatetnike dhe kulturore të proveniencës së tij", thotë Pollozhani. Ndonëse në vështrim të parë pikturat e Mexhiti dukën si të pakontrolluara, sfondi i tyre është i mbushur me simbole dhe metafora të harmonisë dhe disharmonisë. Kështu u shpreh një

historiana e artit Jëllez Hasani, në fjalën e hapjes së ekspozitës.

"Në një pjesë të madhe ngjyrat janë të konceptuara brenda një rrethi të imagjinuar, që e tregon në një mënyrë rrotullimin e qenësisë, ardhjen dhe vajtjen e të qenurit dhe ontologjinë ekzistenciale", tha ndër të tjera Asani. Kjo ekspozitë ka befasuar këndshëm edhe miqtë e tij. Dekani i Fakultetit të Arteve në Universitetin e Tetovës, Miftar Memeti, duke e vlerësuar Mexhitin jo vetëm si një piktor të shkëlqyer, skulptor, vizatues dhe grafist i spikatur, por edhe për aftësinë e tij për t'u transformuar nga një realist i përpiktë në një modernist ekspresionist. Bashkim Mexhiti, profesor në Universitetin e Tetovës, është një prej krijuesve më aktivë, numëron dhjetëra ekspozita, prezantime kolektive brenda dhe jashtë vendit. Po ashtu ka spikatur edhe në gjininë e skulpturës, si bashkautor në disa vepra monumentale.

Në Teatrin e Qytetit të Kumanovës kanë filluar provat për shfaqjen "Plaçkitësit" sipas Joe Orton e me regjisor Ben Apolloni, shkruan KultPlus.

"PLAÇKITËSIT" NË KUMANOVË

vdekurës do të duhej të ishin duke mbajtur zi, por ata në atë ditë i bëjnë tana të zezat, duke mos pasur pikë respekti për të vdekurën.

Kjo komedi e mbushur përplotë situata e batuta komike, në fakt është shumë e hidhur dhe fshikulluese për njeriun e kohës tonë i cili ka humbur të gjitha vlerat njerëzore. Vlera për të cilat gjithmonë është folur, por duket se kurrë nuk kanë ekzistuar.

Personazhet e kësaj shfaqje do të vijjnë në skenë nën interpretimin e aktorëve rezidentë të Teatrit të Kumanovës: Sefedin Shabani, Shkëlqim Islami, Ismail Kasumi, Qazmedin Nuredini, Mirsad Abazi, dhe aktore mysafire nga Shkupi, Rabije Alilovska ndërsa asistent regjie është Ibër Deari. Kjo vepër e Joe Orton është konsideruar shumë provokuese dhe ka shaktuar shumë debatë në kohën kur



është shfaqë për herë të parë (1965). Dhe edhe në trajtimin regjisorial kjo shfaqje do të jetë pro-

voquese, por jo vetëm më përmbajtjen por edhe si realizim skenar./KultPlus.com

"Plaçkitësit" është një komedi e zezë me plot kuptimin e fjalës, sepse ndodhë në një ditë funerali, në një ditë kur familjarët e të

QATIP OSMANI TREGON PËRSHTYPJET E TIJ PAS PËRFUNDIMIT TË SEZONIT VJESHTOR



TË VAZHDOJMË TË PUNOJMË ME PËRKUSHTIM MAKSIMAL

“Sigurisht që jam i kënaqur dhe duhet të jem i kënaqur me rrjedhën e sezonit vjeshtor. Jemi në vend të parë me rekord pikësh, rekord golash dhe gjithë parametrat tjerë që na bëjnë skuadra dominuese e këtij gjysmësezonit. Normal kemi pasur edhe rënie, por janë gjëra normale në futboll dhe me rëndësi është se kemi ditur të menaxhojmë këto situata për tu ringritur në nivelin e duhur që na solli të jemi këtu ku gjendemi tani”, pohon Osmani

Koha

Bujar KURTAJ

Shkup, 5 dhjetor - Skuadra e Shkëndijës po e luan bindshëm gjysmësezonin e saj më të mirë në historinë e klubit. Me vetëm dy disfata, kuqezinjët fituan titullin e kampionit vjeshtor duke synuar titullin e dytë pas asaj në vitin 2010/2011. Të kënaqur për këtë sukses nuk janë vetëm futbollistët, kryesia, “Ballistët” dhe dashamirët e KF Shkëndija, por edhe trajneri Qatip Osmani. Osmani për gazetën KOHA, shprehet se gjatë këtij gjysmësezonit ka pasur edhe rënie, por sipas tij ato janë normale. “Sigurisht që jam i kënaqur dhe duhet të jem i kënaqur me rrjedhën e sezonit vjeshtor. Jemi në vend të parë me rekord pikësh, rekord golash dhe gjithë parametrat tjerë që na bëjnë skuadra dominuese e këtij gjysmësezonit. Normal kemi pasur edhe rënie, por janë gjëra normale në futboll dhe me rëndësi është se kemi ditur të menaxhojmë këto situata për tu ringritur në nivelin e duhur që na solli të jemi këtu ku gjendemi tani”, shprehet Osmani. Përkundër 14 pikëve më shumë nga konkurenti i saj më serioz për titull, por që ata kanë dy ndeshje

më pak, “Qato” se kjo epërsi nuk është e mjaftueshme nëse ai dhe lojtarët nuk janë të aftë të vazhdojnë me ritmin e njëjtë. “Asnjëherë nuk është e mjaftueshme nëse nuk je i aftë për të vazhduar me ritmin e njëjtë ashtu si ke arritur të krijosh atë epërsi. Ne kemi tentuar mos shikojmë çka bëjnë tjerët, por vetëm të bëjmë detyrën tonë. Normal kur rivali gabon, distanca rritet dhe presioni kalon të kundërshtari. Por ne nuk preokupohemi me këto gjëra, e dimë çka duam dhe jemi të bindur për të vazhduar të punojmë me përkushtim maksimal për të realizuar objektivat tona”, shtoi më tej trajneri Osmani. Në pyetjen se a planifikon që në afatin kalimtar të janarit ekipi të freskohet me ndonjë lojtar të ri, ose eventualisht të lirojë nga angazhimi ndonjë lojtar që nuk llogarit për sezonin pranveror, Osmani tha se KF Shkëndija gjithmonë ka qenë tërheqëse për mediat dhe opinionin kur vjen koha e afatit kalimtar për transferim të futbollistëve, por sipas tij deri më tani asgjë nuk zyrtare. “Shkëndija gjithmonë është tërheqëse për mediat dhe opinionin kur vjen koha e afatit kalimtar



Qatip Osmani

Shkëndija gjithmonë është tërheqëse për mediat dhe opinionin kur vjen koha e afatit kalimtar për transferim të futbollistëve dhe ne çdo ditë lexojmë dhe dëgjojmë gjithçka. Por, në këtë moment nuk ka asgjë zyrtare. Këto ditë kemi një kamp stërvitor ku testohen disa futbollistë, në të njëjtën kohë përgatisim analizë të gjysmësezonit të sapo-përfunduar dhe në konsultim me stafin teknik dhe kryesinë do të vendosim për ndryshimet eventuale, qoftë largime apo afrime të futbollistëve

për transferim të futbollistëve dhe ne çdo ditë lexojmë dhe dëgjojmë gjithçka. Por, në këtë moment nuk ka asgjë zyrtare. Këto ditë kemi një kamp stërvitor ku testohen disa futbollistë, në të njëjtën kohë përgatisim analizë të gjysmësezonit të sapo-përfunduar dhe në konsultim me stafin teknik dhe kryesinë do të vendosim për ndryshimet eventuale, qoftë largime apo afrime të futbollistëve. Normal këto lidhen me njëra tjetrën dhe varësisht ku mund të ketë ndonjë largim, do të hapet nevoja për afrim të ri, që për ne do të jetë me rëndësi të bëhet fjalë për kualitet shtesë që do të rrisë nivelin e skuadrës”, tha Osmani. Në fund, trajneri Osmani zbuloi se deri kur do të jenë në pushim lojtarët si dhe foli për plan-programin rreth përgatitjeve dimërore. “Po ne kemi plan-programin tonë të hartuar prej më parë dhe dimë pjesën më të madhe të asaj që mendojmë të realizojmë. Lojtarët janë lënë të lirë deri më 3 janar të vitit të ardhshëm, por ky nuk do të jetë pushim klasik për ta, pasi me vete u është dhënë program punë që duhet ta respektojnë gjatë kësaj periudhe. Shkëndija vite me radhë ka krijuar një standard të punës dhe e njëjta do të vazhdojë edhe këtë vit. Do të ketë testim ditë e para të janarit, ndërsa pastaj varësisht prej kushteve atmosferike do të vendoset për fazën e parë përgatitore. Fazën e dytë dhe kryesore si vitet e kaluara edhe tani do ta realizojmë në Antalia të Turqisë”, përfundoi trajneri i KF Shkëndija, Qatip Osmani.

Januzaj gëzon Sosiedadin



Adnan Januzaj ka munguar në ndeshjet e fundit të Real Sosiedadit, për shkak të një lëndimi. Ylli i Real Sosiedadit, Adnan Januzaj ka stërvitur sot normalisht me pjesën tjetër të skuadrës dhe është gati për ndeshjen e së enjtes. Përfaqësuesi belg kishte munguar në ndeshjet e fundit, shkak i një lëndimi që kishte pësuar në ndeshjen ndaj Atletico Madrid. Januzaj kështu do të jetë gati për ndeshjen ndaj Zenitit, që zhvillohet këtë të enjte në kuadër të “Europa Leagues”.

Anulohet meçi i Haxhi Krasniqit



Boksieri i njohur kosovar, Haxhi Krasniqi, ka deklaruar se është anuluar meçi i tij i radhës i paraparë për 16 dhjetor. Krasniqi nuk ka treguar emrin e kundërshtarit por ka thënë se kjo mbrëmje e boksit është anuluar nga organizatorët. Krasniqi ka luftuar dy herë për titull kampioni të botës. Në 51 meçe të deritashme ai ka pasur 46 fitore, 17 me nokaut. “Miq të dashur, dueli im i radhës ishte i planifikuar për datën 16 Dhjetor dhe mezi po e prisja të ngjitesha në ring, por ajo mbrëmje e boksit u anulua nga organizatorët dhe tani po e pres një termin të ri për duelin nr. 52. Deri atëherë, mirëmbetshi”, ka shkruar ai në “Facebook”.

Në bazë të nenit 22 paragrafi 1 linja 2, paragrafi 3, paragrafi 8, paragrafi 13 dhe paragrafi 14 nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/14, 199/14 dhe 27/16) dhe nenit 22, neni 23, neni 24, neni 25 neni 26 dhe neni 27 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/05, 106/08, 161/08, 114/09, 130/09, 50/10, 52/10, 124/10, 47/11, 11/12, 39/12, 13/13, 25/13, 170/13, 187/13, 113/14, 20/15, 33/15, 72/15, 129/15 dhe 27/16), neni 16 paragrafi 1 linja 2 e Statutit të Agjencisë për planifikim të hapësirës – Shkup, ndërsa në pajtim me Rregulloren për sistematizim të vendeve të punës të Agjencisë për planifikim të hapësirës – Shkup, Agjencia për planifikim të hapësirës – Shkup publikon:

SHPALLJE PUBLIK

Për punësim të 1 (një) personi me kohë të caktuar të punës me orar të plotë të punës si zëvendësimit të punëtorit që mungon

- Vendi i punës me shifrë APP/01/02/V04/003 , niveli V04, titulli i vendit të punës: Bashkëpunëtor i ri kontabilist – 1 (një) realizues
- Përshkrimi i detyrave të punës: udhëheqje punën e tërësishme financiare – kontabiliteti të Agjencisë; përpilim ose merr pjesë në përpilimin e llogarisë përfundimtare të Agjencisë; mban llogari për likuiditetin dhe pronësinë e Agjencisë; kujdeset për pagesën e faturave; bën kontabilitetin e tërë dokumentacionit financiar; bën përllogaritjen e rrogave; mban evidencë të qarkullimit të paguar; kujdeset për arrijen e obligimeve dhe kërkesave; realizon edhe punë të tjera me urdhrë të Drejtorit të Agjencisë.

Kandidati duhet të plotësojë kushtet e përgjithshme në vijim:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë;
- në mënyrë aktive ta shfrytëzojë gjuhën maqedone;
- të jetë i moshës së rritur;
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës;
- me vendim të plotfuqishëm të mos ketë ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrë.

Përveç me Ligji kushtet e përgjithshme të përcaktuara kandidatit duhet të plotësojë edhe kushtet e posaçme në vijim:

- niveli i kualifikimeve VI B sipas komizës maqedonase të kualifikimeve dhe të fituara së paku 180 kredi sipas SETK apo shkallë të mbaruara VIII/1 – Fakulteti ekonomik;
- njohuri aktive të programeve kompjuterike për punë në zyrë;
- njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane) përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtare të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtare e Shoqatës ALTE të testatorëve evropian të A2 nivelit të CEFR, gjegjësisht KET, IELST me maksimum 3 pikë, BULATS; ose Aptis; ose TOEFEL PBT së paku 400 pikë, TOEFEL CBT së paku 95 pikë ose TOEFEL IBT së paku 30 pikë ose DELF, TCF, TEF; ose Gete Certifikatë;
- me ose pa përvojë pune.

Kompetencat e përgjithshme të punës:

- Zgjidhje të problemeve dhe vendim për punë nga fusha e vet e veprimt;
- Mësim dhe zhvillim;
- Komunikim;
- Realizim i rezultateve;
- Punë me punë të tjera/lepkore;
- Vetëdije strategjike;
- Orientim ndaj klientëve/palëve të përfshira;
- Menaxhim financiar.

Orari i punës është 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte, me fillim mes orëve 07:30 dhe 08:30 dhe përfundim të orarit të punës mes 15:30 deri në ora 16:30, me kohëzgjatje të përgjithshme të ditës së punës prej tetë orë. Pauza gjatë orarit ditor të punës është me kohëzgjatje prej 30 minutave në periudhën prej ora 12:00 deri në ora 12:30.

Neto pagesa për vendin e punës Bashkëpunëtor i ri kontabilist është: 27.000 denarë.

Kandidatët të cilët paraqiten për vendin e punës Bashkëpunëtor i ri kontabilist duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim:

- diplomë për arsim të lartë të mbaruar – VI B sipas komizës maqedonase të kualifikimeve dhe të fituara së paku 180 kredi sipas SETK apo shkallë të mbaruara VIII/1 – Fakulteti ekonomik;
- biografi të shkurtë (CV) me kontakt informacione;
- dëshmi për njohje aktive të një prej tre gjuhëve më shpesh të përdorura në Bashkimin Evropian (angleze, frënge, gjermane) përmes posedimit të certifikatës së njohur ndërkombëtare të dhënë nga testatori zyrtar evropian, anëtare e Shoqatës ALTE të testatorëve evropian të A2 nivelit të CEFR, gjegjësisht KET, IELST me maksimum 3 pikë, BULATS; ose Aptis; ose TOEFEL PBT së paku 400 pikë, TOEFEL CBT së paku 95 pikë ose TOEFEL IBT së paku 30 pikë ose DELF, TCF, TEF; ose Gete Certifikatë.
- certifikatë për punë me programe kompjuterike për punë në zyrë;
- certifikatë për shtetësi të Republikës së Maqedonisë;
- Certifikatë se nuk i është shqiptuar me vendim të plotfuqishëm ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Certifikatë nga mjeku jo më të vjetër se gjashtë muaj;
- Dëshmi për përvojë pune në profesion (nëse ka përvojë pune në profesion)

Afati për paraqitje me dokumentet e nevojshme është 5 (pesë) ditë pune duke llogaritur nga dita e publikimit të shpalljes publike në shtypin ditor.

Dokumentet jo në kohë dhe të pa kompletuara nuk do të shqyrtohen. Kandidatët të cilët i plotësojnë kushtet do të thirren në testim në Agjencionin për planifikim hapësor – Shkup për nevojat e të cilët publikohet shpallja.

Kontrolli i aftësive profesionale të kandidatëve të paraqitur të shpalljes publike të publikuar do të realizohet me testim dhe intervistë të cilën do ta zbatojë Komisioni kompetent për zbatimin e procedurës për punësimin e personave me kohë të caktuar të punës.

Pyejet për testimin me shkrim pjesën profesionale do të shfrytëzohen nga sfera e kontabilitetit. Pas përfundimit të testimit do të zbatohet intervistë në të cilën do të parashtrohen pyetje nga fusha e kompetencave të përgjithshme të punës.

Zgjedhja do të realizohet në afatin e përcaktuar në nenin 23 paragrafi 2 nga Ligji për marrëdhënie pune pas përfundimit të afatit për paraqitje në varshmëri prej numrit të paraqitjeve të arritura.

Kandidatët të cilët aplikojnë në shpallje duhet që dokumentet të dorëzojnë në zarf të mbyllur me shenjë "Për shpallje për punësim", në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter dhe të dorëzojnë përmes postës ose si dorëzojnë në arketuvë.

Agjencia për planifikim të hapësirës – Shkup
adresa: "Sheshi Maqedonia", nr.2 Shkup,
Personi për kontakt: Ivana Gorgova, tel. 3 227 244, lok. 122

Agjencia për planifikim hapësor - Shkup

Në bazë të nenit 20, paragrafi 2 i Rregullores për licenca për kryerje të veprimtarisë energjetike (Gazeta Zyrtare e RM nr. 143/11, 78/13, 33/15 dhe 207/16), Çimentorja Usje SHA Shkup me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 94 Shkup në vijim publikon

LAJMËRIM

Informohet opinioni se Çimentorja Usje SHA Shkup me seli në rr. Boris Trajkovski nr. 94 Shkup, me NVPS 4053397 më datë 17.11.2017 ka parashtruar Kërkesë për dhënie të licencës për kryerje të veprimtarisë energjetike – tregti me energji elektrike deri te Komisioni rregullator për energjetikë të Republikës së Maqedonisë të shënuar nën numrin UP 1 nr. 12-187/17 të datës 17.11.2017.

EMRI I KËRKUESIT: Çimentorja Usje SHA Shkup

LLOJI I VEPRIMTARISË ENERJETIKE: Tregti me energji elektrike

RAJONI KU DO TË KRYHET VEPRIMTARIA: Republikën e Maqedonisë dhe jashtë vendit

PËRSHKRIMI I MËNYRËS, OBJEKTEVE DHE MJETEVE PËR KRYERJE TË VEPRIMTARISË

Tregtia me energji elektrike do të realizohet në pajtim me nenin 81 të Ligjit për energjetikë (Gazeta zyrtare nr. 16/11, 136/11, 79/13, 164/13,41/14, 151/14, 33/15, 192/15, 215/15, 06/16, 53/16, 189/16).

Shoqëria do të kryejë veprimtarinë përmes sistemit përçues dhe distribues të energjisë elektrike të Republikës së Maqedonisë me të cilin menaxhon operatori i sistemit elektropërçues dhe operatori i sistemit elektrodistribues, në objektet dhe me mjetet e Shoqërisë me të cilat do të kryhet veprimtaria. Veprimtaria do të kryhet në pajtim em ligjin, dispozitat dhe marrëveshjet tjera ndërkombëtare.

KOHËZGJATJA E LICENCËS: 10 (dhjetë) vjet

AFATI PËR PARASHTRIMIN E PROPOZIMEVE, MENDIMEVE DHE SUGJERIMEVE NË LIDHJE ME KËRKESËN PËR DHËNIE TË LICENCËS

Subjektet e interesuara juridike dhe fizike mund që me shkrim të parashtrorjnë deri te Komisioni rregullator për energjetikë i Republikës së Maqedonisë mendimet dhe propozimet në lidhje me Kërkesën e parashtruar për dhënie të licencës për tregti me energji elektrike në afat prej 5 ditëve nga dita e publikimit të Lajmërimit për kërkesën në shtypin ditor.

ADRESA E KOMISIONIT RREGULLATOR PËR ENERJETIKË TË REPUBLIKËS SË MAQEDONISË

Rr. Makedonija pn, Pallati L Lazar Pop Trajkov, kati 6, 1000 Shkup, Republika e Maqedonisë.

ÇIMENTORJA USJE SHA SHKUP

Në bazë të nenit 131 dhe 135 të Ligjit për arsim sipëror, dhe nenit 34 dhe 35 të Rregullores për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, mësimit, shkencor, mësimit-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" – Manastir, Fakulteti i teknologjive informatike dhe të komunikimit – Manastir publikon:

KONKURS

Për zgjedhje

Shpallet konkurs për zgjedhje të:

- Një mësimdhënë në të gjitha titujt mësimit-shkencor nga sferat shkencore: 21202 - Sistemet dhe rrjetet e informacionit; 21203 – Bazat e të dhënave; 21208 – Të tjera (Sistemet mobile të distribuimit),
- Një mësimdhënë në të gjitha titujt mësimit-shkencor nga sferat shkencore: 11000 –Informatikë; 11002 - Sistemet e informacionit dhe programimi; 11011 – Të tjera;
- Një mësimdhënë në të gjitha titujt mësimit-shkencor nga sferat shkencore: 50302 – Ekonomia aplikative; 50329 - Të tjera (Ekonomia sipërmarrëse; Biznes);
- Një mësimdhënë në të gjitha titujt mësimit-shkencor nga sferat shkencore: 21202- Sistemet dhe rrjetet e informacionit; 21208 - Sistemet multimediale dhe rrjetet për dërgim të përmbajtjeve; 20800 – Përgatitje për shtyp dhe DTP (Desktop Publishing);
- Një mësimdhënë në të gjitha titujt mësimit-shkencor nga sferat shkencore: 11006 – Metodatat dhe aplikacionet e integruara përlogaritëse; 21403 - Makineria e prodhimit, teknologjitë, sistemet; 21208 – Të tjera (Prodhimtaria e integruar kompjuterike);

Kandidatët, krahas kushteve të përgjithshme të parapara me Ligjin për marrëdhënie pune, duhet të plotësojnë edhe kushtet e posaçme të parapara me Ligjin për arsim sipëror dhe Rregulloren për kriteret dhe procedurën për zgjedhje në titujt mësimit-shkencor, mësimit, shkencor, mësimit-profesional dhe bashkëpunues të Universitetit "Shën Kliment Ohridski" – Manastir.

Së bashku me fletëparaqitjen për konkurs, kandidatët, në original ose kopje të vërtetuara në noter, duhet të dorëzojnë dokumentet në vijim: biografi/CV, diplomë për shkallën e arritur shkencore doktor i shkencave nga sfera për të cilën zgjidhet, listë të punimeve shkencore dhe profesionale dhe nga një kopje prej tyre, certifikatë të lindjes, certifikatë të shtetësisë, dhe raport për notë pozitive nga vetëevaluimi.

Fillimi, përfundimit dhe orari i punës dhe shuma në të holla e pagesës bazë për mësimdhënësit janë të ndryshueshme dhe përcaktohen në pajtim me aktet e Fakultetit sipas orarit të mësimiit në semestër, angazhimit dhe titullin në të cilin është i zgjedhur mësimdhënësi (në neto shumë: 29.241 den./ 31.481 den./ 34.677 den.).

Konkursi zgjatë 8 ditë nga dita e publikimit, ndërsa fletëparaqitjet së bashku me dokumentet shtesë dorëzohen në Fakultetin e teknologjive informatike dhe komunikimit – Manastir personalisht, ose përmes postës në adresën: "Partizanska" pn 7000, Manastir.

Fletëparaqitjet e pakompletuara dhe të dorëzuara pas afatit nuk do të merren parasysh.

Fakulteti i teknologjive informatike dhe komunikimit – Manastir

REPUBLIKA E MAQEDONISË
UNIVERSITETI "SHËN.KIRILI DHE
METODI" - SHKUP
FAKULTETI PËR MJEKËSI
VETERINARE SHKUP



REPUBLIC OF MACEDONIA
UNIVERSITY "St. CYRIL AND METHODIUS" SKOPJE
FACULTY OF VETERINARY MEDICINE
SKOPJE

Në bazë të dispozitave nga Ligji për të punësuarit në sektorin publik (Gazeta Zyrtare e RM nr. 27/2014, 199/2014 dhe 27/2016) dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune (Gazeta Zyrtare e RM nr. 62/2005, 106/2008, 161/2008, 114/2009, 130/2009, 149/2009, 50/2010, 52/2010, 124/2010, 47/2017, 11/2012, 39/2012, 13/2013, 25/2013, 170/2013, 187/2013, 113/2014, 20/2015, 33/2015, 72/2015, 129/2015 dhe 27/2016), Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup – Fakulteti për mjekësi veterinare në Shkup publikon

SHPALLJE Për punësim nr. 1

Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup – Fakulteti për mjekësi veterinare në Shkup ka nevojë për punësim të dy personave për kohë të pacaktuar në vendet e punës në vijim:

- Doktor të mjekësisë veterinare, shifra OBN 03 02 G 01 001, realizues: 1 (një)
- Bashkëpunëtor profesional – analist, shifra OBN 03 02 G 01 001, realizues: 1 (një)

Kandidatët krahas kushteve të përgjithshme në pajtim me ligjin, duhet të përmbushin edhe kushtet e posaçme në vijim:

- Doktori i mjekësisë veterinare – niveli i kualifikimeve VII sipas Komizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 300 kredi sipas SETK, fusha shkencore: mjekësia veterinare, me dhe pa përvojë pune.
- Bashkëpunëtor profesional – analist – niveli i kualifikimeve VI A sipas Komizës së Maqedonisë të kualifikimeve dhe të arritura së paku 240 kredi sipas SETK ose shkallë të VII/1. Fusha shkencore: shkencat matematiko-natyrore ose shkencat teknike-teknologjike, me dhe pa përvojë pune.

Mënyra e realizimit të përgjithshme të kandidatëve do të bëhet me kontrollim të fletëparaqitjes dhe dëshmime dhe intervistë me kandidatët e paraqitur të cilët i përmbushin kushtet.

Për të dy realizuesit orari i punës është 40 orë në javë, prej ditës së hënë deri ditën e premte, me fillim prej ora 8 deri në ora 16. Neto pagesa bazë për secilin realizues veç e veç është 30.180,00 denarë.

Dokumentacioni i nevojshëm: fletëparaqitje me theksim të vendit të punës për të cilin parashtrohen dokumentet që përmban së paku të dhënat në vijim: emër dhe mbiemër, datën dhe vendin e lindjes, adresën dhe vendin e banimit, adresën e postës elektronike, telefonin, biografinë, diplomë/certifikatë për shkallën e mbaruar të arsimit, dëshmi për shtetësi, dëshmi për aftësinë e përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, dëshmi se me vendim të plotfuqishëm gjyqësor nuk i është shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës. Dokumentet parashtrohen në origjinal ose kopje të vërtetuara në noter.

Afati për paraqitje është 5 ditë pune nga dita e publikimit të shpalljes. Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat prej 5 ditëve pas kalimit të afatit për paraqitje.

Fletëparaqitja me dokumentacionin parashtrohet në arkivin e Fakultetit ose përmes postës në adresën: Universiteti "Shën Kirili dhe Metodi" në Shkup – Fakulteti për mjekësi veterinare, rr. "Lazar Pop Trajkov" nr. 5-7, 1000 Shkup, tel. 02/ 32 40 700. Dokumentet e pakompletuara dhe dokumentet e parashtruar pas afatit nuk do të merren parasysh gjatë shqyrtimit. Fakulteti për mjekësi veterinare – Shkup



Republika e Maqedonisë
Komuna e Sopishtes

Tel. ++389 2 27 85 100
Faks. ++389 2 27 85 109
Rr. 2, nr. 2, f. Sopishte, 1054
Shkup, Republika e Maqedonisë
www.opstinasopiste.gov.mk
gradonacalnik@opstinasopiste.gov.mk

Numri i procedurës: 13161
nr. 28-57/17 e datës 29.11.2017

LAJMËRIM

Për organizim të Anketës publike dhe prezantimit publik në lidhje me **Projektin urbanistik arkitektonik për formim të parcelave ndërtimore (PK 1214/1 KK Sopishte dhe të pjesës nga PK 1206/4 KK Sopishte jvn), K. Sopishte, sipas certifikatës nga SPU.** Realizohet prezantim publik dhe anketë publike për **Projektin urbanistik arkitektonik për formim të parcelave ndërtimore (PK 1214/1 KK Sopishte dhe të pjesës nga PK 1206/4 KK Sopishte jvn), K. Sopishte, sipas certifikatës nga SPU.** Përfshirja planore e dokumentit **Projekti urbanistik arkitektonik për formim të parcelave ndërtimore (PK 1214/1 KK Sopishte dhe të pjesës nga PK 1206/4 KK Sopishte jvn), K. Sopishte, sipas certifikatës nga SPU** është me sipërfaqe prej **1651,43 m2.**

- Prezantimi publik dhe anketa publike do të realizohet me prezantimin e planit në lokalet e Komunës Sopishte më datë **12.12.2017** në ora **11.00.**
- Anketa publike do të zgjasë deri më **18.12.2017**, në bazë të nenit 51 paragrafi 10 të Ligjit për planifikim hapësor dhe urbanistik (Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 199/14, 44/15, 193/15 dhe 31/16).
- Informohen të gjithë qytetarët dhe subjektet e interesuara juridike nga rajoni përkatës të përfshirë në plan në afatin e lartpërmendur të parashtrorjnë vërejtje, propozime dhe mendime në listat anketuese në administratën komunale.
- Informacione në tel. 2 785 102

Kryetari i Komunës së Sopishtes
Stefçe Trpkovski

Është humbur dëftesa e klasës së 8-të e personit Nazmi Selami të SHF "Jane Sandanski"-Shkup dhe njëkohësisht shpallet e pavlefshme.

Edhe braziliani mori etiketën "Il Gordo" te Real Madridi. Megjithatë përgjigja në fushë ishte mbresëlënëse, 17 trofe ekipor të fituar, 2 trofe të "Topit të Artë" dhe sukcesi në Kupën e Botës 2002, ku mori prej dore Brazilin. Pavarësisht se fiziku asnjëherë nuk e ka ndihmuar, Ronaldo ka shkruar emrin e tij me germa të arta në historinë e futbollit

NGA RONALDO TE KASANO

KUR TALENTI ËSHTË "I BOLLSHËM"!

Kampionë në fushën e lojës dhe në tavolinën e bukës! Talent i pamasë si futbollist, por edhe shumë oreks kur vjen puna për të ngrënë. Dëmtime të shpeshta dhe të rënda, hormone me tepri dhe një jetë e shthurur jashtë fushe, pavarësisht se shumë nga ata kanë qenë idhujt e miliona tifozëve dhe janë "ikona" të historisë së këtij sporti si Maradona, Ronaldo, Ronaldinho, etj.



Angelo Peruzzi

Ka pasur nga ata që gjatë karrierës së tij e kanë thërritur edhe "derrkuc", si pasojë e fizikut. Por në fushën e lojës, më shumë se një derr, Peruzzi ngjasonte me një macë. Reflektet dhe ekzekutimi i lëvizjeve ishte aq i shpejtë sa i dha mundësinë të fitonte gjithçka në karrierë përfshi "Champions League" dhe Kupën e Botës (si zëvendësuesi i Buffon).



Sodinja

U tërhoq nga futbollit pak ditë më parë në moshën 27-vjeçare. Felipe Monteiro Diogo, i quajtur Sodinja, kur e kishte topin në këmbë mund të bënte çfarë të donte. Pavarësisht se pesha e tij shkoi në 90 kilogram dhe paraqitjet ishin me ulje-ngritje, tifozët e Breshës e adhuronin për atë që bënte në pesë apo dhjetë minutat që aktivizohej.



Antonio Cassano

Një jetë e kaluar gjithmonë në fije të perit, brenda dhe jashtë fushe. Në fushën e lojës, duke krijuar futboll, duke ndryshuar hierarkitë dhe kufijtë. Të njëjtët kufij, të njohur jashtë fushe së lojës, ku ka pasur shumë tejkalime. Tejkalime peshe si në rastin kur luante me Real Madridin dhe disa vite më parë te Sampdoria, gjatë muajve të verës. Në Spanjë, gjatë një përvoje ku nuk ka asgjë për t'u krenuar, nisën ta quanin "El Gordito". Shumë kile dhe pak minuta për talentin nga Bari që më pas u rikthyer në Itali ku luajti me Sampdorian, Milanin, Interin, Parman dhe tani sërish Sampdorian. Sërish mbi peshë, por me një talent të pamasë në fushën e lojës. Rrufe në qiell të hapur, si goli që shënoi ndaj Juventusit, në javën e fundit të kampionatit italian.



Ronaldo

"Jam i mërzhitur me njerëzit që më thonë "bullafiq"! Në këtë mënyrë foli, Ronaldo "Fenomeni", kur u kthye në Brazil, në vitin 2004. Dëmtime, serioze dhe të përsëritura, të bashkuara me disa probleme hormonesh të tepruara kanë qenë problem për Ronaldon që kur fitonte "Topin e Artë" dhe luante me Interin. Edhe braziliani mori etiketën "Il Gordo" te Real Madridi. Megjithatë përgjigja në fushë ishte mbresëlënëse, 17 trofe ekipor të fituar, 2 trofe të "Topit të Artë" dhe sukcesi në Kupën e Botës 2002, ku mori prej dore Brazilin. Pavarësisht se fiziku asnjëherë nuk e ka ndihmuar, Ronaldo ka shkruar emrin e tij me germa të arta në historinë e futbollit.



Adebajo Akinfenva

100 kilogram, mos më shumë. Profesionist! Futbollist! Kjo është historia e Adebajo Akinfenva, qendërsulmuesi i Vimbeldon, skuadër të merr pjesë në "League Two" (kategoria e katërt në Angli). Fanella gjithmonë është XXL, por kur zbret në fushë, nigeriani di si të tregojë veten. 138 gola në karrierë, gjithmonë më shumë se dhjetë gola në sezon në shtatë vitet e fundit si profesionist. Nuk fal para portës, por mesa duket edhe para tavolinës. Sidoqoftë ai vazhdon të shënojë, duke treguar se ndonjëherë peshorja gabon!



Adriano (Roma)

Dukej gati për të nisur fluturimin duke u bërë një nga më të mëdhenjtë e futbollit botëror, por më pas erdhi rënia e lirë, gjithmonë si pasojë e jetës jashtë fushe, që zhduku përfundimisht magjitë e viteve të para të karrierës. Te Interi i kishte lënë të gjithë me gojën hapur, derisa fitoi rënia e pashmangshme. Përvoja me Flamengon dhe rikthimi në Itali me Roman treguan se "Perandori" i vërtetë nuk ekzistonte më. Mbi peshë dhe jashtë forme, larg që në mendime nga fusha e lojës. Parabola e rënies nuk u ndal kurrë për Adrianon, derisa erdhi tërheqja nga futbollit. Por edhe në vitet e fundit që luajti futboll nuk arriti kurrë nivelet e së kaluarës.



Diego Armando Maradona

Ai që konsiderohet si futbollisti më i madh i të gjitha kohërave, Diego Armando Maradona, nuk ka nevojë për t'u prezantuar. Jehona e arritjeve të tij do të bëj bujë edhe për shumë vite, pavarësisht se jeta e tij larg fushe së lojës ka qenë e kundërta e sportistit. Mbi peshë u bë problem jetik për Maradonën, në momentin që u tërhoq nga futbollit, por faktikisht disa kile më shumë i kishte edhe kur luajti me Argjentinën në Kupën e Botës 1994 në SHBA. Edhe të mendosh se përpara veprimtarisë ndoqi një program special dobësimi për 10 muaj.



Ronaldinho

Vitet e para të karrierës në Evropë treguan një Ronaldinho model të profesionizmit me Paris SZH dhe Barcelona, pastaj peri i këput! Ronaldinho Gauço për shumë vite magjistari i botës së futbollit me driblime, finte dhe gola u shndërrua në një lojtarë mbi peshë që nuk pati mundësinë ta mbyllte karrierën në nivelet që paraqiti për 10 vjet. Te Milani dukej i paqartë në atë që bënte, pikërisht si mungesë e formës sportive. Megjithatë, për të kënaqur tifozët kudo nëpër botë mjafton që Ronaldinho të ketë topin në këmbë për të pritur çdo magji.



Luis Muriel

Kur luante me Leçe (sezoni 2011/2012) dukej se do të arrinte majën e futbollit botëror. Sot, në moshën 24-vjeçari nuk është kuptuar ende nëse Muriel është një futbollist i zakonshëm apo talent i madh, teksa por luan me Sampdorian. Aftësitë teknike nuk vihen në diskutim, por mënyra si ushqehet nuk është e mirë. Te Udineze u paraqit në grumbullimin e vitit 2012 mbi peshë, aq sa e detyroi trajnerin Guidolin ta pezullonte derisa të humbte pesë kile. "Nëse dëshiron të punën me të, duhet të punojë shumë për të bërë atlet." Kanë kaluar katër vjet, por duket se gjitha nuk kanë ndryshua për Luis Muriel.

LIGA E KAMPIONËVE, GRUPI E, F, G DHE H

SHTATË SKUADRA KËRKOJNË KUALIFIKIMIN

Luhën këtë mbrëmje, në orën 20.45 ndeshjet e raundit të fundit në katër grupet tjera të Ligës së kampionëve, E, F, G dhe H, ku do të përcaktohen skuadrat që do të vazhdojnë në fazën tjetër. Ende pa u luajtur sfidat e fundit e kanë siguruar kualifikimin plot katër skuadra, Siti në Grupin F, Beshiktashi në Grupin G, dhe Reali e Totenemi në Grupin H



Në Grupin E Liverpooli dhe Spartaku i Moskës në "Anfield" do të luajnë njëra kundër tjetër për një vend në raundin tjetër. Skuadra angleze kryeson grupin me nëntë pikë, një më shumë se Sevlija dhe tre më shumë se kundërshtari i sotëm. Ndërkaq edhe me një pikë djemtë e trajnerit Jurgen Klop do të shkojnë tutje, derisa ata mund të përfundojnë të parët në Grup në rast se Sevlija nuk do të fitojë ndaj Mariborit. Derisa, skuadra spanjolle me fitore ndaj Mariborit ose me një barazim nëse Spartaku nuk fiton do të vazhdon tutje. Por, nëse Spartaku mund Liverpulit dhe Se-

vilja në përballjen tjetër mund Mariborin, atëherë rusët dhe spanjollët do të vazhdojnë tutje kurse Liverpooli do të bie në pozitën e tretë dhe do të luajë në Liga Evropë. Mançester Siti e cila ka pesë fitore në po aq ndeshje, ka siguruar plasmanin në raundin tjetër, kurse për pozitën e dytë do të "luftojnë" Shakhtari Donjeck dhe Napoli. Shakhtari ka një epërsi të qartë në garën për vendin e dytë, por ndaj Mançester Sitit në stadiumin "OSK

Metalist Stadion – Kharkiv" kanë nevojë për një barazim. Ata mund të vazhdojnë tutje edhe nëse Napoli nuk fiton në fushën e Fejenordit, e cila nuk ka asnjë pikë dhe është në kërkim të fitores së parë apo pikës së parë në Çampion. Skuadra italiane duhet të fitojë Fejenordin dhe të shpresojë që Shakhtari të humb nga Siti dhe të plasohet në pozitën e dytë e cila qon në raundin tjetër. Plasmanin në raundin tjetër do ta kërkojë

edhe Porto. Ata në stadiumin "Estadio do Dragao", do të presin Monakon, e cila nuk ka gjasa teorike për plasman të mëtuftëshëm dhe edicionin e sivjet në Ligën e kampionëve do ta përfundojnë në pozitën e fundit. Andaj Porto, e cila me shtatë pikë, aq sa ka edhe Lapi-zigu, do të kërkojë fitore me çdo kusht për të qëndruar në pozitën e dytë. Në të kundërtën Laipzigu, e cila sonte pret liderin e pakontestueshëm Beshiktash, me fitore

- GRUPI E**
LIVERPUL - SPARTAK M.
MARIBOR - SEVLJA
- GRUPI F**
FEJENORD – NAPOLI
SHAKHTAR D. - MANÇESTER S.
- GRUPI G**
PORTO – MONAKO
LAIPZIG - BSHIKTASH
- GRUPI H**
REAL M. - BORUSIA D.
TOTENHEM - APOEL

apo një barazim në rast se Porto humb nga Monako, do të vazhdojë garat në raundin tjetër.

Ndërkohë në Grupin H është gjithçka e qartë sa u përket dy pozitave të parë dhe asaj se kush do të vazhdojë tutje. Është skuadra e Totenemit dhe fituesi aktual i trofeut të Ligës së kampionëve, Reali i Madridit, kurse pritet të mësohet se cila skuadër do të plasohet në pozitën e tretë e cila qon në Liga Evropë, Borussia Dortmundi apo APOEL Nikozia. Të dyja skuadrat kanë nga dy pikë. Dortmundi poitën e tretë do ta kërkojë ndaj Realit të Madridit në "Santiago Bernabeu" kurse APOEL-i ndaj Totenemit në "Wembley".

Publicitet

SHPALLJE PUBLIKE I nr. 1787/2017
(në bazë të nenit 48 paragrafi 2 i Ligjit për përbarim (Gazeta Zyrtare nr. 72 të datës 12.04.2016)

Përbaruesi **Aleksandar Kuzmanovski** nga Gostivari në bazë të kërkesës për realizim të përbarimit nga kreditori **TTK Banka SHA – Shkup** nga Shkupi me seli në rr. Nardod Front nr. 19A Shkup, bazuar në dokumentin përbarues ODU nr. 802/16 të datës 21.06.2016 të Nolerit Zulfuqar Sejfullai – Gostivar, kundër borxhitliu **Shoqëria për tregti, hoteleri, transport dhe shërbime RIGON KOM SHPKNJ** eksport-import f. Çegan Gostivar dhe debitorit të pengut Ilmi Ejupi nga Gostivari me seli në f. Çegan rr. 300 pn, për realizim të përbarimit me vlerë prej 5.387.792,00 den, më datë 05.12.2017:

FTON

1. Borxhliu Shoqëria për tregti, hoteleri, transport dhe shërbime RIGON KOM SHPKNJ eksport-import f. Çegan Gostivar për shkak të dorëzimit të:
- Urdhresës për përbarim ndaj patundshmërisë në bazë të nenit 166 të LP I nr. 1787/2017 të datës 27.10.2017.
- Konkuzion për përcaktim të vlerësimit i cili do të realizojë vlerësim të patundshmërisë në bazë të nenit 176 paragrafi 1 të LP I nr. 1787/2017 të datës 31.10.2017.
- Konkuzion për mënyrën e shites së patundshmërisë i nr. 1787/2017 të datës 22.11.2017.
- Konkuzion për përcaktim të vlerësimit të patundshmërisë i nr. 1787/2017 të datës 22.11.2017.
- Konkuzion për shiten publike me gojë i nr. 1787/2017 të datës 22.11.2017 të gjitha të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari dhe
- Konkuzion të vlerësimit të realizuar të patundshmërisë të muajit nëntor të vitit 2017 të NT VLERESIM DHE MBIQEYRJE Goce Mito Mihajloski Shkup.
2. Debitorin e pengut Ilmi Ejupi nga Gostivari me seli në f. Çegan, për shkak të dorëzimit të:
- Konkuzion për mënyrën e shites së patundshmërisë i nr. 1787/2017 të datës 22.11.2017.
- Konkuzion për përcaktim të vlerësimit të patundshmërisë i nr. 1787/2017 të datës 22.11.2017.
- Konkuzion për shiten publike me gojë i nr. 1787/2017 të datës 22.11.2017 të gjitha të Përbaruesit Aleksandar Kuzmanovski nga Gostivari dhe
- Konkuzion të vlerësimit të realizuar të patundshmërisë të muajit nëntor të vitit 2017 të NT VLERESIM DHE MBIQEYRJE Goce Mito Mihajloski Shkup.
Në afat prej 1 (një) dite duke konsideruar nga dita e publikimit të kësaj thirrje publike në gazetën ditore.
PARALAJMËROHET borxhliu Shoqëria për tregti, hoteleri, transport dhe shërbime RIGON KOM SHPKNJ eksport-import f. Çegan Gostivar dhe debitorin i pengut Ilmi Ejupi nga f. Çegan, se mënyra e këllitë e dorëzimit konsiderohet si e rregullit dhe se pasojat negative që mund të dalin do t'i barë vet pala.
KJO PARAQET SHPALLJEN E DYTË

PËRBARUES
Aleksandar Kuzmanovski

Republika e Maqedonisë
Qeveria e Republikës së Maqedonisë
Institucioni publik Qendra ndërkomunale për
Punë Sociale - GOSTIVAR

LAJMËRIM
Për shpallje të shpalljes publike si të pavlefshëm

IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Gostivar me Vendim të UD Drejtorit nën numrin 04-1063/2017 nga data 30.11.2017, shpalljen e publikuar për punësim për plotësimin e vendit të lirë të punës për punë dhe detyra të punës punëtor i diplomuar social për 1 (një) realizues në IP Qendra ndërkomunale për punë sociale Gostivar, për kohë të caktuar deri më 31.12.2017, të publikuar në numrin 04-1063/1 të datës 03.08.2017, SHPALLET SI I PAVLEFSHËM, dhe nuk është bërë përzgjedhje e kandidatit.

Koha
www.koha.mk • WEB FAQJA MË E VIZITUAR

Tel: 02 3179 - 904, Fax: 3118 - 060
marketing@koha.com.mk

udhërrëfytes
mjekësi
FAQ. 133

udhërrëfytes
mobilie/ndërtimtari
FAQ. 153

libri i artë
2017/18

ZBRITJE DHE GRATISE
24 KUPONË PREMIUM

LEHTË DERI TEK INFORMACIONI
www.zk.mk android app. iPhone app.



DASHI 21. mars - 20. prill

Do ndiheni të lumtur pranë atij që keni në krah dhe të gatshëm të hidhni çdo lloj hapi më tej. Për gjithçka do bashkëpunoni fort. Beqarët do kenë takime pa fund, po nuk do mund të nisin dot një histori serioze dashurie. Nëse dëshirojnë mund të përfitojnë për aventura kalimtare. Në planin financiar do ju duhet me patjetër të merrni disa para hua që t'ia dilni mbanë.



DEMI 21. prill - 21. maj

Mos u tregoni ironike me partnerin/es tuaj sot, por flisni hapur për gjithçka që mendoni. Në këtë mënyrë lidhja juaj do ecë në rrugën e duhur. Beqarët nuk duhet ta humbin për asnjë moment shpresën se do e gjejnë princin e tyre të kaltër. Sot mund të ndodhin gjëra të jashtëzakonshme. Në planin financiar do arrini t'i zgjidhni të gjitha problemet që keni pasur.



BINJAKET 22. maj - 21. qershor

Do jeni shumë pesimistë për vazhdimësinë e jetës suaj në çift gjatë kësaj dite duke parë ecurinë e saj kohët e fundit. Mos mendoni se të tjerët nuk kanë debate sepse ato janë normale për jetën. Beqarët më shumë gjasë do kenë takime impresionuese me persona të mrekullueshëm. Situata financiare do fillojë pak nga pak të stabilizohet.



GAFORRJA 22. qershor - 22. korrik

Do jeni shumë të përkushtuar ndaj punës sot dhe nuk do keni kohën e nevojshme për t'ia kushtuar atij që keni në krah. Shpjegojani atij situatën para se të mërzitet. Beqarët nuk do kenë as sot mundësi për të takuar princin e tyre të kaltër. Do ju duhet ende të presin. Financat do jenë goxha të mira, kështu që mund të përfitoni të kryeni ndonjë investim.



LUANI 23. korrik - 22. gusht

Do jeni shumë kritikë ndaj partnerit/es tuaj sot dhe kjo mund ta përkeqësojë marrëdhënien në çift. Tregohuni sa më të matur dhe mos kërkoni perfeksionin. Beqarët do bëjnë mirë të mos i besojnë të gjitha fjalëve që do ju thonë disa persona sepse do zhgënjehen shumë shpejt. Në planin financiar do jeni shumë të zotët dhe pak nga pak do e përmirësoni situatën.



VIRGJERESHA 23. gusht - 23. shtator

Ditë e turbullt dhe e mbushur me debate të zjarrta kjo për të gjithë të dashruarit. Herë pa herë do ndiheni shumë keq dhe nuk do dini çfarë të bëni. Beqarët duhet t'i pranojnë ftesat që do ju bëhen sepse askush nuk do i detyrojë më pas të krijojnë një lidhje. Gjithçka do jetë në dorën e tyre. Financat nuk do jenë aspak të mira.



PESHORJA 24. shtator - 23. tetor

Lidhja juaj në çift do përforcohet edhe më tepër gjatë kësaj dite. Do përbaleni me disa të papritura të cilat do ju afrojnë edhe më tepër me atë që keni në krah. Nëse ende jeni beqarë, sot takimet do jenë serioze dhe mbresëlënëse. Mos i humbisni. Në planin financiar nuk do keni vështirësi nëse nuk shpenzoni kuturu.



AKREPI 24. tetor - 22. nëntor

Mirëkuptimi dhe toleranca do mbizotërojë gjatë kësaj dite në jetën tuaj në çift. Edhe pse herë pas here do keni konflikte gjithçka do zgjidhet shpejt. Beqarët nuk do jenë të privilegjuar në dashuri, por kjo nuk do të thotë që do kalojnë një ditë të mërzitshme. Në planin financiar shpenzoni aq sa ua mban xhepi që të mos keni vështirësi më vonë.



SHIGJETARI 23. nëntor - 21. dhjetor

Ditë paksa delikate kjo e sotmja për ata që janë në një lidhje. Nuk do pranoni gjithmonë ato që do ju thotë partneri/ja dhe do veproni sipas mendjes suaj. Kjo do e përkeqësojë situatën. Beqarëve do ju ndryshojë jeta brenda disa orëve. Përgatituni për emocione dhe gëzim pa fund. Në planin financiar nuk do ketë probleme e vështirësi megjithatë kujdes me shpenzimet.



BRICJAPI 22. dhjetor - 20. janar

Edhe ju do jeni të përkëdhelur nga yjet në planin financiar. Nuk do keni asnjë debat sado të vogël, përkundrazi pasioni do jetë i zjarrtë. Beqarët gjithashtu do fillojnë një etapë të re në jetën e tyre, mjaft romantike dhe të mbushur me emocione. Në planin financiar vazhdoni të tregoheni të matur me shpenzimet në mënyrë që të mos keni probleme.




UJORI 21. janar - 19. shkurt

Ditë e lumtur kjo për gjithë ata që janë në një lidhje. Do kaloni momente fantastike pranë të dashurit të zemrës dhe do dëshironi që dita të mos ketë një fund. Beqarët do jenë të stresuar në lidhje me një çështje profesionale dhe nuk do mendojnë aspak për jetën sentimentale. Në planin financiar Marsi do ju bëjë më të kthjellët dhe do i menaxhoni me kujdes të ardhurat.



PESHQIT 20. shkurt - 20. mars

Pritet që jeta në çift të mos ketë as problemën më të vogël gjatë kësaj dite. Do kuptoheni mjaft mirë me partnerin/en tuaj dhe do e toleroni atë herë pas here. Në çdo rast do bashkëpunoni me të si një ekip i fortë. Beqarët nuk do jenë me shumë fat në dashuri dhe do mbeten vetëm. Në planin financiar mos kërkoni të pasuroheni menjëherë.



NE KETE DATE

ISH VOZITËSI FINLANDEZ ROZBERG												
KOMPOZITORI ARMENIAN, HAÇATURIAN												
KRYEQYTËTI ITALISE JASHTËTOKËSOR												
A												
LLOJ DRITHI, TEPA												
SQUFURI									UNIVERSITETI I TIRANËS			
FLETË QILIMI									SËMUNDJA E TOKES, PUNEHERA			
SHTET NË LINDJEN E MESME												
LLOJ KOKTEJI ALKOOLIK	M	QË I PËRKET BOSHTIT	AMERICIUMI	KOHA	DORËZUJ FILM ME BO DEREK						TEMPO	LLOJ EKSPLOZIVI
ISH GRUP MUZIKOR SUEDEZ					AKTORI YNË FEHMU STINË							MORAL
NACIONALITETI I BOKSIERIT NË FOTO												
TEATRI SHITËTOR					PJESË E NJË MEKANIZMI							
MARKË ORESH DORE					AKTORJA KROATE, RINA							
C									QYTET NË TAJLANDË			
KËNGË E GRUPIT 'DJURAN DJURAN'									INSTRUMENT MUZIKOR			
NOVELISTI FRËNG, DE BERZHERAK												KALIUMI REOMIRI
S												
												KADE DRURI PËR TË MBAJTUR VERË, TINAR

ZGJIDHJET: H, KEKE, ARAM, ALIEN, OKRA, S, UT, TENE, M, JAP, T, ABABEKIM, ROM SOMALIE, TSH, ELEMENT, CITIZEN, PAL, NOTORIUS, K, SIRANO, TIRË.

Sudoku

	<i>shumë i lehtë</i>				<i>mesatar</i>										
	7	2				8		5							
	2	3	5	7	4			9	5	3					
			1	7		9	1	8		2					
		6			1	7		3	5	9	6				
	8	4			5	9				1		7	3		
3	1				6					7	6				
			6	9		4	2			8		7		2	9
4		8		3	2				4		3	2			
				8						2					4

Shumë i lehtë: 837264951, 162359784, 945817236, 256983417, 784126593, 319475628, 573691842, 498732165, 621548379, Mesatar: 384672591, 267195438, 915843267, 473589612, 596214873, 821736954, 158467329, 649321785, 732958146.



Facebook fiton 10 miliardë dollarë për 3 muaj!

Algoritmi i ri për reklamimin në Facebook duket se ka dhënë rezultatet e para. Kompania publikoi të dhënat për 3-mujorin e tretë të këtij viti dhe shifrat e përfituara janë marramendëse. Sipas këtyre të dhënave, vetëm nga marketingu, Facebook ka siguruar rreth 10 miliardë dollarë përfitimi në korrik, gusht dhe shtator. Rreth gjysma e kësaj shume (4.7 miliardë dollarë) janë fitime të pastra për kompaninë, ndërsa pjesa tjetër janë shpenzime, ku koston më të madhe e ka patur siguria.

Mark Zuckerberg u deklaruar investitorëve se politikat e kompanisë në fushën e sigurisë në të ardhmen do të kenë një ndikim edhe më të madh tek fitimet, duke i reduktuar ato. Deklarata e tij interpretohet si një reagim ndaj nismës dhe hetimeve të ligjvënësve amerikanë për mundësinë se platforma më e madhe sociale të jetë përdorur dhe të përdoret akoma nga Rusia për propagandë. "Jemi të vendosur për të parandaluar abuzimet në platformën tonë. Mbrojtja e komunitetit, për ne është më e rëndësishme sesa përfitimet", deklaroi Zuckerberg.



SHPALOSET LAMBORGHINI URUS

Lamborghini Urus është shpalosur pak para debutimit zyrtar. Ky është modeli i parë SUV i Lamborghini që do të kushtojë rreth 180 mijë euro. Sipas Lambos, Urusi është "fuqi, performancë dhe dinamikë", ndërsa kombinon edhe "dizajn, luks dhe ngasje të lehtë". Urusi ka motor 4.0-litërs twin-turbo V8 me 641 kuajfuqi. Ai vjen me sistemin që tërheqë me të gjitha rrotat. Përshpejtimin prej 0 në 100 kilometra për orë ky model e arrin për 3.6 sekonda. Vetura ka marsh automatik me tetë shpejtësi.



"Happy Birthday", 25 vjet SMS!



Më 3 dhjetor 1992 u dërgua SMS e parë. Më pas mesazhet që dërgoheshin me celularë u sollën kompanive të telefonisë të ardhura milionëshe. Dhe edhe sot megjithë konkurrencën e shërbimeve të tjera, dërgimi i mesazheve nuk ka marrë fund. Konceptin e sms-ve e ideuan gjer-

mani Friedhelm Hillebrand dhe francezi Bernhard Ghillebaert. Pra sms-të janë një shpikje gjermano-franceze. Në mes të viteve 1990 kur telefonja mobile dhe celularët shënuan një bum ofruesit e shërbimit sms nxorën fitime të mëdha. Në vitin 1996 p.sh. në Gjermani u dërguan 100

milionë sms, kurse në vitin 2012 rreth 50 miliardë. Një sms kushtonte 39 cent dhe fitimet ishin tepër të mëdha. Këto fitime vazhduan edhe pasi filloi të aplikoheshin sistemi flatrate. Por që nga viti 2009 shërbimet që mundësonin smartphonët si Messenger apo Whatsapp filluan t'u bënin konkurrencë sms-ve si mjet komunikimi. Këtyre iu shtuan më vonë edhe Facebook-Messenger apo Twitter. Por megjithë konkurrencën nga interneti sms-të vazhdojnë të mbijetojnë. Në Gjermani u dërguan gjatë vitit 2016 rreth 12,7 miliardë sms. SMS-të vazhdojnë të jenë rruga kryesore për dërgimin e kodit të identifikimit për llogaritë bankare online. Po ashtu kush nuk u beson shërbimeve sekrete amerikane dhe mbledhjes së të dhënave prej tyre, vazhdon të përdorë sms-të.




KALENDARI HISTORIK 6 DHJETOR

- 1060 - Bela I kurorëzohet Mbret i Hungarisë.
- 1240 - Mongolët nën udhëheqjen e Batu Khan okupojnë dhe shkatërrojnë Kievin.
- 1424 - Don Alfonso V i Aragonit i jep të drejtë Barcelonës për të dëbuar hebrejtë.
- 1492 - Zbulohet Haiti nga Kolombo.
- 1756 - Trupat britanike nën komandën e Robert Clive okupojnë Fulta në Indi.
- 1768 - Publikohet edicioni i parë i "Encyclopedia Britannica" (Skoci)
- 1790 - Kongresi amerikan shpërngulet prej Nju Jork Siti në Filadelfia (Pensilvani).
- 1820 - Rizgjidhet Kryetari amerikan James Monroe.
- 1912 - Kina voton për të drejtat njerëzore universale.
- 1917 - Finlanda shpall pavarësinë nga Rusia.
- 1929 - Turqia prezanton të drejtën e votës për femrat.
- 1956 - Nelson Mandella dhe 156 persona të tjerë arrestohen për aktivitete politike në Afrikën e Jugut
- 1998 - Hugo Chávez Frias, zgjidhet kryetar i Venezuelës.



Qentë nuk e njohin ndjenjën e fajit - ata mund të ndjehen vetëm të trishtuar, kur i zoti i tyre i bërret.

Popullsia e Irlandës është aktualisht 2 milionë më pak nga sa ishte para zisë së bukës, 160 vjet më parë.



Rreth 10 milionë baktere gjenden mesatarisht në vendin ku ju vendosni duart mbi tavolinën tuaj të punës.



A E DINI SE...

PASTRUESI I OXHAQEVE

Babai: A ke dëgjuar se pastruesin tonë të oxhaqeve e ka shkelur vetura? Biondina: E tmerrshme! Nuk jemi më të sigurt as në çati...

SHKALLËT LËVIZËSE

I thotë biondja shoqes së vet bionde: - Paramendo, dje u ndal rryma, mbeta në ashensor një orë rrafsh! - Po kjo nuk është asgjë. Unë kam mbetur tri orë në shkallët lëvizëse.

BARSOLETA



THËNIA E DITËS



Njerëzit qajnë jo se janë të dobët, por sepse kanë qenë të fortë për një kohë shumë të gjatë.

(Johnny Depp)